

- Moisi Zaloshnja -

KOHËT NDRYSHUAN



VH - 32
Z 22

MOISI ZALOSHNAJA *veçim*

8A - 3
Zal 16

BIBLIOTEKA E SHTETIT
GJIROKASTER

Kohët ndryshuan

(Tregime)

3464

NDËRMARRJA SHTETËRORE E BOTIMEVE

SHËNCIMI DIPLOMATIK

TIRANË, 1957

NE PRAG TE FITORES

Nga kodrat e Saukut, në jugë të Tirarës, shihej gjithë qyteti si në pëllëmbë të dorës. Shtëpitë, pallatet dhe rrugët e gjera dukeshin sikur shtriheshin gjer rrëzë maleve të Krujës nga veriu, dhe nga perëndimi mbulonin fushën e gjerë pa arë e fund.

Jorgji Marargozi kishte një orë e ca që po rrinte shtrire barkazi me mitrozin përpara, në një nga pozicionet që pat bërë para tri ditësh dhe vështronë me mall qytetin e lindjes.

Kur éshtë vetëm njeriu dhe mejtohet, i shkojnë në-për mënd kush e di sa e sa gjëra, kush e di sa e sa kujtime, bën gjithëfarë planesh për të ardhmen, gëzohet, qesh me vehte, urren e shtrëngon grushte e nofulla, kur kujton se ka një armik përpara që do ta pengojë.

Edhe Jorgji, gjatë kësaj kohe që kishte mbetur vetëm, pat sjellë ndër mënd tërë jetën e tij, duke u munduar të kujtonte gjithëçka mbarët mënd që në fëmini. Kujtoi në-nën, vëllanë e motrën, u mundua të përfytyronte gëzimin e tyre kur t'i takonte. Solli ndër mënd shtëpinë e vogël përdhese me dy të ndara, oborrin me lule, siç e pat lërë sot e dy vjet të kaluara, kur qe hedhur në mal me çetat partizane, e pastaj i duallën një nga një përpara syve shokët e fëminisë, shumë prej të cilëve i pati dëhe si u rrit. Kujtoi vëndet ku pat lozur me 'ta; një mall i tërë plot ankth e pushtoi dhe ndjente një peshë të rëndë sikur t'i qe bërë rjë lëmsh në lukth të zëmërs.

Gjatë jetës partizane, ai kush e di sa herë e pat parë në ëndër Tiranën. I bëhej në gjumët sikur kryente aksione kundër spionëve e tradhëtarëve, — pikërisht ashtu siç i pat qëlluar disa herë me të vërtetë para se të dilte ilegal, — sikur ngjiste trakte, sikur sulmonte për çlirimin e kryeqytetit. Çmallej me Tiranën në këto ëndëra, por kur zgjo-

hej e shikonte se gjëndej majë ndonjë mali ose në shtëpit e fshatarëve, psherëtirte, kthehej në krahan tjetër e ja kë-puste përsëri gjumit, i lodhur nga marshimet e gjata.

Kur erdhi në kodrat e Saukut, ky mall për Tiranën iu shtua akoma më shumë. Dy vjet të tëra në malet e jugut krrë ndorjë herë nuk qe mallëngjyer për njerëzit e për shtëpinë sa gjatë këtyre ditëve. Bile shokët e tij i patën thënë shumë herë:

— Me ty, Jorgji, është çudi. Asnjë herë nuk të kemi dëgjuar të flasësh për nënën.

Por ai mallin e mbarëtë të ndrydhur në zëmë.

Lajmi që kishte marrë sot në mëngjes herët, se shtabi operativ për qëllimin e kryeqytetit kishte vendosur që n'ora 16 fiks të fillonte sulmi vendimtar për qëllimin e Tiranës, e bënte të fluturonte me krahë.

Ora ishte 12 e mezit të ditës. Nga ana e partizanëve në këtë çast nuk bëhej asnjë veprim. Rreth e përqark Tiranës dukej sikur nuk pipëtinte gjë. Ishte qetësija përra para stuhisë. Ndërsa brënda në qytet herë pas here ulërinte ndonjë autoblindë nëpër rrugët, që ngjanin si të shkreta dhe aty këtu shihej ndorjë nazist a ballist, që kalonte nga njëri cep në tjetrin, me nxitim, e që dukej sa një mizë.

Jorgji i vështronë dhe shtrëngonte dhëmbët. Ai kishte sulmuar armiqjtë natë për ratë, qyshse kishte ardhur këtu, gjer në llogoret e në telat me gjëmba të tyre e i kishët grirë me nga dhjetë e pesëmbëdhjetë bomba që iu kishët vërtitur njëren pas tjetrës.

Duke mbajtur kokën në pëllëmbat e duarve, mendonte: «Do të hyjmë në Tiranën e Re. Në fillim do të na duhet të bllokojmë filari rrugë. Si të vemë atje, do të zëmë ato pallatet e mëdha... Në ballkonin e atij pallati një mitroloz të bën punë...»

Më në fund u ngrit në gjunjë, mori leckën e vajit dhe filloi të fshinte mitrolozin, gjithë gas se po afrohej ora e sulmit, megjithëse gjatë asaj paradite mund që e kishte pastruar dy a tri herë të tjera. Dhe duke bërë këtë purë i fliste mitrolozit sikur ai ta dëgjonte ç'i thosh:

— Tek ti e ka shpirtin lala. Kur të të them unë: «kolli-tu», kollitu pa frikë, se të ka lala në dorë.

Dy vjet e ca atë mitroloz nuk e pat luajtur nga supi, aqë sa të dy supet i ishin bërë guall, duke e mbajtur me krahë ditë e natë e nuk ndjente në i kish të tijtë.

Në këtë çast ja arriji që përposh, nga prapa bregut, Kamberi, me rjë gavetë me kokoshka misëri. Kishte bukë s'kishte, Kamberi e kish bërë zakon që një a dy qillo misër do t'i mbante në çantët dhe, kur e merrte urija, i piqte. Edhe sot, me t'u mbaruar instruksionet që u dhanë për të fundit herë se si zhvillohet lufta në qytet me një grup partizanë, ai kishte pjekur kokoshka dhe vajti i tha Jorgjit, siç i thosh gjithmonë, me të qeshur:

— Shoku përgjegjës i ririsë, do apo s'do nga këto sherkat e fshatit, apo ti je qytetar e s'para të pëlqejnë. — Sepse e dinte që edhe Jorgji i kishte shumë qejf kokoshkat e Kamberit.

Ata të dy ishin bërë miq e shokë qyshse kishte vajtur Jorgji për herë të parë në fshatin e Kamberit në Skrapar. Të dy të rinj. Secili ruk kishte kaluar të njëzet vjeçët. Jorgji e kishte marrë Kamberin në çetë. Ai i kish mësuar shkrim e lexim. E kishte propozuar në celulen e Partisë që të prarohej i ri komunist. Dhe tani Jorgji ishte përgjegjës e rinisë në batalion, kurse Kamberi komandant kompanije. Dy vjet të tëra asnjë herë nuk qenë ndarë nga shoshoqi: tok në çetë, tok në batalior, tok në brigadë.

Bashkë me gavetën, Kamberi i lëshoi Jorgjit përpara edhe gazetën e xhepit të brigadës.

— Urdhëro, shok, se ta kanë botuar vjershën e Tiranës.

Jorgji këceu përpjetë sa desh e derdhi gavetën. Sytë i lëshuar xixa nga gjëzimi dhe lexoi me zë të lartë:

Tiranë, zëmër, Tirana!
Syt e tu dinë, c'panë,
shpirti yt e di se c'hoqi,
Se armiku dogji, poqi!

Po ti kurrë s'u përkule,
Po ti kurrë s'u trondite.
Dhe flamurin e Partisë
La më la e valëvite.

Kjo ishte një vjershë e tij që kishte bërë një ditë pasi kishte ardhur në kodrat e Saukut.

Komisari i brigadës, — i tha Kamberi, — e kishte pëllqyer këtë vjershë dhe ka thënë që ta lexojnë të gjithë.

Duke biseduar për sulmin vendimtar të çlirimtë të kryeqytetit, të dy shokët folën edhe sot, si gjithmonë, për ditët e lumtura që i prisnir, për gëzimin kur do të kthehen në shtëpi si të kishte mbaruar lufta, dhe në këto bisedime e sipër Kamberi i tha Jorgjit:

— Ku e ke shtëpinë, ti, Jorgji?

— Ja, jaaa, mu atje, — ja bëri me dorë Jorgji për nga Spitali i Përgjithëshëm, po nuk duket se nuk e lënë ato shtëpitë e mëdha.

— Kur të vemi në shtëpinë tënde, sapo të hyj, do t'i them nérës sate, — vazhdoi Kamberi, — ja, nëno, edhe Jorgjin ta prura shëndoshë e mirë. A të kujtohet si më shkruante nëna jote atëhere kur muarrëm letrën e saj, kur hymë në fillim rë Berat: «Djalin e dua nga ti, Kamber, të ma ruash e të ma sjellësh si pëllumb», se ajo, kur i ke shkrojtur ti për mua, kush e di ç'më ka pandehur, ndonjë çetar të vjetër, të rrahur në luftra. Nuk di ajo se ti u bëre shkaktar...

Dhe të dy të rinjtë gjëzonin në këtë çast si dy vëllezër sot, që kthehen në shtëpi nga shkolla e largët, pasi ka në dhënë edhe provimin e fundit dhe kanë dalë me sukses, ejeta e lumtur u ka hapur krahët e i pret ta bëjnë akoma më të lumtur.

Ora po shkorte dy.

Të dy shokët vazhdonin të bisedonin dhe vështronin nga qyteti buzëgas. Veshët i mbanin ngritur se mos jepej shënja e sulmit. Megjithëse duheshin dhe dy orë akoma, atyre iu bëhej të shpresonin se mos kish dalë ndonjë urdhërtjetër, që ta fillonin sulmin më herët.

Në mëngjes kishte rënë shi. Pastaj koha ishte prerë. Qielli kishte mbetur pjesërisht i mbuluar me re të bardha. Dielli, gjatë ditës, herë delte, herë fshihej. Atje ku s'kishte re, qielli ishte aqë i kaltërt, sa që ngjante si qelq i pastër. Tashti që pat thyer dita, retë zuri t'i shtynte një erë pak a shumë e ftohët, nga lindja në perëndim. Hijet e tyre, plla-

ëcka-placka, kalonin mbi qytet dhe iu linin vëndin rrezeve të diellit. Ca nga ca tërë qyteti po shëndriste nën rrezet e atij dielli vjeshte.

Jorgjit e Kamberit iu dukej rë këtë çast sikur Tiranës po i hiqej ajo hije e rëndë trishtimi dhe ankthi, me të cilën deshi ta mbulonte fashizmi.

— Sa është ora, o Jorgji? — e pyeti Kamberi.

— Dy, — u përgjegj Jorgji duke bërë me dorë i dëshpëruar, sikur donte të thoshte: Sa ngadalë që po shkon e shkreta!

* : *

E ëma e Jorgji Marangozit, Lena, që kurse kishte filluar i biri të punonte për lëvizjen, kurrë ruk ishte e qetë, megjithëse ishte mësuar me një jetë të tillë. I shoqi, Anastasi, komunist i vjetër, si dyqanin, ashtu edhe shtëpinë, i kishte bërë qendra të punës ilegale që në kohën e regjimit të Zogut. Pastaj më 1939, ca kohë përparrë se të okuponte fashizmi italian Shqipërinë, e kishin arrestuar, e kishin torturuar dhe në fund e patën internuar në Gramsh të Elbasanit. Atje ai kishte vdekur nga torturat e nga vojtjet. Po dhimbja përfëmijëri qënkësh më e madhe se çdo gjë në bëtë.

Kur binin pushkë në pazar, Lenës i bëhej gjaku ujë e me gjak të ngrirë priste gjersa të merrte vesh që ishte bërrë. Kur i thoshin se u vra filan spion apo tradhëtar dhe atentatorët nuk u zunë, atëherë bota i dukej tjetër soj.

Sidçqoftë, sa e pati Jorgjin në qytet, rë mos dëndur, por më të rallë, e takonte, sepse, ose vinte ai në shtëpi natën, ose e takonte ajo vetë nëpër baza të tjera partizane, kur e dërgonin shokët e djalit me trakte, me ndorjë letër, ose edhe me armë e municione, që i mblidhnin për shokët në mal. Por kur i shkoi Jorgji në çetë, atëherë nuk i hiqej nga mëndja për asnjë çast. Edhe ratën në gjumiët atë shikonte në èndërr: «Ç'qënka nëna e shkretë për evlatin'-mejtonte me vehte e çuditur.

Kur frynte erë, kur binte shi e bërete ftohet, Lena menjtonte me vehte: «Ku do të jetë Jorgji tani në këtë natë va-

llë? Brënda, apo jashtë? Do të jetë në luftë, apo ku? Do të më ketë rroba, apo do të më ketë mbetur me ato të hollat që kishte kur iku?...» Po në sy të shokëve të djalit e të gjithë botës, nuk e bënte vehten kurrë. Të gjithë Lenën e rjihnin si një grua që dinte të duronte dhe të luftonte. Kur binte fjala, megjithëse i dhimbsej djali, thoshte sa herë me gjithë shpirt: «Kush lufton për rëjë të drejtë, edhe ne u vraftë shkon me nder. Edhe djali im, si ta ketë të thënë. Jetë-gjati nuk bëhet kurrë jetë-shkurtër».

Kur shkonte nëpër shtëpitë e lagjes për të agjituar, për të mbledhur ndihma a për ndonjë punë tjetër, u thoshte atyre që bisedonte:

— Djemtë në mal, ne këtu, kështu të gjithë bashkë, do ta çporrim dushmanin.

Shtëpija e saj ishte bërë qëndra e partizanëve, depo armësh, vendi i trakteve. Apo nuk ua gjerte vendin të gjithave Leni! Sa herë që e patën kontrolluar, nuk i patën zënë asnjë majë gjilpëre nga sendet e partizarëve.

Po të mos paske patur dy fëmijët e tjerë të vegjël, Yllin dhjetë vjeç dhe Dritën shtatë vjeçë, që e kishte në bark kur i arrestuan Arastasin, dhe po të mos e paske patur një këmbë pak çyryk, ajo do të kishte shkuar në mal me kohë.

Në kohën kur u afroan forcat partizane dhe rrrethuan Tiranën, Lena gëzonte sa për çirimin, aqë edhe për Jorgjin që do të vinte ta takorte e të çmallej me 'të.

Kishte tri-katër ditë që kishte filluar lufta. Në natë partizanët hyjnë në lagjen e saj. Rrugët gjëmonin nga bombat, mitrolozat, pushkët. — Para partizanë, para partizanë! — Dëgjoheshin partizanët që nga larg.

Lera mënt fluturonte nga gëzimi.

— Ashtu djemt e nënës, ashtu! Ashtu, vëllezër! — thoshte duke ardhur rrëth nëpër shtëpi e nëpër oborr, që të gjente një vend të mbrojtur të mos e zinin plumbat për të kupluar se nga anonte lufta.

N'ato zëra që thërrisin, rdonjë i dukej si i Jorgjit dhe mejtonte:

— Ti do të jesh, bir i nënës, ti.

Po Jorgji i saj n'atë kohë nuk kishte arritur akoma në rrethimin e Tiranës. Atij i patën ngarkuar një punë më rërdësi diku gjetkë dhe kur erdhi, lufta kish gjashtë-shtëtë ditë që kish filluar.

Bataljonit ku bënte pjesë Jorgji i kish rënë në short sektori në jugë të qytetit. Kurse atij do t'i dëshëronte zemra t'ish atij krahut andej nga kishte shtëpinë. Me të ardhur, shtabi i brigadës, pa marrë frymë, e nisi për në batalionin e tij. Kështu që as pati kohë të mendonte për të biseduar gjë. Dhe pas pesë ditësh pastaj ishte dhërë urdhëri përsulmin vendimtar për çlirimirë e kryeqytetit.

Po atë natë, pas tri orësh përleshje, Lena ndjeu ca këmbë në oborrin e fqinjës. Pastaj nga muri i oborrit, «bump» u hodh përdhe një njeri në oborrin e saj. Pas tij «bump» edhe një tjetër, edhe rjë tjetër. Tre veta. Ata povinin rreth me ngut ku të gjenin një shteg nga të kalonin më tutje. Nëpër terrët Lena i pa që ishin të armatosur. Po sikur të ishin nazistë ose ballistë!

E bëri zemrër gur e thirri me zë të ulët:

— Jorgji, ti je, bir i nënës?

— Nëno, jemi partizanë, — iu përgjigjën hijet dhe u nisën drejt saj. Atëherë Lena ndjeu që ishin të lodhur, se gulçonin e mezi mernin frymë.

— Nga të hidhemi që të kalojmë përpëra, rëno?

— Këtej, vëllezër, këtej, — iu priu Lena.

Mitrolozi e pushkët u ndezën pak më poshtë shtëpisë së saj, ku bënte rruga një brryl.

— Shpejt, nëno, gurë, tulla, hekurishte, ç'të gjesh na i sill të ngrejmë rjë barikadë, — i tha një nga partizanët.

Lena trokiti portë më portë, rgriti edhe tërë rrugën e saj më këmbë dhe barikada u ngrit sakaq.

Banorët e lagjes disa punonin, disa të tjerë iu sillnin partizanëve për të ngrënë.

— Hani, djemt e nënës, hari, vëllezër, se kush e di që kur kini pa bukë, iu thoshin grarija që delnin nëpër portat dhe iu zgjatnin tepsi të mbushura me lloj-lloj sendesh ushqimore.

— C'qënka ky byrek i ngrohtë, moj motër! — i thoshte një partizan Lenës, duke kafshuar me oreks të madh një copë byrek.

— Ju prisnim or'e çast, or vëlla; për ju e kam bërë; e mbajta në sobë që të mos ftohej, — i përgjigjej Lena.

Me të rënë dita, pjesa e Tiranës nga veri-lindja, që nën spital e lart, u çlirua. Partizanë e popull ngrinin bërikada rjerën pas tjétrës.

Çdo partizan që shihte, Lena e pyeste:

— A e njeh, or bir, një Jorgji Marangozi? e kam djalin tim.

Shtatë a tetë ditë me radhë asnë nuk tha se e kish parë ose se e dinte ku ishte. Por të nëntën ditë një djalë me mustaqe të verdha i tregoi se ku gjendej bataliori i Jorgjit dhe Jorgji vetë. Dy ditë kishte që qe ndarë me 'të. Ishin shckë të vjetër me Jorgjin.

Lena iu hodh në qafë, e pushtoi edhe një herë dhe nuk dinte ç't'i bënte e ç't'i thoshte. E pyeti për shëndetin e Jorgjit, a kishte rroba apo jo, ç'bënte për të ngrerë. E për çfarë nuk e pyeti! Kur i tregonte partizani, se Jorgji ishte rritur, kishte lënë mustaqet, ishte si molla nga shëndeti, veç që e kish marrë malli për 'të, ajo nga gjëzimi së s'lua te mënç. I dukeshin si të pabesuara ato që dëgontë. Jorgji kishte ikur pa qime në faqet.

— Si më the, si? E ke patur përgjegjës të ririsë në batalion? — e pyeti Lera partizanin pa ja hequr sytë dhe mejtonte me vehte: — Po ky është burrë përpara Jorgjit tim. — Megjithse partizani, me atë eshtë të trashë e me atë trup të ngjeshur, nuk ishte më i madh se njëzet e dytre vjeç djalë.

Nga gjëzimi i dridheshin duart e nuk dinte ku t'i vinte.

Ajo kishte tharë gojën për ata fëmijë. Kishte puruar e robëtuar nëpër dyert e botës, kishte duruar sa e sa të shara, sa e sa përbuzje që t'iu siguronte një kothere bukë, t'i rriste e të shihte prej tyre një ditë të bardhë.

Me të marrë vesh se ku ndodhej Jorgji, Lenën, nuk e nxinte verdi. Donte të vinte ta takonte, por po errej dhe partizanët i thanë se nuk mund të shkonte e nuk mund ta

gjente. Edhe për të nesërmer nuk ishte e mundur. Pregatitë sulmi i përgjithëshëm vendimtar për çlirimin e Tiranës. Secilit, edhe Jorgjit vetë, i zjente koka n'ato çaste.

Tërë atë natë, Léna nuk fjeti. Vinte rrëth nëpër shtëpi dhe fliste me vehte me zë të lartë: «T'u bëftë nëna, ty, Jorgji i rënës. Ti më qënke rritur, ti më qënke bërë burrë me mustaqe. T'u bëfsha unë mustaqeve tua, o trim i noçes». I shprehte këto me një mall t'atillë në fytyrë e me një zë përkëdhelës, sikur ta kish Jorgjin në vatër e ta gezonëte. Mundohej ta përfytyronte se sa bojë do të kishte hedhur, sa do të qe zgjeruar në shpatulla, ç'hije do t'i kishin dhënë rrobat partizane, ç'hije luftëtarë do të kishte marrë.

Ai shoku i Jorgjit që e kishte fjalosur për të, i kishte thërë: «Po ta shohësh Jorgjin tanë, nuk e njeh fare». Kurse ajo kishte përpëra syve gjithënjë atë Jorgjin e hequr, me atë hundën e mprehtë, me trup thatim, akoma fëmijë, që e shikonte me dhëmshuri kur i kthehej i lodhur nga dyqani, ku punonte si çirak këpuçar. Këto kujtime e bënин të drithërohej akoma më shumë për 'të dhe të thoshtë me vete: «Jo, si të mos e njoh unë djalin?! Sado të jetë rritur, sado t'i ketë vlejtur klima e malit, siç thoshtë ai shoku i tij, sado të ketë lërë mustaqet, do ta njoh unë djalin, si të mos e njoh!». Pastaj hapte krahët sikur e kishte përpëra ta pushtonte, i shtrëngonte duart në gjoks e thosh: «T'u bëftë noçja ty, komisar i noçes!».

Duke ardhur rrëth prestatiste shtëpinë që, kur të vinte Jorgji, të mos kishte asnë telash tjetër veç të ishte e lirë t'i rrinte pranë, t'i gëzohej, të çmallëj, t'i vinte ujë ta lante dakulec, siç e lante kur ishte i vogël, e t'i fërkorte shpatullat e lodhura. Mori ndërrresat e Jorgjit, që i pati larë, i shikoi mos kishin ndonjë follë të këputur, i hekurossi, i vuri palë mbi tryezën në fund të dhomës, jo në sënduq, që t'i kishte gati në çdo minutë, se ja, sikur e kishte parë Jorgjin në derë, e të mos vonohej, por fët e fët ta ndërronte. Pastaj mori jorganin e tij, i hodhi çarçafin e larë, i shtiri edhe dyshekur, që ja pati shkriftuar koklat që më përpëra. Duke bërë këto punë nuk pushonte së fjalosuri gjithënjë me vehte: «... Ashtu, të keqen nënia, ash-

tu. Ja edhe shtratir ta rregulloj nenia që të të bjerë brinjë rehat rjë natë, se ke kaqë kohë maleve.»

Edhe fëmijët, Yllin dhe Dritën, nuk i zuri gjumi atë natë. Nga gëzimi nuk hëngren as darkë.

— Nuk na hahet, moj mama, jo, — i thanë. Kush e di, po të vijë Jorgji që sot, ngrihem i dhe hamë bashkë me 'të.

Si ranë rë dyshekët, rrinin sa rrinin e pastaj fësht zbulonin kokën ngadalë e pyesnin:

— Moj mama, po kur do të vijë ky Jorgji, kur?, hë, thuaj ti, kur?

— Ja, shpirtët e mamasë, ja; nesër këtu do ta kemi Jorgjin. Në mos nesër, pasnesër. Këtu është ai tani. Mund të vijë edhe sot.

Dhe të tre, ëmë e bij, mbanin veshët rgritur sa herë që ndiheshin këmbë në rrugë, mos trokiste porta dhe vinte Jorgji.

— Po ti nuk e njeh Jorgjin, ti nuk e mban mënd, — i thoshte Lena Dritës duke i fërkuar kokën atje rë dyshek tek kishte rënë. — Ti pesë vjeçë e gjysëm ishje kuriku Jorgji.

Drita, ca e lodhur nga pritja e të vëllajt, ca pse i virte keq që e ëma i thoshte ashtu, grindej me përkëdheli:

— Po e njoh, moj mama, e njoh, si nuk e njoh?! Si nuk e mbaj mënd?! Nuk vinte këtu ai me shokë? Nuk më mbante gjithërjë në prehër? Po atëhere, nuk e mban mënt ti, mama, kur e puthe dhe qave?!

Dritës i kujtohej çasti kur kishte ardhur Jorgji e që përcjellë me shtëpinë para se të shkonte për gjithëmonë me çetat.

Pastaj Drita zinte e i kujtonte me mburrje s'ëmës se si ajo mbante mënd që Jorgji e kishte mësuar të thoshtë: «Vdekje Fashizmit» e të nderonte me grusht; të thoshtë: «Rroftë Partija Komuniste», «Rroftë Bashkimi Sovjetik», «Rroftë baba Stalini».

Lena duke dëgjuar Dritën sillte rdër mënd se si i pat folur kaqë herë Jorgjit të mos e mësonte atë foshnjë, se ajo delte në rrugë e tregonte e iu sillte belara. Por Jor-

gji nuk hiqte dorë nga e tija, vazhdonte duke qeshur me gjithë shpirt ta mësonte motrën e vogël me zë të ulët:

— Hë, Drita, hë! Pa thuaj: «Rroftë Partija Komuniste», dhe Drita vinte grushtir e vogël në ballë e thosht: «Rroftë Partia Komuniste» duke e shqiptuar Rr-në L.

Fëmijët i zuri gjumi më përpara. Lena ndejeti akoma zgjurar. Ajo androi edhe një palë pantallona të vjetra që t'i vishte Jorgji dhe ato që kishte me vehte t'ja lante shpejt e shpejt.

Ashtu nga ora katër pas mesnatës ra edhe Lena të flirte. Në mëngjes prapë u ngrit herët, se si anëtare e këshillit të Frontit në lagje, e prisnin një tok punë, e veçanërisht pura që i kishin ngarkuar, bashkë me shumë shoqe të tjera, për t'u kujdesur për partizanët e sëmurë e të plagosur.

Të vendosur sipas urdhërit të Shtabit operativ për çlirim e Tiranës, rreth e qark qytetit, partizanët e tre divizioneve t'ushtrisë N.Çl. prisnin orën e sulmit vendimtar. Shënja e sulmit do t'ishte hedhja e tri fushqetave të kuqe.

Tirara, e heshtur dhe e qetë c'prej tri-katër orësh, pa drita në mëgëtirë e asaj mbrëmjeje vjeshte, dukej sikur e dinte se ç'ishte vendosur përfatim e saj nga partizanët: të çlirohej për jetë, të shkëlgente në dritën e yjve e të festonte gjithë gas e gjallëri. Jorgjit dhe Kamberit u dukej sikur i hidhte dheu. Të dy, me zemër e trup të tendosur, mezi prisnin dhe minutat u dukëshin orë.

Ora gjashtëmbëdhjetë e datës 11 Nëntor 1944, ora e sulmit vendimtar, ora e çlirimtës së kryeqytetit, ra.

Partizanët çohen nga pozicionet dhe vërsulen mbi armikun.

Jorgji, Kamberi e partizanë të tjera kanë objektiv Kishën e Shër Prokopit, Tiranën e Ré dhe pastaj të dalin te pallatet e Ministrive. Vëndi ku do të sulmojnë është fare i zbuluar. Terreni aspak i favorshëm. Artilerija, tanksi dhe të gjitha armët, të hanë nga të katër anët.

Në Shtabin e brigadës, Jorgji kishte mësuar se, sipas informatave që kishin, forcat naziste rë Tiranë arrinin në tre mijë vetë, t'armatosur me të gjitha llojet e armëve. Armi kishte për qëllim të rezistonte me çdo kusht në Tiranë gjersa t'i vinte ndihma nga forcat që qenë grumbulluar n'Elbasan. Gjatë atyre ditëve që kishte luftuar, Jorgji kishte vërë re se morali i nazistëve ishte për tokë, por megjithatë kishte parë edhe se si luftonin e qëndronin që-nërisht.

Pesë minuta para se të fillonte sulmi, Jorgji kish hedhur edhe një herë një vështrim të shpejtë nga Kisha e Shën Prokopit, te Stadiumi, te pallatet e nepunsave, te Banka Kombëtare, nga Bashkija e gjatë rrugës s'Elbasanit në të gjitha këto vënde të Tiranës që nuk ishin çliruar akoma, dhe kish shtrënguar grushtet e dhëmbët sikur ta kishte armikun përparrar duarve duke thënë me vehte:

— Tashti mbaruat, rgrini duart qëna, se nuk delni dot të gjallë, jo!

Që nga mbrëmja e njëmbëdhjetë nëndorit e gjer në gjashtëmbëdhjetë, luftime të ashpra u zhvilluan për çlirimin e kryeqytetit. Armiqtë qëndronin qënërisht për të mbajtur pozitat, të futur nëpër fortira e llogore. Tankset e tyre vinin rreth dhe suleshin, si bisha të hekurta, nga njëra rrugë e qytetit në tjetrën. Pesë ditë e pesë netë Tirana ishte nën zjarrir e bombave, mitrolozave, t'artilerisë. Tyimi dhe flakët e shtëpive të djegura nga nazistët mbulonin qiellin! Dheu dridhej si rga një tërmët i paparë. Dukej për një çast sikur nuk do të mbetej gjë më këmbë.

Aty nga data pesëmbëdhjetë rëndor, pasi qe larguar për nj'a dy orë për të marrë kontakte me shtabin e brigadës, Jorgji u kthye i gëzuar e iu hodh në qafë Kamberit.

— Forca Kamber, forca Kamber!

— Ç'kemi, mo? Si është puna?

— Në Mushqetë nazistët janë grirë. Gjithë kollona na-

ziste që ishte nisur t'i vinte rë ndihmë garnizonit të Tiranës, mbaroi, mori fund.

— Duke fërkuar duart e duke kërcyer nga gjëzimi si ndonjë fëmijë, Jorgji vazhdonte t'i jepte lajmet e reja shokut:

— Tashti parulla është sulm mbi armikun. Ku do të futet, kapiten Leidereri?

Kapiten Leidereri ishte komandant i forcave naziste të garnizonit të Tiranës. Me t'u dukur kollona që i vinte në ndihmë, ai u orvat me forcat e tij të çante rrëthimin. Në këtë situatë shtabi operativ për çlirimin e Tiranës kish hedhur parullën: «të rezistojmë me çdo kusht» n'ato pozita që ishin fituar gjer atëhere.

Pasi qe qfarosur krejt kollona naziste që vinte nga Elbasani, pa arrijtur të hynte në Tiranë, me përjashtim të ca bishturirave që mundën të shpëtonin dhe që, kur erdhën në Sheshin Skënderbej, nuk po dinin nga t'ja mbanin, forcat partizane, në mëngjezir e gjashtëmbëdhjetë nëndorit, do të hidheshin në sulm të përgjithëshëm.

Jorgji dhe Kamberi nuk qenë ndarë asnjëherë nga njëri tjetri. Kishin pesë ditë e pesë netë që nuk dinin ç'ishte gjumi, ç'ish urija, ç'ishte të ftohtit. Lufta i kish bërë tym nga koka. Por gjithëmonë gjakftohët, me mënd në kokë e me sytë gjarpër, qëllonin sa po që ua shihrin synë nazistëve.

Në sulmin te llogoret e Kishës së Shër Prokopit, Jorgji ishte hedhur i pari. Pasi pat vërtitur njëzet e pesë granata njerën pas tjetrës, i kishte shkulur nga vëndi nazistët dhe vetëm për vetëm iu kishte zënë dy topa 67/17 mm. në gjëndje të mirë. Që natën e parë partizarët e këtij sektori përparuan gjer te Fusha e Shallvares, çliruan pallatet e mëdha të nëpunësave, ca gazerma afër tyre, kapërcyen Lanën dhe iu afruan Ministrive. Të nesërmen më njëmbëdhjetë nëndor, Kamberi, duke parë se një mitrolos shtinte nga ballkoni i një shtëpije e nuk i lirte të bënин këmbë, kishte dalë vullnetarisht, i patën vajtur pas edhe katër partizanë të tjerë, e kishin sulmuar atë shtëpi dhe i pat vajtur mitralierit nazist befasisht në ballkon. Si u kacafyt me të

trup me trup, më në furd e flakëriti nga ballkoni e përposh
dhe rrëmbeu mitrolozin gjerman më krahë. Që andej u
kishte bërtitur shokëve, kur i kish parë që qenë ngritur e
po sulmonin:

— Përpara partizanë!

Duke përparuar nga njëra shtëpi e nga njëra rrugë në
tjetrën, Jorgji dhe Kamberi, gjer më datën gjashtëmbë-
dhjetë nëndor, patër arritur mu afér Bankës Kombëtare.
Edhe aty, mu përpara Bankës, nëpër breshërin e plum-
bave që u vinin nga fortina në mes të sheshit të Bashkisë,
dy ditë përpara iu patën vënë zjarrin tri maqinave t'ar-
mikut, që dorin të çanin rrugën për nga Bulevardi
Kavaja.

Natën e gjashtëmbëdhjetë nëndorit nazistët i kishin
vënë zjarrir: një shtëpije në rrugën e Kavajës. Populli i
krahut të djathë të kësaj rruge donin të hidheshin rë
anën e majtë; pastaj të kalonin në pjesën e çliruar. Në
mëngjesin e kësaj dite do të fillonte sulmi i përgjithë-
shëm. Atë natë Jorgji ndihmoi gratë e fëmijët, që kishin
dalë rrugëve dhe ulërinin. Një grua kishte djalin trem-
bëdhjetë-katrëmbëdhjetë vjeç matanë rrugës dhe nuk
po e merrte dot. Ai kishte këmbën e djathëtë të tarrë në
allçi se qe plagosur si viktimë disa ditë më parë. Plumbat
që vinin si breshër nga fortina para Bashkisë, të korrrnin,
por mbi një metro nga sipërfaqja e rrugës, më posht, nuk
të zinin. Jorgji, barkaz e barkaz u hodh përtej. Nënën e dja-
lit e mësoi si të kalonte dhe vetë mori një derë të shqyer,
shtriu djalin mbi të, hoqi rripin, e lidhi d'rën dhe duke e
tërhequr e shpëtoi nga vdekja e sigurtë.

— Bir, të pastë jot' ëmë! Rrofshi e gjëzofshi të rit
tuaj! Gëzofshi Shqipërin e Lirë, bir! — uronte nëna e
djalit të plagosur.

Ndaj të gdhirë urdhëri për sulm u dha. Përlleshja ti-
lloj, çlrimi i Tiranës tashti u bë çështje orësh.

Jorgji rrëmbeu mitrolozin. Plumbat e fortin nu: të
linin të nxirrje as vetullën. Atëhere të dy me Kamberin,
muarën nga një gur të madh, e vunë përpara dhe, duke
shtyjtur gurët e duke u zvarrisur pas tij, shtinin e përp-
ronin.

Në rrugën «28 Nëndori», te Sahatit, te Xhamitja e Vjetër, që brënda Bashkisë, poshtë nga Shtëpija e oficerave, nga rruga e Durrësit, lufta zjente si edhe këtej nga ana e Bankës Kombëtare. Në këta vende qe përqëndruar tërë përleshja e fundit. «Tiranën do ta çlrojmë me çdo kusht». Ky ishte urdhëri i Shtabit Operativ që në fillim. Ky ishte urdhëri i Partisë qysh se u rrethua Tirana. Nga çlirim i shpejtë i Tiranës varej fitorja e fundit. Dhe partizanët këtë urdhër po e çonin në vënd me nder. Për disa orë, gjer në mbrëmje, gjer të nesërmen në mërgjes fundja, Tirana duhej të buçiste nga kënga e fitores, të shkëltente nën flamujt e çlirimit.

Gëzimi i çlirimit fë kryeqytetit te Jorgji ishte i dyfishtë. Ai do të takonte nënën, motrën, vëllanë... Sot, as ai nuk e dinte përsë ruk i hiqej nga mëndja një kujtim i largët: kur ishte i sëmurë një verë nga ethet, i qe shtirë pér një simite të ngrohët me bugaçë siç i bëjnë edhe në Elbasan, por s'ëmës nuk i pati kërkuar, se e dinte me sa mundim e nxirrte ajo bukërit e tyre. Një natë Lena e kishte dëgjuar tek e kishte kërkuar duke folur perçart. Të nesërmen kishte vajtur të lante rrobat e zonjës së tregëtarit të madh fqinjë, e kur u kthyte, i pruri simiten. Mirëpo, ca nga firja e ca nga të ferkuarit e rrobaive, i qe çarë misht e gjishtrinjve thela-thela e i rrithnin gjak. Me atë gjak qe lyer letra ku qe pështjellë simita. Jorgji, sado me nepsin e etheve pér atë simite të ngrohtë, mezi e kishte ngrënë.

Këtë kujtim kishte përparrë syve edhe në këtë çast, e malli pér të puthur ato duar t'asaj rëne të vojtur e kishte pushtuar, kur një grup nazistësh, që kishin luftuar nga godinat e Kafe Londonit, duke mos i qëndruar dot sulmit të partizanëve t'atij krahu, lanë vëndet dhe dorin të hynin në godinën e Bashkisë. Derën e pasme nuk e hapën dot dhe deshën të hynin rga dera e përparme. Jorgji ja shkelë këmbëzën mitrolozit dhe një karikator i tërë palosi nazistët nëpër shkallët e jashtme. Njeri prej tyre arriji gjer te dera, por atje hapi një herë krahët, u dha sa djathtas majtas, dhe pastaj ra më kurris me krahë hapur e me kokë tatëpjetë.

Kur pa Jorgji që edhe atë të fundit e shtriu, thirri nga gëzimi:

— Përpara partizanë! Përpara partizanë!

— Hap sytë Jorgji! — Iu kanos Kamberi duke patitur frikë se nios shoku i tij nga gëzimi i fitores, u zbulohet predhave që i vërvshëllenin e që i shkreptirin te guri që kishte përparrë.

Kryeqyteti, më 17 Nëndor në mëngjes u çlirua.

Tetë ditë me radhë, që nga dita që mori vesh se Jorgji kishte ardhur në rrethimin e Tiranës, Lena e priti të birin orë e çast që ta takonte.

Gjatë atyre tetë ditëve, ajo nuk mori asnjë lajm për Jorgjir. Në mesditën e datës tetëmbëdhjetë nëndor, Ylli si kurdoherë, kishte pyetur një partizan nëse e njihet apo jo Jorgji Marangozin dhe partizani e kishte puthur e i kishte thënë:

— Jo, unë nuk e njoh. Por atë e njohin të gjithë partizanët. Pastaj e kishte pyetur: A di të lexosh?

— Po, di, — i ishte përgjegjur si me turp Ylli.

Partizari kishte nxjerrë buletinin e luftës e i kishte thënë:

— Na këndoje këtu se çfarë thotë për vëllanë tënd. Ylli e kishte kënduar dhe pastaj i kish thërë:

— A do ma falësh mua këtë të vete t'ja këndoja masë? Ose hajde në shtëpinë tonë edhe ti, këndoja masë dhe merre prapë.

— Nuk vij dët, po ti merre se ta kam falur, — i ishte përgjegjur partizani.

Ylli kishte fluturuar nga gëzimi e i kishte thirrur s'ëmës:

— 'Mama!' një lajm për Jorgjir!... Mama!

Në buletinin e luftës thuhej: «...Më datën 16, në mesditë, partizani Jorgji Marangozi, përgjegjës i rinisë së-

bataljonit, në të hyrë të rrugës së Kavajës, gjendet ballë për ballë me një tanks t'armikut, në të cilin qerë pesë agjentë të gestapos që mundoheshin me çdo kusht të shpëtonin. Në mes të tij dhe tanksit nis një luftë e rreptë. Bisha e hekurt naziste ruk e përkuli partizanin tonë. Ai dhe shoku i tij Kamber Isufi nuk e lanë tanksin të çante përpëra gjersa predhat e artilerisë sonë i vunë flakën».

Lena e mori buletinin, e futi në gji dhe rrinte sa rrinte e ja ipse Yllit ta lexorte përsëri. Pastaj mejtohej: «Buletini thotë: «Bisha e hekurt nuk e përkuli partizanin tonë». Mirëpo pse s'thotë q'u bë Jorgji? Mos më është vrarë djali mua së zezës?!». Pastaj prapë i jepte gjajtjet vehtes: «Sikur t'ishte vrarë do ta thoshte buletiri, siç thotë përkëta të tjerët».

Dhe Lena e priti Jorgjin ditë me radhë që t'i kthehej në shtëpi, ta puthte. t'i vinte kókën në gjoksit, t'i përgëzonte flokët... Teshat e tij, që ja pati bërë gati ta ndërronte sapo t'i kthehej, i mbajti ditë me radhë mbi tryezë e i palosi e i çpalosi darkë e mërgjes; jatakun e Jorgjit, të shtirë e të larë, që t'ja shtronte për t'i rënë brinjët rehat, nuk e luajti nga fundi i dhomës, ku e pati vënë përditë me radhë; e ditë me radhë priti me veshët ngritur duke përgjuar rrugën natë e ditë mos i ndjente këmbët kur të vinte. Por ai nuk u lthyen më. Në mërdjen e në zëmriën e nënës mbetën vetëm fjalët e buletinit që mbante në gji: «Bisha e hekurt nuk ka përkuli partizanin tonë».

NËNË SABRIJA

Gjermanët e ballistët kishin dymbëdhjetë ditë që e kishin pushtuar Zharanin dhe po bënин si mundnin. Të dymbëdhjetën ditë, një pasdreke heret, Nënë Sabrija dhe Nënë Shefikua po rrinir njëra në një kënd, njëra në këndin tjetër të ashefit të përdhesëshëm dhe po menjoheshin. Nënë Shefikua kishte zënë mashën me të dyja duart, kishte pshtetur ballët mbi 'të dhe rrinte përbys pa e ngritur kokën asnjë herë. Kurse Nënë Sabrija, me kokën pshtetur pas oxhakut, mbërthyer sytë nga dritarja e vogël, vështronë nga malet për karshi. Dy rrudha të thella në ballë dhe vullat e vrejtura tregonin se në shpirtin e saj vlorët një urejtje dhe rjë zëmërim që nuk mundëte ta përbante dot.

Hyskë Gjini, një nga komandantët e ballit kishte kontrolluar edhe sot në mëngjes që me natë në shtëpinë e Nërrë Sabrijes duke thirrur e bërtitur:

— Kush u shpije bukë partizanëve? Ku janë fshehur partizanët, se ju thera të gjalla, do t'u përvëloj si miun brënda!... Tregoni!...

Ai nuk kishte lënë vrimë pa u futur e nuk kishte lënë gjë më këmbë. I kishte rënë era se në pyllin përtej Zharrarit kishte ca partizanë të fshehur dhe se buka iu vinte nga Zharanakët, po se kush ua conte nuk e dinte. Dyshimin e tij më të madh e kishte te shtëpija e Nënë Sabrijes. Në pyll ose në shtëpinë e Nënë Sabrijes, i kishte thënë spiuni, gjendej i fshehur edhe Koci Papa, komisari i Komandës së vendit, të cilin Hyska edhe pjekur ta shihet nuk ngihej me 'të. «Komisarët janë komunista», thoshte. «dhe ata e kanë ngritur popullin. Pa çdukur ata nuk çkulët fara e komunizmit....».

Nga kontrollimi i Hyskë Gjinit me shokë ashefi i Në-

në Sabrijes qe bërë rrëmujë. Ngado që të hithje sytë shikojë qypa me turshi të thyer, kadishte e talëra të përmby-sura, enë të flakura, ku ishte tigani nuk ishte tepsija, dhe magjes i kishin thyer këmbëzat e qe shtrëmbëruar.

Të dy kunatave nuk iu bënин duart as për të rregulluar, as për të fshirë e spërkatur. Ç'të rregullonin! Gjermanët e ballistët do të vinin përsëri, do të kërkonin, do të kontrollonin, do të thyenin, do të rrëmbejn c'u kishte mbetur ndonjë gjë e vlejtur, se të shumtat e plaçkave: qili-ma, jorganë, gjyma bakëri.... ua kishin plaçkitur që ditët e para, dhe prapë do ta bënин rrëmujë shtëpinë.

Verija, një vajzë e vogël nj'a shtatë a tetë vjeçë, e zbeh-të në fytyrë e me sy të mbufatur, kishte vënë kokën rë gju të Nënë Sabrijes dhe dukej sikur flinte. Një bukë misri, që Nënë Sabrija e kishte shtirë para një gjysëm ore, po piqej në vatër nënë saçin dhe jamakja me fasule po ziente në zjarr.

Më në fund Nënë Shefikua e theu heshtjen e para. Ajo ngriti kokën dhe duke shtrënguar gjithnjë mashër ndër duar, sikur të mbahej në të nga një lodhje e madhe që ndjente, i tha së kunatës:

— Të zezat ne, Sabrije o motër, ra u mbyll dera, mbetëm kërcure pa asnjë mashkull në shtëpi! — Pastaj vësh-troi të bijën, Verijen, dhe vazhdoi: — Mbetëm me një copë çupë në shtëpi ne të zezat!

Verija i hapi sytë dhe me buzët vesh më vesh, zuri-të qante përsëri e zvetëtar.

— Mjaft, de, mjaft me këtë kob që po i ndjell shtë-pisë! Mjaft të thonë, se zvetëtove edhe këtë foshnjë! — i foli Nërë Sabrija. — Nuk të vjen keq për 'të?! — Pastaj vazhdoi: — Mos ki merak, se si petritë i kemi djemtë; ja atje janë, — dhe ja bëri me dorë nga malet për karshi dri-tares nga ndihej gjëmimi i luftës. — Atje janë. Edhe në qoftë vrarë ndonjeri, vdekja për burrat është, të gjithë nuk do të shuhën. Me nder po vritten e jo me turp. Pa edhe rë qofshin shuar ata, neve pse jemi? Një plumb do të dimë ta zbratzim sa t'u marrim hakër. Por unë nuk ua kam më-rakun atyre që janë të shëndoshë, sa ua kam më-rakun kë-tyre që kemi këtu, — dhe tregoi me dorë pyllin për kar-

shi Zharanit. — Se këta janë të plagosur, të sëmurë e nuk luajnë dot as këtu e aty. Ja kam mërakun atij të ziu Koci, që i ka mushkëritë byk, që ka dymbëdhjetë ditë në dëborë; është me një vatër fëmijë korbi!...

Duke folur kështu Nënë Sabrija ngriti saçin, pa bukën nëse qe pjekur apo jo dhe i hodhi edhe rjë herë prush nën 'të e mbi 'të, duke mallëkuar me vehte:

— E shkretë, piqu edhe ti mos u pjeksh kurrë, se ja u ngrys dhe ata të zes kanë tridhjet e gjashtë orë pa futur erën e gjësë në gojë!

Atë bukë Nënë Sabrija e kishte hedhur për t'ia shpurë Koçi Papës, që ndodhej i fshehur në pyll vet' i shtatë, që të gjithë të plagosur e të sëmurë, e që ishin shkëputur nga shokët e spitalit partizan të qarkut në një përpjekje që patën një natë me gjermanët e ballistët. Në tërë atë të keqe, në tërë atë frikë e sori, Nënë Sabrija, nëpër këmbët e gjermanëve e të ballistëve, u pati shpurë tri a katër herë bukë gjatë atyre ditëve, duke vajtur natën e me qefin nënë sqetull. «Sot, — mendonte ajo — riuk do ta kishte aqë zor, sepse gjermanët e ballistët qenë tërhequr që në mëngjes. Në fshat kishte mbetur vetëm Hyskë Gjini me njëzet ballistë nga ata larot që i mbante pranë». Prandaj ajo po nxitonë që të piqej buka e t'uа conte herët sapo të zirtë të errej.

Nënë Shefikua, tek e vuri re të kunatën që nxitohej ta piqte bukën sa më shpejt, i tha edhe atë mbrëmje si gjithmonë:

— Do të na marrësh më qafë Sabrije o motër. Tërë ditën Hyska sot ka ndenjur me dylbi në dörë gërmadhave dhe ka ruajtur. Edhe tani kushedi se ku do të jetë futur më ndonjë ferrë e rri e përgjon, po hap sytë motër, Sabrije!

Si me shaka, si me të vërtetë, Nënë Sabrija iu përgjegj:

— Rri ti, rehat. A po të kërkon njeri gjë ty? Jo. Rri ti, se unë as të kam thënë as të them ty për t'uа shpurë; jam gjallë vetë unë, dhe sytë i kam në ballë. — E duke i shërbyer bukës që të piqej sa më parë vazhdoi të fjaloj se me vehte, por që ta dëgjonte edhe Nënë Shefikua: — Nuk kam parë unë sa frikë ka ky fob! (e kishte fjalën për

Nënë Shefikon) kur ruk vdiq kjo këtë radhë nga frika, ta dini që nuk ka për të vdekur kurrë.

Shefikua, që e dëgjoi, iu përgjegj:

— Eeeee, ashtu thua ti, po të vrasin ata, nuk ta bëjnë të gjatë. Dhe si të vrasin se, ti e ke parë, ta nxjerrin shpirtin me thika. Nuk janë njerëz ata.

Dymbëdhjetë ditë e dymbëdhjetë netë Nërë Shefikua nuk qe shtruar një herë në sofër.

— Ha, moj, ha, — i thoshte Nënë Sabrija, — nga inati ha, dhe mos e bëj qejfin qeder; ç'të dinë le të bëjnë, se nga frika vetëm një në Durrës ka vdekur. Të gjithë popullin ruk do ta shuajnë dot sikur qiellin të zënë me dorë.

Një ditë, gjatë atyre dymbëdhjetë ditëve, kur binte një déborë e madhe me flokë, — si atë dimër e jo më, — dhe bënte një të ftohët i madh, një ballist i veshur me brekushe, si dukej qe këtej nga Sulova, kishte vajtur të ngrohte duart pas zjarrit në ashek të Nënë Sabrijes. Duke ungrohur me rëmbim në bisht, se mos e pikasnin dhe e qërtorin se ishte roje, e kishte kërcënuar edhe ai Nënë Sabrijen:

— Ku i kini burrat juve?!

Nënë Sabrija, që i kishte ardhur shpirti në majë të hundës nga të zezat që iu kishin punuar e nga meraku që kishte për meshkujt e shtëpisë, i ishte përgjegjur pa shikuar në sy:

— Ja atje janë! — dhe ja kishte bërë me dorë duke i treguar malet. Ç'na pyet ne ti! Ju e dini më mirë se reku janë, se me ju po luftojnë ata!

Ballisti kishte tundur kokën, sikur donte të thoshte me atë shenjë: «Kam parë e s'kam parë, por të tillë gruanuk më kanë zënë sytë», sepse ai kishte vënë veshin që Nërë Sabrija ashtu i qe përgjegjur kujtdo që e kërcënonte, në daç të ishte komandant gjerman, në daç të ishte nga ata lapangjozët, siç i quante ajo komandantët ballistë. Nërë Shefikua, kur shikonte që ajo iu përgjegj n'atë mënyrë, i lutej me zë të ulët:

— Mos, moj Sabrije o motër, mos se kushedi ç'të zeza të tjera do të na punojnë.

Por ajo i çkrehej:

— Rri ti, se e di unë si më nginjet barku me këta katala. Po dale, dale sa të mbushet ena mirë.

Duke folur kështu zbehej nga zëmërimi. Fytyra e saj dukej e egërsuar, dhe e mbyllur ashtu n'atë qilar me rojet e dera, ngjante si luar në kafaz. Asaj i shoqi i qe vrapë gjashtë muaj më parë në një përpjekje me ballistët. Djalin e vetëm e kishte partizan. I kunati, Mazllëm Gjatoilari, i shoqi i Shefikas, më gjithë të dy djemtë, edhe ata ishin partizanë. Katër meshkuj kishte shtëpija, po të katër kishin një muaj e ca që nuk i dinin se kù ishir, asnjë lajm nuk kishin prej tyre. Operacioni i dimërit kushedi se nga i kishte zënë.

Ballistët, ditë për ditë, mblidheshin te lëmi përpara ashefit, nga njëzet e tridhjet veta, dhe fjaloseshin me zë të lartë, me qëllim që t'i dëgjorin të dy gratë:

— Partizanët u shuan të gjithë, nuk ka mbetur këmbë prej tyre. Filan komendant partizan e zunë të gjallë dhe e varën në mes të Tiranës përpara bashkisë. Filan komendant brigade e r'dau gjylja e topit gjerman më dysh...

Ndonjë tjetër hidhej e thosh:

— Sot u gjetën shtatë partizanë lart në mal. Kishin vdekur.

— Ehe, me të vërtetë, i pashë edhe unë, — hidhej shoku i tij, — dy prej tyre kishin patur guna të dhirta. Nga dy gjerdhanë fyshekë kishin patur secili...

Ky i dyti i jepte këto hollësira me qëllim që ta përforonte më shumë fjalën e të parit.

Nënë Sabrija dëgjorte dhe nuk e bënte vehten, por përbrënda shpirti i saj e dinte sa vuante. Po sikur t'ishin të vërteta ato që thoshir ballistët? Prandaj edhe i jepte të drejtë Shefikos. Nënë Shefikua përkundrazi, kur dëgjonte ato fjalë rrihej e përpiquej më keq:

— E zeza, djemtë tanë kanë guna, ata kanë maliherë të gjatë dhe nga dy gjerdhanë fyshekë!

Zharani ishte në mes vëndi n'atë krahinë, prandaj edhe gjermano-ballistët e kishin bërë qendër të tyre. Ditë e natë atje kishte lëvizje të madhe, një palë vinin, një palë ikrin. Shkarkonin karvanet me fyshekë, ngarkonin mallin e plaçkitur në popull. Natën — asnjë herë ditën — sillnin

të plagosurit e tyre, cirreshin e ulerinin si çakej. Nga një herë zinin ndonjë partizan të sëmurë ose të plagosur dhe e pushkatonin në mes të fshatit, duke u mburur sikur kishin bërë ndonjë trimëri të madhe.

Këto mizori të ballistave e të gjermanëve kundër atyre që kishin lërë shtëpinë, fëmijët, nënën, babanë, vëllezër e motra vetëm e vetëm që të çporesh duşhani, kishin ngjallur te Nënë Sabrija një urrejtje të atillë për armikun sa që i rëndëshin sytë e nuk i shikonte dot. Nga Koci e nga shokët e tij nuk i hiqej mërdja për asnje çast dhe mejtonte: «Mos Zot, po sikur t'i gjejnë? po sikur t'i zënë të gjallë e t'i pushkatojnë?» I ngjethej misht, zinte sytë me dorë si për të larguar këto mendime të kobëshme dhe thoshte me vehte: «O zot, merrna hakën!».

Atë mëngjes, ditën e dyshëdhjetë, kur ikën gjermanët e ballistët nga Zharani, hapën fjalën se gjoja ishte gjetur një depo e madhe e partizanëve dhe do të vinin ta ngrinin. Shumica e ballistëve këtë gjenjeshtër e kishin besuar si të vërtetë. Krerët ballistë me të tilla gjenjeshtra i shpinin rë luftë ata që iu vinin pas ose që i merrnin ushtarë me zor, por populli i Zharanit nuk e hëngri. Gjermanët e ballistët diç kishin ndjerë, ata nuk shkonin të ngrinin «depor e madhe», se ku e gjetën partizanët këtë depo? por shkonin të luftonin. Dhe me të vërtet, ashtu si mendoi populli qe. Katër pesë orë pasi qenë larguar gjermanët e ballistët nga Zharani, filloi të ndihej uturima e luftës larg e thellë prapa maleve. Këtë luftë e pati ndjerë edhe Nënë Sabrija. Herë pas here, duke ndenjur prarë oxhakut, mbante vesh e dëgjonte dhe zëmra i rrihte prej gëzimit. «Ishalla, luste me vehte, «ishalla i thyejnë sot e nesër këta qenë, e të shpëtojmë...» Dhe aqë sa gëzonët për vehte, për shtëpinë, për meshkujt që kishte në luftë e që do t'i vinin në shtëpi të piqeje me 'ta, t'i shihte e ta shihnin, po aqë gëzonët edhe për Kocin me gjithë shokët, të cilët vetëm ajo që i kishte parë me sytë e saj e dinte si qenë bërë: tharë e nxirë si kandili, sa të vinte frikë t'i shikoje.

Buka donte edhe pak të piqeji. Ajo mendoi që, si ta hiqte nga zjarri, ta linte edhe pakëz në dritare sa të ftohej, se ashtu e ngrohtë thërmohej, e pastaj me të errur do të

risej t'ua shpinte Kocit me shokët. U ngrit, gjeti një copë rrobë të zezë, pshtolli veshët me të si në vënd të sharpit e po mendohej çfar të merrte si gjellë për partizanët. Po ata të zes gjermanë e ballistë nuk i patën lënë gjë në shtëpi, as gjizë, as djathë, gjë prej gjëje, se edhe ato gjëra ushqimore që nuk i hëngërn, ua derdhën katonjve e rrugëve.

Dielli ishte ulur fare dhe qe gati rë të perënduar. Horizonti skuqte. Një copë diell në formë katrore binte në mes të ashefit, duke kaluar nga baxhaja, që ishte rë faqen e çatisë nga perëndimi. Në këtë kohë «fup» hyri në derët Koci me malher në dorë, i gjatë, i thatë, me sy të zhgaberryer e qëndroi në mes të ashefit. Fytyra e tij e murretyer, kur i ra dielli që vinte nga baxhaja, iu duk aqë e llahtarshme Nënë Sabrijes, sa që, kur iu thirri Koci krahë hapur në mes të ashefit: «Ku jeni moj motra?» dhe u derdh ië përqafqohej me 'to, ajo, me qypin e turshive që i mbeti ndër duar, mundi të thërriste vetëm kaqë:

— Koci!

Dhe nuk foli sepse dyshoi për një çast rëse ishte Koci me të vërtetë ai apo dikush tjetër, mbasi edhe zëri iu duk sikur i ishte ndërruar. Po pastaj e njohu, u lëshua drejt tij, i hodhi duart dhe e puthi. Pa ja hequr duart nga qafa e pyeste duke u dredhur e tëra nga malli e rga gjëzimi:

— Po ku jini o Koci, o vëlla?!

— Këtu jemi, motra Sabrike, këtu, — iu përgjegj edhe ai i mallëngjyer.

— A jini të gjithë? A jini gjallë?

— Të gjithë jemi, të gjithë. Gjallë jemi.

Nërë Shefikua ngriu në këndin, u shastis e më s'dinte ç'të bënte. Më në fund kur u ulër rreth vatrës ajo pyeti:

— Po djemtë tanë, o Koci, ku do të jenë? a do të jenë gjallë? të më thuash të drejtën, për kokën e fëmijëve!

— Kur të qaj djemtë, gjallë janë, — iu betua Koci tek e pa aqë të trishtuar. — Sot, — vazhdoi Koci, — muarrëm një letër nga Mazllëmi. Na lajmëron që nesër pa gdhirë t'u bjemë prapa krahëve ballistëve. Do t'i fusim rë kë o gryka mes dy zjarreve dhe do t'i bëjmë të ngrejnë duart përpjetë. Nesër në mëngjes do të shikosh se ç'do të bëhet në këtë pellgun tonë këtu. Ne të komandës së vendit jemi

mbledhur të gjithë në mal, te kasollat e barijve. Kemi lajmëruar edhe të gjithë fshatrat e këshillat. Me të bërë «bamp» në qafën e Pelës, lufta do të ndizet në të katër anët. A e dëgjoni luftën? A e kuptioni dot sa janë afruar tannët? Vetëm shenjën tonë presin fshatrat përqark.

Si ju dha lajmet mbi gjendjen e luftës, Koci i pyeti të dy gratë:

— A ka më ballistë në Zharan, se ne na erdhi lajmi që nuk ka mbetur rjeti prej tyre.

Ato i treguan për Hyskë Gjinin dhe të njëzet «trimal» e tij që ishin në shtëpinë e Hekuran Çepelës në krye të fshatit.

Koci kishte ardhur deri diku me mëndje të fjetur se nuk kishte më ballistë në Zharan, por tanë shpejt e shpejt kërkoi gjysëm buke dhe u ngrit e iku.

Nënë Sabrija me Nënë Shefikon, duke i dhënë bukën, e porositën një mijë herë të hapte sytë se mos përpiqte më Hyskën, se më s'dihej, mund t'ishte aty përqark. Pastaj e nxuarrë: nga dera e prasme e qilarit, e përcuallën prapa kasolleve, e hoqën nëpër një ledh gjer në fund të selishtes është e porositën edhe një herë:

— Koci, hap sytë, vëlla!

Koci mori buzën e përrojt, do të hidhej përtëj e pastaj do të ngjitej sipër në mal, mbi fshat, te shokët.

Nuk kishin shkuar as pesë minuta që kur qerë kthyer Nënë Sabrija me Nënë Shefikon në ashek, kur dëgjuan të çrrura:

— Ndal! Ndal!

Dhe pa sosur mirë këto fjalë u dëgjuan dy krisma malihershë që ranë këmbyerazi.

— Korba, se mos e vranë Kocin! — thirri Nënë Sabrija dhe fluturoi në gjurmët e tij. E gjithë bota iu duk stërrë dhe ruk pa përpara as ledhe, as gërmadha, as fera, as gjëmba.

Nënë Shefikua dërgoi Verijen të shikonte nëpër fshat se ku ishin ballistët.

Kur vajti Nënë Sabrija, Kocin e gjeti akoma me gojë:

— Më vrau Hyskë Gjini, o motra Sabrije, — i tha. — Amanet fëmijët! — Dhe mbaroi në kraharorin e saj.

Nënë Sabrija edhe sot thotë: «Ndofta prandaj ruk i kishte dalë shpirti se priste që të linte amanet fëmijët, që i kishte kokla korbi, si njerin tjetrin: dy çupa dhe tre djem. Më i madhi i tyre trembëdhjetë vjeç».

Me atë llahtar dhe me atë zëmërim, Nënë Sabrija u këthyte në shtëpi. Sapo arrijti, erdhi në shtëpi edhe Verija, e tmeruar, me sy të zgurdulluar e duke bërtitur:

— Moke moj! Moke moj! (kështu i thërriste Nënë Sabrijes) Hyskë Gjini me një gjysmë buke në dorë, po hyn shtëpi më shtëpi në lagjen tonë.

Komandanti ballist, apo e pa që ra Koci i vrarë, shkoi e kontrolloi. I mori gjysmën e bukës dhe si i marrosur, më shumë edhe nga thyerja e ballistëve që sa vinte po afëro-heshin, shkoi që të krahasonte bukëri për të gjetur se në cilën shtëpi ja kishin dhënë, dhe do t'i vinte zjarrin asaj shtëpije duke e djegur me gjithë njerës brënda. Kështu vendosi. Vajti në një shtëpi të lagjes së Gjatollarëve, ruk gjeti t'atillë mielli e t'atillë buke. Vajti rë një tjetër, i krahasoi, prapë nuk gjeti, edhe në të tretën po ashtu. Nga inati bërtiste e cirrej:

— Jo, jo, nuk ja kemi ngjitur kot emrin Moska e Vogël neve Zharanit. Si? Si?! neve të jemi këtu e ju nëpër këmbët tona t'u jepni bukë komunistave! Ah, veç në e gjeçat atë shtëpi që u ka dhënë bukë!

Shpejt e shpejt Hyskës iu kujtua shtëpia e Mazllëmit. «Atje do t'ua kenë dhënë këtë bukë, ato shtrigat kanë blojtur në mokra këto ditë, se ruk i linin të delnin. Duke kjo bukë, është gatuar me miell të ashpër». Kështu mejtoi dhe u nis i etur për gjak. Aqë iu prish mërdja nga urrejtja, sa që harroi se trimat për mbrojtje personale nuk i kishte më vehte. Trimave të tij, që iu pati thënë se partizanët mbaruan, atë ditë iu kishte hyrë frika në bark më shumë se çdo herë tjetër. Nga Zharani u nisën plot pese-qind ballista e gjermanë. Kuptohej se partizanët, që po luftorin kundra tyre e që i kishin thyer aqë shumë sa po i

afroheshin Zharanit, nuk do t'ishin të pakët. Ata e ndjenë gjallë se partizanët ishin akoma më këmbë. Prandaj kishin dalë të gjithë në krye të fshatit e po bënин llogari që, sidomë të birte puna, të kishin kohë t'ua mbathnin këmbëve.

Nënë Sabrija, me të dëgjuar Verijen që tha se ç'po bënte Hyskë Gjini në lagjen e tyre, e kuptoi se përse bridhëte ai shtëpi më shtëpi. Prandaj u prish në fytyrë, po në shtëpi e saj dukej që kishte vendosur diçka të bënte.

— Merr çupën dhe ikë, — i tha shkurt Nënë Shefikos.

— Ku të vete?! — iu përgjegj e kurata. — Ku të të lëmë ty?!

— Merr çupën dhe ikë, të them, — iu kërcënuar Nënë Sabrija përsëri.

Mollëzat e faqeve po i dridheshin vetvetiu pa pushim.

— Po do na gjejë bukën.

— Ikë, — i tha më në fund dhe e mori e shtyjeti përkrahur.

Nënë Sabrija, si mbeti vetëm në ashef, u kërrus, diçka mori në fund të qilarit, pasi ngriti një pllakë të gurtë, ho-dhi krahëve një triko të gjatë, të bërë me shtiza, dhe u ul në këndit. Duke i vënë shpatullat murit si e kapitur, mbështeti kokën pas oxhakut dhe po vështronë nga dera. Të gjitha shkresat që i dha Koci kur dha shpirt i kishte futur në gjji.

Hyskë Gjini hyri me gjysmën e bukës rë dorë, të lyer me gjakun e Kocit. Nuk shikoi as tej as këtej, por shkoi drejt e në magjet. Sapo krahasoi bukën iu kthye nënë Sabrijes dhe uluriti duke u dredhur i téri:

— E kujt éshtë kjo buuuukë?!

Ajo u ngrit më këmbë, ashtu e gjatë siç ish, me duart prapa, mbuluar me trikonë, me sytë të ftohët si xham, dhe si hodhi dy-tri hapa e u afrua përpëra tij i tha:

— Imja éshtë.

— Bushtër, ndaj të thonë partizanët «Nënë Sabrija» ty, rdaj të thonë! — dhe gati t'i hidhët thonjtë ta mbyste

— Po, ndaj më thonë, — iu përgjegj ajo e qetë e plot urejtje. — Ndaj më thonë, se nënë më kanë, dhe mos më

thëncin nëra e tyre po nuk ua mora hakun. Dhe «fapja bëri si vetëtimë nagartit të të shoqt, që e kishte ruajtur si kujtim të tijnë pas vrasjes. «Tak» «tak» ja shkrepit dy herë në gjoks.

Hyska ngriu për disa sekonda më këmbë, iu prish mëndja, ca nga që nuk e priste atë që bëri Nënë Sabrija, ca nga ajo që e gjeti, por pastaj e mbledhi dhe e ndoqi me rovole në dore.

Nënë Sabrija mbar mënd nga ajo skenë vetëm këtë:

Hyskës i rrithte gjaku mbi xhaketën e re ushtarake italiane nga dy plagë të gjoksit. Hodhi nagantin përdhe dhe tha vetëm kaqë:

— Mallkuar qofshi, se muarët botën në qafë!

Kur dolli në lëmë, Shefikua iu dha përpëra me sy të shqyer:

— Ç'bëre? — e pyeti.

— E vrava! — iu përgjegj ajo prerë..

Muarën çupën për dore dhe u nisër. Vendi ku ishin shokët e Kocit e dinin se ua kishte treguar vetë Koci.

Hyskë Gjini ruk mundi të hidhët veçse dy tri hapa tej pragut të derës së ashefit dhe u këput e ra përbys sa gjatë gjérë.

Hidh një shami përdhe. — i tha Shefikua sipas zakonit, tek ishin duke bredhur, — se mos të të zërë gjaku?

— Jo, jo, nuk më zë gjaku i tradhëtarëve mua, — iu përgjegj Nënë Sabrija, së cilës i rrinte përpëra ftyra e Kocit të vrarë, që i bëhej sikur i thoshte gjithënjë: «Amanet fëmijët».

ZOTËR TË TOKËS

Në lokalitetin Dubas të rrëthit Frashër grupi i reformës agrare që iu ndante tokat e bejlerëve fshatarëve të varfër, aty nga fillimi i javës së parë të rëndorit të vitit 1946, pas dy muaj e ca pune, ishte duke u dhënë fund punimeve të tij. Fshati i fundit që mbetej për të shkuar ishte Sheqi.

Në mbrëmjen e datës gjashtë nëndor, grupi i reformës agrare shkoi edhe në Sheq. Edhe grupet e tjera, që punonin në lokalitete të tjera të Myzeqesë, në këtë kohë, po kështu ishin: kush kish mbaruar fare, kush kishte edhe dytri ditë punë e kujt i kishte mbetur edhe një fshat pa vajtur.

Në komitetin e fshatarëve të varfër të Sheqit ishte Mëtanit i Shaqos, Sabriu i Refatit, Liçi Zonja, dhe Refije Go-rezi.

Natën e parë, megjithëse grupi i reformës agrare vajti vonë, lajmi u përhap sakaq në fshatin. Secili nga buqit e Sheqit nxitohej t'i takorte i pari. Në darkë shtëpija e Mëtanit, ku qëndruan shokët e grupit të reformës agrare, zjeu nga hyrjet e daljet gjer në ora dhjetë të natës. Edhe fëmijët shkuan t'i shikonin.

Kur vajti Refija në shtëpi, xha Rapushi, i vjerri, e pyeti:

- E moj nuse, sa veta janë?
- Tre janë, o baba, — iu përgjegj e reja.
- Do të vete edhe unë t'i takoj, — tha xha Rrapushi.

Po e reja e ndaloi:

— Rri, baba, ku do të vesh tani natën, është terrët. Xha Rrapushi ndëjti, si mbi gjëmba. Nuk e linte mëraku, donte të vinte t'i takonte e të bisedonte me ta. Atë natë ndehti gjer vorë pranë vatrës, menjtohej. Atij iu kujtua, edhe këtë natë si gjithmonë, një amanet që pati lënë i biri me gojë përpëra se të jepte shpirt. Vrau mëndjen

gjithë natën nëse do t'iа linte reforma agrare apo jo Kuqickën, atë arë që i biri e pati larë me gjakun e tij, e ku si për kujtim, atje ku i pati rënë gjaku, ishin hedhur një grumbull gurësh sipas zakonit. Edhe atë çikë gjumë që fjeti atë natë, me ëndërra e bëri. Në mëngjes i dolli gjumi me dy-tri orë natë, bëri një flakë zjarr, priti gjersa ra drita, mori shkopin dhe qe i pari që vajti që në mëngjes te Metani.

— Urdhëro, urdhëro, xha Rrapush, — e ftoi Metani, pa lënë hunjtë që kish filluar të gdhëndëte që me natë e që do t'i duheshin për caktimin e kufijve.

I thirri së shoqes t'i bënte një sherbet xha Rrapushit, dhe pritën përjashta gjersa u ngritën shokët e grupit të reformës. Gjatë asaj kohe gati tërë fshati, me të mëdhenj e të vegjël, ishte pshtjellë në oborrin e Metanit.

Gjithë ditën grupi i reformës agrare bashkë me komitetin e fshatarëve të varfér shkelën tokat e Sheqit, bënë studimet paraprake, mbajtën shënimet e duhura. U çlodhën vetëm kur hëngrën ato dy kafshita bukë në drekë; edhe ato në ara i hëngrën dhe më këmbë e më duar. Gati tërë fshati shkonte pas tyre. Të gjithëve u queshte fytyra Qeshnin me njeri tjetrin, bënë shaka, këndonin. Shokët e grupit të reformës iu thanë se që të nesërmen do të fillonin të ndanin tokën. Xha Rrapushi nuk u nda prej tyre. Gjithë ditën, me shkopin në dorë, duke ecur ashtu i kërrusur sigish, me ato këmbët e holla e të gjata, të kthyera kular, poçelik, i ndoqi arë më arë dhe i ndihmonte:

— Po, po, — iu thoshte. — kjo arë dhjetë dynymë është, e di unë, po bëhem nëntëdhjetë vjeç në këtë fshat.

Dhe me të vërtet, kur e matnin ajo aqë delte. Jo vetëm për këtë, por ai i ndihmonte edhe për t'u treguar se cila arë ishte më pjellore se tjetra.

Atë ditë koha qe e bukur. Që në mëngjes, toka nisi të avullonte nga rrezet e ngrohta të diellit dhe një erë jeshillëku vjeshte e përzjerë me atë të kashtës së kalbur të hambulloreve të binte fytyrës si e vakët. Nga dreka duallën ca re të bardha e të mëdha rrëth e qark horizontit. Fshatarët herë pas here, duke shkuar grumbull arë më arë, ngrinin kokën lart e thoshin:

— Ç'ka marrë ky mot i bukur, besa besën si një behar i vogël po kalon kjo vjeshtë!

Pa ndonjeri, fshinte mustaqet e varura gjithë i kë-naqur e përgjigjej me zë të lartë, si për të dëgjuar të gjithë:

— Ashtu siç qeshin sot zëmrat tonë, ashtu bën edhe moti, behar shqyr. A e dini se sot gëzojnë edhe gurë e drurë, ore, e jo robi i Zotit. — Dhe duke folur ngrinte dorën dhe tundëte shkopin si për të treguar se ashtu ishte siç thoshte ai. Të gjithë ata që e dëgjonin e pohonin në mënyrë të heshtur, me një gëzim të madh që u këndohej në fytyrë.

Në mbrëmje, kur u err e nuk dukej as për të mbajtur shënimë, as për gjë, grupi i reformës agrare shkoi në shtëpinë e xha Rrapushit për darkë.

— Nuk ju lë unë, — rguli këmbë ai, — se vjen Idrizi nga lokaliteti dhe më bën rrezil po të mos ju marr në shtëpi. I kam çuar lajm edhe Idrizit të vijë sot.

Idriz Gorezi ishte kryetar i këshillit popullor të lokalitetit dhe xha Rrapushi e kishte nip, djalin e të birit.

Xha Rrapushi ngulte këmbë, sepse të gjithë fshatarët donin t'i merrnin për darkë shokët e grüpuit.

Si shkuan në shtëpi e si u çlodhën pakë, shokët e grüpuit të reformës agrare bashkë me ata të komitetit të fshatarëve të varfér, filluan të punonin me kandil duke bërë planin e ndarjes.

Në këtë kohë arriji edhe Idrizi, por nuk qëndroi, vetëm sa u takua me ta dhe, si mori me vehte edhe pesëmbëdhjetë veta nga fshati të armatosur, iku.

Rrugës atë e kishin lajmëruar se Agush Beu, vet'i pestë, që qëndronte akoma i arratisur, ish diktuar dhe dihej ku ishte atë natë. Prandaj kishte lajmëruar togën e mbrojtjes, që ishte në ndjekje të krimirelëve të luftës n'ato anë. kishte lënë një vënd takimi me ta dhe u nis. Shokët e komitetit të fshatarëve të varfér shkuan me ta që të gjithë, përvëç Metanit, që Idrizi nuk deshi me asnje mënyrë ta merrte dhe e la për të ndihmuar shokët e grüpuit të reformës.

Xha Rrapushi, kur dëgjoi, tundi kokën dhe tha me vëhte, si pat thënë gjithmonë:

— Jo xhanëm, po nuk u shua fara e tyre nuk ka rehat ky popull.

Agush beu ishte një nga bejlerët që kishte patur bujqësmin e Sheqit. Gjysmën tjetër e kishin patur tre të kushërinjt e tij. Kishte qënë komandant balli. Një i vëllai, më i madhi, ishte zënë dhe ishte dënuar nga gjyqi i popullit. Agush beu vetë kishte mbetur jashtë dhe mundohej të sabotonte punët e pushtetit. U çonte lajm fshatarëve që të mos punonin tokat, përhapte parulla, shkulte hunjët që vinin grupet e reformës agrare, kërcënonte komitetet e fshatarëve të varfér, pat gjetur rastin dhe pat vrarë edhe një kryetar këshilli në një fshat. Por me që ndiqej nga mbrojtja dhe nga populli, nuk i zinin këmbët dhé. Kishte rj'a një muaj e gjysëm që nuk qe ndjerë aty përqark, e thoshin se pat hyrë Mallakastrës lart ose andej nga Dumbreja. Por ja sot i qiti prapë veshët. Si duket i kishte vajtur në vesh që grupi i reformës kishte shkuar të ndante tokat e tija dhe kush e di ç'kishte mejtar të bënte.

Bashkë me Idrizin e me fshatarët e tjerë u ngritën të shkonin edhe tre shokët e grupit të reformës. Por Idrizi ua mbushi mëndjen të qëndronin.

— Rrini, shokë, — iu lut ai, — ç'kini juve, në mos sot nesër, ka kush ua bën varrin atyre. Tashti që po vijnë prapë këtej rrëth e përqark, si duket u janë shkurtuar. Armiku atë do, të na pengojë reformën agrare e tjetrën e tjetrë. Ju bëni punën tuaj. Për inat të armiqve, ne do të mbarojmë sa më parë zbatimin e reformës dhe ata të bëjnë bof në vënd. Ç'kini ju, punoni të qetë! Unë, edhe këta shokët e komitetit të fshatarëve të varfér që po vinë me mua, nesër do t'uadërgoj heret, ruk do t'i mbaj me vehte.

Mirëpo mezi iu mbush mëndja atyre. Hele ai që ishte kryetari i grupit, Nexhmedin Bima e thoshir, një zeshkan vetullzi, njëzetedy-tre vjeç djalë, sa i urtë e i qetë dukej, aqë trim paske qenë. Ai paske bërë shkollën bujqësore të Kavajës, paske shkuar që andej partizan, kishte qënë nën-togë i ushtrisë popullore, por meqenëse dinte nga bujqësia, e kishin hequr si komisar kompariye që ishte dhe e kishin caktuar në reformën agrare. Dy të tjerët, partizanë edhe ata, njëri mësues, gjysëm burri, e tjetri tridhjetepesë

vjeç djalë, nga ato fshatrat përqark, nuk ishin më të pakët se i pari. Por fjalët që iu tha Idrizi i bindër dhe qëndruan. Nj'a një gjysëm ore pasi iku Idrizi as punuan dot, as qenë të qetë. Çfrynte ai kryetari i tyre sikur ta kishte përparrë Agush benë dhe donte ta coptonte. Po pastaj iu shtruan punës.

Xha Rrapushi iu mbajti kandilin dhe ata puruan gjer sa i dhanë fund pjesërisht planit të ndarjes së tokave. Herë pas here e pyesnin hëm xha Rrapushin, hëm Metanin. Bënnë ca vija, e ndarë atë letrën e bardhë që mbanin përparrë mbi sofër në ngastra-nngastra me ato vijat. Xha Rrapushi nuk kuptonte gjë; ai vetëm oy gjëra kishte në mënajë atë darkë: merakun për të nipin që i shkoi në rdjekje dhe merakun tjetër që Reforma Agrare të mos ja merrte Kuqickën. Sido që ta merrte plani, makari edhe më pak tokë le t'i jepnin, vetëm Kuqickën të mos ja luanin. — E po t'i bënir këtë, — mejtonte me vehte xha Rrapushi, — atij i kishin falur tërë botën.

Si mbaruan ndarjen e tokave në letër, si shkoi edhe Metani, Nexhmedin Bima, që hëm punonte, hëm e kishte mëndjen te krimireli i luftës, pështolli tura letrat që punoi mbi 'to edhe shkresa të tjera, i futi në çantë dhe iu drejtua xha Rrapushit:

— Nuk më thua, o xha Rrapush, ç'është ky Agush Beu. E di që është rga ky fshat, që ka qënë komendant balli, që ka punuar shumë të këqija në këtë luftë, por nuk di gjëra me hollësi për të, se vetë jam andej nga Kurveloshi dhe në luftë andej kam qënë. Këtej vetëm një herë kam kaluar, kur çliruam Fierin e Lushnjën dhe u holdhëm andej nga veriu për të çliruar Tiranën.

— Hë, — ja bëri xha Rrapushi dhe tundi kokër, — do të dish vetëm si është nga surrati Agush beu, apo do të dish që nga i jati, apo që nga gjyshi po të duash?

Xha Rrapushi me të vërtetë ishte plak, afër nëndëdhjetave, po siç thoshin bashkëfshatarët e tij, mëndjen e kishte qiqër dhe duar e këmbë akoma i punonin. Atij gjë

atëhëre nuk ia kishte dhërë dorën njeri për ta ngritur e për ta lëshuar. «Druri i vjetër», thoshin bashkëfshatarët e tij përtë kur binte fjala. Ai nuk kishte vënë kurrë raki e duhan në gojë. Gjersa qe bërë tridhjet vjeç pat qënë bari me dhënt e bejlerëve. Dimrin në Myzeqe e beharin në Tomor e pat kaluar. Mbarte mënd shumë dhe kur binte shesh tregonte nga ato të vjetrat sa që djemuria e dëg, o-nin me gojë hapur.

— Zëre nga të duash, o xha Rrapush, — i thanë që të tre me një gojë shokët e grupit të reformës agrare. — Ne sot s'kemi gjumë.. Do të presim, ndofta vjen edhe Idrizi, e ndofta na bije ndonjë lajm të mirë: kush e di, ja bëj-rë gropën që sot atij Agush beut me gjithë shokë.

— Shko bjerë e fli ti nuse, — i tha së resë xha Rrapushi, — mos na nga ne. Kur të na vijë gjumi bijem vëtë. Ti na sill ç'na ke për të sjellë, të mbulohemi, dhe ikë se je lodhur.

Megjithëse Refija ishte pesëdhjetë vjeçe, xha Rrapushi «nuse» e thërriste, ashtu siç e kish thirrur që në fillim; dhe ajo «baba» i thërriste.

— Po leri o baba të flenë këta shokët, se janë lodhur. — iu lut e reja, sikur po i shtrëngorte ai të rrinin pa gjumë.

Pasi u ngrit Refija, mbylli derën, kaloi nëpër arallëkur e ngushtë dhe hyri në të ndarën tjetër të kasolles prej garchi të lyer me baltë brënda dhe jashtë dhe të mbuluar me kashtë okërrri. Atje nuk fjeti, po dolli në dritarët e vogël, që nuk ishte më e madhe sa të nxinte kokën e një rjeriu dhe mbajti vesh a mos ndiheshin dyfekë më ndonjë anë. Zëmra i hidhej në gjoks sa që edhe vetë ajo i ndjente të rrahurat e saj, ashtu siç i pati rrahur kush' e di sa herë dy vjet e gjysëm me radhë sa qe Idrizi partizan. Djalin tjetër, të mesmin, nuk e kishte aty. Ai ishte në një kurs bujqësor në Lushnje dhe i vogli kishte vajtur te i ungji. Me leckë në zemër qe mësuar të rgrysej e të gdhihej kush e di sa netë me radhë, se nenia është nëne gjithëmonë. Mirë thotë çobani: «ç'mejton nëna e babaj për evlatin, mos ma heqtë as kraba». Ku nuk i shkonte mërdja Refijes atë natë: «Po sikur, Zoti na ruajtë, të më vritet djali mua së zezës tanë

që u mbarua edhe lufta», mejtonte me vehte dhe nuk i zinte vendi vend. Duke ecur me majat e këmbëve delte përjashta, rrinte një copë herë, mbante vesh, i dukej s'ku dëgjorte këmbë njerëzish larg në xhade, prapë nuk ndihej gjë, i vinte frikë dhe prapë hynte brënda.

Kur pa xha Rrapushi se shokët e grupit të reformës agrare nuk donin atë natë veçse t'i fjaloste, dhe këtë e kishin me gjithë zëmër, edhe ai u kënaq se atë kërkonte. Si plak që ishte, çdo natë nuk bërete veçse tri orë gjumë, prandaj filloj:

— Kur ka ardhur babaj im këtu në Sheqës, or djem, kam qënë dhjet vjeç dhe i mbaj mënd të tëra. Këta bejlerët ahore një shtëpi ishin, jo kaqë sa janë sot, gjashtë-shtatë shtëpi. Babai im ishte bujk te një bez andej nga Mokëra. Beu yrë qe njohur me këtë bejn'e këtushëm dhe meqenësse nuk kishte aqë tokë andej, bije në ujdi me kta bejlerët e këtushëm, (dy vëllezër ishin këta atëhere, Veli Beu dhe Beqir Beu, i gjyshi i Agush beut) dhe iu shiti tri shtëpi bujq. Mori nga Veli beu e Beqir beu kush e di sa para dhe na ngriti ne e na dërgoi këtu me qahallarët e tij. Deshëm s'deshëm, muarëm leckat më krahë dhe erdhëm. Dy shtëpi nga ato u shuan, ca nga ethet, se ruk ishin mësuar me ujin e ktushëm, ca rë kohën e zisë së parë. Nga shtëpija jonë shpëtova vetëm unë, se tre vëllezërit, nëna babaj, më vdiqën që në kohë e zisë. Dy motra më vdiqën edhe ato nga ethet. Unë bëra vetëm një djalë dhe djali më ka lënë tre nipër e dy mbesa. Mbesat i kam martuar të dyja, se ato ishin më të mëdha.

— Një djalë ke patur, xha Rrapush? — e pyeti Nexhmedini.

— Një pikë të vetme.

— Të ka vdekur, ë?

Xha Rrapushi pshëretiti:

— Jo, o djem, jo, ma kanë vrarë.

Të tre shokët e grupit të reformës agrare mbajtën dhe një herë frymër për të dëgjuar se mos ndihej ndonjë pushkë dhe si për t'u preqatitur që të mos e kishin mëndjen andej, por të dëgjonin xha Rrapushin, pyetën.

— Si është vrarë? Kush ta ka vrarë?

— Ja ky qeni m'i thau mëlçitë, Agush beu, ky që e bëfshin katër çerekë sot ishalla. — Çfryu xha Rrapushi.

Fytyra e tij, me atë lëkurën rrudha-rrudha e si e holluar, iu duk Nexhmedirit sikur të ishte e vajosur. I nguli sytë e po e vështronte. Xha Rrapushit zuri t'i dridhej pakë ko-ka me flokët borë të bardha, që i delnin anëve të qylafit, si trumba leshi, pa qethur kush e di që kur e të pa kre-hura. Mjekra e tij e bardhë n'atë fytyrë me cipë të zezë shquante edhe më shumë.

— Pa na trego, xha Rrapush, po nuk të erdhi rëndë, pa na trego të lutemi, si ka ndodhur vrasja e tij.

— Jo, or djem, nuk më vjer rëndë. Mua, kur fjalos përtë, më lehtësohet ky krahërori, më duket sikur çfrej du-fin tim e jam më rehat.

Pastaj filloi:

— Ka qënë si tani, vjeshtë; (ka 10 vjet kjo, që më 1936). Sa kishte hyrë vjeshta dhe gjithë bujqësija kishin zënë e po mbillnin gryrja, se gjer ahore qe lagësirë atë mot. Vakt zjarri, hante kau kanë. Beu kishte që në prill që i kishte thërë tim biri, Seferit, t'i linte këto ara që kemi edhe sot dhe t'i jepte ca të tjera të largëta, karkurina, që nuk bënin as okërr. Seferi nuk dëgjoi. «Nuk i lë arat, or bëj», i pat thënë. «Pse t'i lë? nuk i punoj unë? nuk të kam dhë-në gjysmën, a? apo pse merr moti motit rga pesëdhjetë-gjashtëdhjetë qase bereqet nga krahët e mij?» Por beu i qe përgjegjur: «Jo, jo, ti do të ikësh, kështu si po të them, pa atë psenë e di vetë unë, nuk e di ti».

Djali e dinte pse ngulte këmbë beu të na i ndërronte tokat, po mua nuk më kishte thërë gjë. Ai i kishte ardhur rreth mbesolles, çupës së madhe të djalit; dhe tek ajo nuk i kishte ndezur. Kështu kanë qënë këta të mallkuar, zinaqarë të mbëdhej. Po kaqë ta bënin dhëmbin, sa të derrit, — dhe xha Rrapushi tregon gishtin e madh të dorës, — te çupa jonë ruk i shkonte. Pa sikur t'u mirrte Perëndia mëntë e të mundoheshin ta zinin me pahir, do t'ua bën m siç ja bëri Kupja, një fshatari ynë, një të kushërit të këtyre sot e tridhjetepesë vjet të shkuara: E zuri në shtëpi bejnë, tek mur-dohej t'i çnderonte të shoqen me zor, e ndau më dysh me sopatë. e futi në thasët e ngarkoi rë gomar, i

ngriti kapistrën gomarit, e lëshoi dhe ua dërgoi në shtëpi. Vetë mori gruan e fëmijët dhe hapi krahët e iku tutje nga Izmiri, a kush e di se ku. U bënë shkaktarë këta, i prishën shtëpi e katardi, la vatanin e mori rrugët në dhe të huaj.

Tre shokët e grupit të reformës agrare, kush shtritur, kush duke dredhur një cigare, dëgjonin xha Rrapushin, pa ia hequr sytë.

— Nuk donte djali, or djem, — vazhdoi xha Rrapushi, duke e sjellë prapë fjalën tek vrasja e të birit, — nuk donte, se i vinte keq t'i linte arat. Kishim shtatëdhjetë-tetëdhjetë vjet që i punorim e kishim derdhur djersën në 'to. Pa kishim veselitur vresht e hardhi e pemë, dhe na vinte keq. Të na u thahëj goja fëmijëve në behar pér një kokër pemë??!

Kur e thirri përsëri atë vjeshtë që ngjau vrasja, beu i tha djalit: «Megjithse të kam thënë sa më ka zënë goja lesh që të mos i punosh arat e të marrësh të tjerat, ti prapë nuk hoqe dorë nga jotja. Hasëllin e mbolle që e mbolle; po mirë, s'ka gjë, në e mbolle nuk dihet a do ta korrësh, po grurin mos e mbill, të them!»

— «Hasëllin e mbolla», i qe përgjegjur djali, «edhe grurin do ta mbjell, e do ta korr e do t'i ha gjëzuar. Ngrijë atë mëndje që ke, se unë nuk ikij nga arat që kam».

Beu i ishte kërcënuar: «Mirë, të shohim, do të bëhet kështu si them unë, apo ashtu si thua ti. Unë nesër do të vij të t'i zbërthej qetë».

«Po deshe hajde zbërtheji», iu përgjegj shkurt Seferi im, e u ngrit e iku pa i dhënë as dorë: e pa i thënë as natën e mirë.

Që andej djali nuk erdhi në shtëpi. Ne kishim një mësonjës këtu, një xhevahir djalë, që i mësoi fëmijët tre vjet me radhë. Shkoi te mësonjësi e ja tregoi të gjitha. Ai ishte komunist, kështu si juve. «Mos luaj, o Idriz nga toka», m'i kish thërë djalit, siç i pat thënë gjithmonë që kur ishte hapur ky sherr. «Beu po deshi le të hapij gjyq. Ti tërë fshatin e ke me vehte». Dhe e kishte fjalosur siç na thoshte gjithënjë, kur na vinte në shtëpi, se si e kishte bërë moskovi atje në vend të tij, fshatarët i kishin çdukur bejlerët dhe ishin bërë zotër të tokave. «Do të vijë dita që kështu

do të bëhet edhe në Shqipëri», na thoshte gjithmonë. Djali iu besorte shumë fjalëve të mësonjësit. Mos, or bir, i paç thënë gjithmonë, mos nis me bejnë. Jo se doja t'i lija tokat, po pse kisha frikë se mos ma gjente djalin ajo që ma gjeti, se atë shkëndijë të vetme kisha. «A, baba, — më thoshte, — më ka rënë gjaku në lëkurët mua së punuari këto ara, ruk luaj unë». Edhe unë nuk e paç ngarë, se në i dhëmbsej atij malli një herë, mua më dhëmbsej njëqind herë. Paç marrë shkopin e paç vajtur kush'ë di sa herë te beu, po meazalla se afronte ai i vogëli.

Kur erdhi djali atë darkë, e kam mu si tani përpara syve, hyri në derët dhe nxinte e steronte. E kuptova. «C'ke or bir? — e pyeta. «C'të tha beu?»

— «Avazir e parë,» m'u përgjegj dhe na i tregoi të gjitha.

Atë darkë nuk futi bukë në gojë. Të nesërmen, u ngrit, vuri qetë përpara, shkoi edhe nusja me djalin me 'të dhe vanë nd'arë, zunë qetë e po lëronin. E sheh beu, ky qëni, Agushi, rëgjesh koburen në brez dhe i vete tek lëronte dhe as e përshëndet fare, po iu del përpara qeve e murdohet t'u heqë zgjedhën. Seferi im shtyu qetë, ai u doli përparrë. «Ik, or bej», i thotë djali. Një herë, dy. Po beu nuk hiqte dorë nga e tija. Kishim një ka, atë mot e kishim marrë, ai të vriste shumë. I fut një bri beut kau dhe e hedh tëj matanë. Beu atëhere merr zjarr më keq e i lëshohet Seferit, e godit dhe e shan më t'ëmën. Djalit atëhere i ndizet gjaku; çupën donte t'ia çrderonte, nga malli donte të na nxirte, e shau edhe më t'ëmën, e goditi edhe në sy të gruas, e këto nuk i duroi dot se ia shpuri thikën në mëlcit. Prandaj ngriti hostenin, siç e kishte patur në dorë dhe i ra kokës një herë, dy, tri. I pëlqet gjaku beut, arohet një herë tej, një herë këtej, po djale i shëndoshë dhe i mban plagët, nuk bije. Nusja hidhet që prapa dhe ai Idrizi e mbërtheu për këmbësh ta vinin poshtë. Seferit i thyhet hosteni dhe kërkon kosoren, po harron ku e kishte lënë. I hyn dorë me rjë furkaçë prej shkoze. Agushi nxjerr koburen, një tet-she të madhe austriake, i bije tri herë. Djalit i kujtohet që kosoren e kishte lënë nd'anë të arës, nja njëqind çape larg, mbuluar me laroshet dhe riset ta marrë, megjithë-

se kishte tri plagë. Po nuk ja arriji, vajti gjer në mes të arës, hoqi qylafin nga koka dhe u shtri në brazdët sikur do të flinte duke e pështetur kokën në qylaf. Rrojti nj'a një çerek ore me gojë dhe pastaj vdiq. M'i ka lënë amanet nuses dhe nipit përpëra se të jepte shpirt: «Kur të vijë ditë të bëhemë zotër të tokës, ashtu siç thotë mësonjësi, më hajdeni mbi kokë te varri e më thoni, se vetëm atëhere do të më tretë dheri». Prandaj edhe ju thashë, or djem, që atë arën Kuqickë të ma lini mua kur të ndahan, se kam gjakun e djalit atje.

Xha Rrapushi vuri dorër: në ballë dhe pshëretiti:

— Ah, or djem, më ka djegur zëmërën ai qën. Haku i fukarasë i zuri ata katilë, prandaj u bënë kështu kasht' e koqe.

Prushin në vatër e kishte mbuluar hiri. Të tre shokët e grupit të reformës agrare mbetën për rjë çast pa folur. Më në fund, Nexhmedini tha:

— E, ja, xhaxha, gëzoju tani që amaneti i djalit u plotësua. Partija dhe pushteti, ty e tët ripër, u bëri zotër të tokës.

Në këtë kohë u hap dera dhe hyri Refija lidhur duart në gjoks:

— Po bijen dyfekë andej nga Kuqari, kanë një copë herë.

Xha Rrapushi, Refija, të tre shokët e reformës agrare duallën përjashta dhe mbajtën vesh një copë herë të madhe.

— Do ta kenë rrëthuar qënин, — tha xha Rrapushi, dhe sytë nuk i hiqte nga vërdi ku bëhej lufta. Një mitroloz rrinte dy-tri minuta, dhe prapë binte, herë me të shtëna të shkurtra, herë me të gjata. Rrallë e tek zunë të dëgjoeshin edhe bomba.

— Bjerini qënит! bjerini qënит! — shtrërgontenofullat pa asnjë dhëmb në gojë xha Rrapushi dhe ngrinte shkopin në drejtim të vëndit nga shiheshir flakët e pushkëve dhe e turdëte. Pastaj shtonte si njeri që i njihte ato vënde:

— Në shtëpit e Isuf Qorit i kanë rrëthuar. Edhe ai qën do vrarë me bukë në gojë, se ai është jataku i tyre.

Pushkët u prerë, nuk po binin më.

Xha Rrapushi me gjithë shokët e grupit të reformës agrare hynë përsëri brënda. Ai i fjalosi pastaj se, pas vrasjes së Šeferit, Agush benë e kishin marrë në burg. Ia kishin prerë pesë vjet, se gjyqi e kishte futur në një kallëp gjoja sikur e kishte vrarë për të ruajtur kokën. Në burg beu rronte si zotni që ishte, në dhomë më vehte. Qëlloj që hyri fashizmi italiar në Shqipëri, duallën nga burgjet të mirë e të liq, dhe beu nuk i mbushi as pesë vjetët e burgut.

— Po, hele hele, or djem, — iu tha xha Rrapushi, keq e kam parë edhe atëhere kur ika dhe lashë tokën, shtëpinë, mallin e gjënë, në dyzet e trenë.

Dhe nisi prapë t'iu tregojë.

— Kur m'u vra Seferi, ky Idrizi ishte tamëm, trëmbëdhjetë vjeç djalë, po vinte ashtu si i fatakequr, se ishte rritur me të keq. Pastaj, si u bë nj'a pesëmbëdhjetë vjeç, hodhi bojë e u rrit. Llahtaria e vrasjes së t'et nuk i çqitej nga sytë. Më thoshte gjithëmorë: «Xhaxhait», (kështu i thërriste t'et, se baba më thërriste mua), i rridhte gjak nga goja dhe thoshte: «Të më vini te koka të më thoni... mos qaj, mos qaj, më thoshte mua dhe nënës i shtrëngonte dorën e i thosh: «Mos luani nga toka». Shtrëngorte dhëmbët, i binte gjoksit me grusht ky Idrizi dhe ja bënte: «Ah!». Po si u rrit nuk ma zinte ngojësh më. Më dyzet e një ma muarën ushtar. Atje në ushtri ziret me një oficer italiar, se e k'shë sharë, i bije, e vret, merr dyfekun në krahë dhe kërcet e ikën. Asnjë nga ne nuk dinte gjë. Xhandarët vinin e kërkonin, po ku ta gjenin se? Kur rëjë mesnatë, pas tre muajsh që qe arratisur, troket penxherja. Isha zgjuar. Ngrihem e hap, e njoha që në zë. Hyri brënda me gjithë dy djemt e pajillarëve të tij, të arratisur nga ushtrija dhe ata.

— Ç'bën kështu, or bir, — i them, — ku je?

— Do të marr hakën e babajt, — më tha.

Nuk i bëra zë. E kishte bërë tetë ai.

Ruante natë për natë ta futëte në pritë bejnë, po ku shkelte në drasë të kalbur ai! Idrizi rë shtëpi vinte në një muaj, në një muaj e gjysëm një herë dhe nuk rrinte veç një sahat e ikte. I jepnin bukë këta shokët: Refati i Metanit, Liçi, Uani. Ata e dinin se ku ngrysej e gëdhihej, ne s'dinim. Ama edhe këta shokët, si Refati, Uani e të tjerë,

gozhdë e patën vrasjen e Seferit. Sapo e muarrën vesh duallën me kosoret e ja zunë beut, po e dinte ai hanaç, bëri rrugë pa rrugë dhe ruk erdhi në shtëpi, po vajti drejt e në postët. Idrizi bëri nj'a shtatë a tetë muaj kështu firar, veç kur e shoh një mesnatë që më erdhi prapë në shtëpi vet' i dhjetë me yll rë ballë e më tha: Ky është komisari im' o baba, ky është nga Fieri, ky nga Lushnja, ky nga Mallakastra». Ku dinja unë komisar e partizan atëhere! Mirë, or bir, i thash, qofshir shëndoshë. Mirë kini bërë që kini dälë, veç ruani kokëp, i porosita, se nuk ma merrte mëndja që do të bëhej ashtu siç thoshin ata e siç u bë sot. Veç shikoni na qëroni këtë qenin këtu, iu thashë. «Jo, gjysh, më tha komisari »ne s'kemi dalë të marrim gjak, kemi hasmir brënda, kemi dalë për liri». Drejt t'u them, nuk më erdhi hiç mirë. Mirë, mirë, bëni si të doni, iu thashë, po ky është byth e brekë me Duçen, po nuk ja hëngërt kokën ju më parë, do t'ju a hajë ai. «Po zuri atë rrugë, ahore do t'ja hamë kokën më përpëra se t'na i hajë», më tha komisari. Mirë, pëmbani mënd ç'ju thashë, i fola më rë fund. Idrizi, më sa folët ju që nuk ishit, aqë foli ai. Mbante sytë përcħe dhe rrinte. E kishin zgjedhur komandant çete. U dhashë bukë, hëngrën, muarër me vehte dhe ikën. Që atëherë nuk e dëgjova më djalën të thoshte: «Do të marr hakën e xhaxhajt». Hë, hë, shkuan ca muaj, kur edhe beu na bën një çetë. Çetë e ballit, siç i thoshin. Zuri të turdej e të shkundej, se gjer ahore nuk delte sheshit, ruhej nga ne, megjithëse Idrizi nuk i kishte më ato mënd. Zuri e virte rrreth sa andej këtej nëpër fshatrat. Kur, një mëngjes, i pleksën me një çetë partizane të Mallakastrës e me çetën e Idrizit, atje, në krye të fshatit. N'atë luftë u vra i vëllaj më i madhi, Qatua, po ky qeni shpëtoi. U kthyte dhe iku me brekë nëpër këmbë, vajti në Fier, mori italianët dhe erdhi. Atëherë ç'ishin partizarë në fshat u ngritën e ikën me ç'kishin veshur me vehte me gjithë fëmijë dhe iu futën Mallakastrës përpjetë. Njëzet e katër orë luftë u bë këtu. Tymi e flaka u ndez më të katër anët. Pa m'u plagos edhe Idrizi në atë luftë në këmbët. Ahore e pasë më keq akoma. Ca e keqja e ikjes, ca e keqja e djalit. Po njeriu, t'ju them unë, është i fortë e i duron të gjitha.

Xha Rrapushi fjaloste, tre shokët e grupit të reformës agrare dëgjorin dhe rrallë e tek ja prisnin fjalën për ta pyetur për ndonjë gjë. Me këto bisedime arrijtën gjersa kënduan kaponjt e parë. Gjumë nuk kishin, po hodhën nga rjë rrobë në kokë e ranë të flinin. Aty ndaj të gdhirë, lufta në Kuqar u ndes prapë, akoma më e rreptë. Duallën të mbanin vesh. Në fshat nuk mbeti mashkull që pati pushkë në shtëpi, shkuan vullnetarisht rë rrëthim. U bë edhe rj'a dy orë luftë dhe pastaj u pre fare.

Sapo ra drita, shokët e grupit të reformës agrare, Reftija, Xha Rrapushi, burra të tjerë të fshatit, djemtë që vinin në shkollë, shkuan nëpër arat të matnin e të ndanin tokat.

Pas dy tri orësh, si qe prerë lufta, xhadeja Berat-Fier që shkonte përmes Sheqezës, po nxirte. Ç'do të jetë? I tërë fshati zbriti buzë rrugës. Tre shokët e Agush beut qenë vrarë, njeri qe dorëzuar dhe Agushin vetë qe plagosur. Të dy këta, Agushin dhe atë tjetrin që qe dorëzuar, ushtarët e mbrojtjes po i çonin në Fier.

Rruadhën fshatrat buzë xhadesë me të mëdhenj e me të vegjël. Sikush donte ta godiste Agush berë; nga zë-mërimi i hidhnin pllaçka pshtyme. Ushtarët e mbrojtjes nuk i lejonin. Megjithëse Fieri tri orë ishte larg, në mbrëmje arrijtën ushtarët e mbrojtjes në Fier, se i qëndronte populli. Agush beu, gjith ai trup që kishte një herë e rjë kohë. ishte rrëgjuar e ishte mbledhur sa një grusht, aqë sa nuk njihej fare. Fshinin sytë njerëzia dhe bënin be rrufe në fillim që nuk ishte ai, po pastaj nga ata sytë e tij të dalë sa rjë kaçkë e nga tiparet e tjera e shëmbëllënин pakë.

— Ku ka vajtur gjith' ai shëndet që kishte! — thoshin të habitur.

— Po si i zutë, si i zutë? — pyesnin fshatarët që kishin marrë pjesë në rrëthim. Dhe dëgjonin nga secili:

— Si i vramë e si i zumë?! Ne shyqyr që i vumë në dorë ku ishin futur. E bëmë rrëth shtëpisë së Isuf Qorrit

pëllëmbë e njeri, dy sërë me radhë. Na pikasën ata të shtëpisë ashtu nga mezi i natës dhe i lajmëruan kriminelët. Deshën të delnin, ne iu ramë. U ndes lufta. U thirrëm të dorëzoheshin, nuk deshnin. Qëndruan ca. Zunë përsëri sikur të çarin rrëthimin, po nuk mundën. Agush beu, që në pusinë e parë u zu. Një ushtar i mbrojtjes e pa dhe i ra e plagosi. Ai i hodhi një bombë dhe bëri yxhym, po veç kur ra përsipër mbi ushtarin. E përlau ushtari dhe e futi ndër shalë.

— Hë, m'i lumtë, hë, m'i lumtë ajo dorë! — thoshin të kënaqur ata që dëgjonin dhe fërkonin duart. — Cili ushtar është, cili? pa na e tre go t'i puthim grykën e pushkës.

Xha Rrapushi hoqi Idrizir më nj'anë, e vështroi në syt sikur t'i kanosej dhe i tha, duke i treguar me kokë Agush benë:

— Vraje, ç'pret??

— Tek ai ka hakë për të marrë i gjithë populli, baba! — iu përgjegj i nipi me një zë sikur ta qërtonte të gjyshin, por gjëzimi që ndjente për suksesin që kish patur, fytyra e tij e çelur, e tradhëtuanë. Prandaj xha Rrapushi pati kurajo e vazhdoi t'i thosh përsëri:

— Vraje bir, ç'pret?! më ka përvëluar zëmërr: ai qën: A nuk të kujtohet ty?!

Por kur e pa që i nipi nuk dëgjonte nga ajo anë, ai iu lut oficerit të mbrojtjes që t'ja linte Agush benë ta pushkatonte me duart e tija. Edhe oficeri nuk deshi. I hodhi duart, e pushtoi e i tha:

— E di pse do ta vrasësh me duart e tua, o xha Rrapush, por nuk bër. Ne do t'ja dorëzojmë gjyqit dhe gjyqi do të vendosë për të ashtu si dëshëron populli.

Pak ditë kishin kaluar nga dita që kishte marrë fund zbatimi i reformës agrare në Sheqës, rë tërë rrëthin e Lushnjës dhe në gjithë Shqipërinë.

Në këtë kohë u hap fjala nëpër fshatrat e Myzeqesë se në Lushnjë do të festohej zbatimi i reformës agrare.

Kur dëgjoi këto fjalë xha Rrapushi, siç kishte ndejnur këmbë kryq në diell, atje sipër në breg, ku kishte shtëpinë, u kollit një herë dhe duke vështruar fushat larg, mejtoi:

— Jo, jo, mori furd kjo punë. Nuk janë vetëm ata tre që erdhën i matën tokat e na i dhanë, po është e tërë qeverija, e tërë Partija rë këtë punë. Sepse gjer ahore atë, sado pak, po prapë e hante një fije e vogël dyshimi e xheku i vinte mëndja, se ço valla e kishin aqë rë dorë ata tre shokët e grupit të Reformës Agrare që t'i jepnin tokën xha Rrapushit, të cilët sikur nuk ja patën mbushur synë edhe aqë shumë. Dhe këtë të fshehtë ai nuk ja pati thënë rjeriu. e pati mbajtur vetëm për vehte.

Ditën që u bë metingu, xha Rrapushi i hipi qerres dhe shkoi edhe ai në Lushnjë. Kishte nja dhjetë vjet e më shumë që nuk i kishte parë synë pazarit, se qëkur iu vra djalili, e rrëzoi shumë dhe nuk i bënte zëmra as për mik, as për pazar. Edhe purët e bujqësisë i kishte rrëmbyer e reja që kishte veshur shallvare si burrat, e ishte bërë mashkull për shtëpinë. Ai vetëm sa i ndihmonte dhe i mësonte ndonjë punë çifçillëku. Pastaj edhe i tërë fshati i ishte gjëndur xha Rrapushit, në daç për mbjelljet, në daç për korrjet, në daç përsedo. Djalë si Seferi i ishin bërë të gjithë djemtë e fshatit, gjersa iu çuanë të nipërit dhe rrëmbyen punët e bujqësisë e të shtëpisë.

Kur vajti në meting, ç'të shikonte! Ato që shihte atje as që dinte t'i shpjegonte me mëndjen e tij se c'ishir. Rrinte në këmbë me dorën të vënë si strehë, i dridhej koka nga pleqëria, si prej hidhërimit edhe kur kishte gjëzim, mbahej me njérën dorë mbi shkopin dhe thoshte me vehte:

«Jo, xhanëm, po është ngritur i gjithë mileti më këmbë sot. Gjith ky milet me pështymë të mbyt.»

Kur mejtonte kështu e kishte hallin tek ndonjë Agush be tjetër që mund të ishte akoma gjallë e që mund të mundohej të shkulte ato kufi që kishte vënë reforma agrare në tokat e bezlerëvet.

Pa kur dërgoi e e thirri shoku Enver Hoxha të parir pér ta takuar, kur i hodhi duart e pushtoi, ahere nuk i mbajti dot lotët

— Më bëri Partija zot të tokës, — i tha, la e më la bëftë Partija dhe rroftë sa mali i Tomorit!

Shoku Enver e përqafroi edhe të renë e tij, kurse Idrizin e mbante në krahun e djathë, bisedonte e qeshte me të si me një vëlla të dashur.

— Pse rrojta nëntëdhjetë vjeç e pse vojta të zit e ullirit që në djepet, ruk më vjen keq, — mejtoi me vehte xha Rrapushi, — vetëm e vetëm pér këtë çast që pashë e jetova sot.

Kur u kthye mbrëmave në fshat, xha Rrapushi nuk vajti në shtëpi, por shkoi drejt mbi varrin e Seferit, t'i plotësonte amanetin që pati lënë.

Edhe Refija, që kishte mbetur pak më prapa se gratë e tjera të fshatit, nuk shkoi në shtëpi, por drejt e mbi varrin e të shoqt.

Kur u gjënd atje thirri:

— Baba!

— Nuse!

Xha Rrapushi i hodhi duart në qafë dhe pa e shkëputur nga krahët, uroi me sytë nga qelli:

— Të na rrojnë djemt e gjithë c'kemi pér zëmër!

B A S T I

Atë mot vera qe e thatë. Që në të hyrë të qershoret e gjer në një javë të vjeshtës së mesme nuk ra asnje pikë shi. Me rjë javë të vjeshtës së dytë zunë shirat, dhe në maliqitë, po i thanë vjeshtë e po zuri një shi, moti ftohet e nuk gëdhihesh dot jashtë pa zjarr.

Çeta e parë partizane në krahinën e L... ishte formuar që në gusht e kishte arrijtur tridhjet veta. Tashti kishin nj'a një javë që rdiznin zjarr natën e, të rrethuar pér qark zjarrit partizan, bisedonin pér luftën, aksionet, hallet e popullit... U dukej sikur ai zjarri u bë shkak të mbli-dhen më mirë bashkë, të afrohen e ta njohin më shumë shoshoqin.

Një natë, tek ishin duke biseduar pér motin e thatë që pati marrë atë vit e pér shirat që zunë, një partizan me mustaqe të zeza, gjysëm burri, dhe që gjer tanë ai ishte më i vjetri rë çetë, veç xha Brahos, komandantit të çetës, i cili i kishte zënë të pesëdhjetat, tha:

— Kur rjë mbretëri e zapton një mbretëri tjetër, i vihet vesh edhe këmba. Ky fashizmi shumë këmbë ters pas ka qënë. E shikoni, ka dy behare që nuk po pikorë shi në Shqipëri. E kini vënë re se fukarallëku është shtuar akoma më shumë rë vëndin tonë apo jo?

Komisari i çetës dëgjonte. Edhe të tjerët nuk thanë gjë. Bisedë pas bisedë në fund u hodh xha Brahua:

— Shqipëria është vakëf, or djem, dëgjomëni mua, se jam plak unë. Çdo mbretëri që ka ardhur këtu nuk e ka trashëguar dot këtë vënd.

— Biseda nuk është e shtrembër, — mendoi komisari me vehte, — por pura është që disa nga këta duhen më-suuar që t'i kuptojnë ndryshe gjërat.

Dhe me takt u shpjegoi shokëve se fashizmi erdhi në vëndin tonë. jo se e zuri malli pér Shqipërinë e shqipta-

rët, por për të na shfrytëzuar akoma më shumë. Prandaj është shtuar edhe varfëria. Dhe në qoftëse Shqipërinë ruk e ka trashëguar dot asnjë mbretëri, kjo ka ardhur se populli shqiptar nuk i është nënështruar asnjë armiku, ka qëndruar me armë në dorë dhe ka luftuar.

Në këto biseda kështu komisarit iu kujtua se duhej që të organizonte luftër kundra analafabetizmit në çetë sa më parë. Nga të tridhjetë shokët që kishte çeta, njëzet qenë fshatarë, dhe shtatëmbëdhjetë prej tyre qenë analafabetë. Edhe vetë xha Brahua qe analafabet.

Ç'prej asaj nate e gjer pas festës së 28 Nëndorit puna e luftës kurdër analafabetizmit shkoi si shkoi në çetë. Por pas festës së 28 Nëndorit erdhën edhe shumë shokë të riq nga qyteti që kishin marrë pjesë në demonstratë e që fasizmi i kërkonte t'i burgoste. Midis tyre qe edhe Agim Kallaja, të cilin komisari e kishte patur nxënës para motmotësh dhe e njihte mirë. Këtij, komisari i ngarkoi përgjegjësinë e luftës kundra analafabetizmit në çetë dhe ai iu vu punës me zell. Që në ditët e para shokët ja ngjitën emrin Mësuesi i Çetës dhe me këtë emër e njihnin të gjithë. Emrin e vërtetë pothuaj ia harruan fare.

— Ç'qesh rehat, — mejtonte me vehte Xha Brahua, sa qe ai çuni i parë përgjegjës. Atë e zinte gjumi më përpëra se unë. Po ky s'të ndahet, — thoshte për Agimin, — po ruik mësove një gërmë më dy ditë këtë nuk e zë gjumi. Mirë e ka ky, po q'të bëj unë që më janë trashur trutë dhe nuk mund ta thyej dot dorën.

Gjatë dy muajve, para se të vinte Agimi në çetë, Xha Brahua kishte mësuar t'i rjihte pak nj'a shtatë a tetë gërmë, dhe rj'a dy arrinte edhe t'i shkruante, porse tanë e kishte pisk punën; i duhej të mësonë me doemos një gërmë më dy ditë.

Një natë kur qe vetëm me komisarin, e pruri fjalën anës e anës e pastaj i tha:

— Më ka pjellë belaja me atë Mësuesin e Çetës, o Çeko. Më është qepur edhe nuk më ndahet. «Ja do të të mësoj unë ty shkrim e kërdim, — më thotë, — ja s'ka». Mirëpo nuk mësohet revani në pleqëri, or bir. Limëri rehat mua. Thua-

më pér luftë, në zjarr të hidhem, ama pér të mësuar nuk mësoj dot. Nuk i ndreq dot ato grabat unë.

Komisari vuri buzën në gaz. Ai e kuptoi që xha Brahma me ato fjalë deshi edhe sikur t'i ankohej pér Mësuesin e Çetës edhe sikur t'i kërkonte që ta linir të qetë. Që Xha Brahma e kishte me zor të mësuarit e që mundohej me çdo mënyrë t'i bënte bisht kësaj punë, këtë e kishte vënë re edhe vetë Çeçua dhe, edhe Agimi ja pati thënë kaqë herë. Punë agitative qe bërë mjaft me Xha Brahon gjer ahere pér nevojën që kish ai të mësorte shkrim e këndim. Tani nuk ishte puna pér agjasjon. Xha Brahma përdori, pér të shpëtar, gurin e fundit: i qe mbushur mëndja t'i qahej komisarit siç iu qa, edhe Çeçua, që të mos e zgjaste më me 'te, mendoi që edhe ai të përdorte gurin e fundit. Pér çdo gjë që kundërshtonte xha Brahma, po t'i thoshte komisari: «Kjo punë duhet bërë se kështu thotë Partia», ai nuk fliste më. Prandaj edhe sot me këto fjalë ja mbylli gojën.

Xha Brahma nuk e zgjati po vari kokën sikur t'i kishte mbetur hatéri, mustaqet çile i ranë mbi buzë, e duke dredhur një cigare, i futur në mendime të thella. tha me vehte si me zëmërim:

— C'hair do të shohë Partia nga unë, pse do të mësoj shkrim e kërdim tani në pleqëri?! Unë e hëngra kullotën. Tani jam pesëdhjetë vjeç burrë, ç'më duhet mua kalemi në këtë moshë?!

Si nuk i ndezi te komisari, u mundua ca kohë që t'ja hante kokën me të mirë Agim Kalasë, duke i thënë që ta linte të qetë, se ishte plak, lodhej, e merrte gjumi... Mirëno Agimi i fërkonte shpatullat, e i lutej:

— O burra, xha Braho, o burra! Pa shiko sa mirë e ke shkruar A-në! Pa shiko si e ke bërë B-në, njëlloj si timen!

Xha Brahma e shikonte në sytë, i vinte keq pér të që lodhej aqë shumë, çuditej me durimir e tij dhe bënte shaka me të:

— Hë, ç'qerrata që je ti, ç'qerrata!

Mandej mundohej t'i shkruante, por prapë nuk hiqte dorë nga e tija:

— Nuk mësoj döt; urë. or jo! po lëmë rehat në ke

Perëndi! C'beson ti? Muhametin a? Krishtin a? Lëmë, ore të qetë.

— Partinë besoj unë, — i përgjigjej Agimi duke qeshur. — dhe mbaje mënd, Xha Braho: Zotrote shumë shpejt ke për të mësuar shkrim e këndim... E kur të çlirohet Shqipëria, zotrote do të dish sa di unë sot. Dhe unë do të vete në Bashkimin Sovjetik, do të mbaroj universitetin e do të dal profesor...

-- Po mësova unë kaqë sa thua ti, e po u bëre ti profesor, unë pres kokën, — e kundërshtonte xha Braho gjaja si me inat dhe vinte dorën e trashë e të çarë thela-thela nga puna në qafë, duke treguar si pritet koka.

— Mos, — qeshte Agimi me gjithë shpirt, — mos, se kur të arrihet kjo që them unë, do të të dhimset koka, e do të më lutesh: «aman, mos ma pre»!

— Plaça po t'u luta, unë do ta pres vetë kokën atëhere.

Kjo grindë, që u pëlqente që të dyve, vazhdoi për shumë kohë. Të gjithë shokët e çetës shqysheshin së qeshuri dhe komisari qeshte sa i mbaronte brinjët me dorë.

Xha Brahua e shikonte duke i ngulur sytë sikur ta qërtonte e sikur t'i thoshte:

— Qesh ti, qesh, po e di mirë unë se të gjitha të tuat janë këto që po mundohem unë plak njeri sot. Ti m'i ke fajet.

Komisari e kuptonte, dhe ahere binte përbys fare. Një ditë, tek ishin duke u ngrënë Agimi me Xha Brahon, komisari u tha:

— Unë them kështu: Xha Brahua dhe Agimi ta zënë me bast: Po mësoi Xha Brahua gjer në çlirim sa di Agimi sot, e po u bë profesor Agimi në çlirim, xha Brahua të na bëjë një gosti të mirë në fshat; të na theri një mish, të na bëjë një bakllava... Po nuk u arrit kjo, atëhere detyrohet Agimi që ta bëjë gostinë. Kështu s'ka nevojë ta presë asnjeri kokën.

— Për hair qoftë, — thirri xha Brahua dhe i zgjati dorën Agimit. Ata të dy zunë duart dhe Çeçua i preu duke thënë sipas zakonit, me shaka: «kush gënjeftë, e preftë».

— Mos harro se ti që preve bastin je dorëzërës përtë dy, — u hodh xha Brahua.

— Po, jam, — e siguroi komisari.

Kështu rrrođhi puna e bastit midis Mësuesit të Çetës e Xha Brahos. Dhe sa herë që binte fjala, ose kur e shikonin shokët Agimin tek mësonte xha Brahon, pyesnin:

— E mo, si dukeni, kush do ta paguajë bastin nga ju të dy?

— Ky, ky, do ta paguaj, — përgjigjej xha Brahuë duke treguar me gisht Agimin dhe férkonte mustaqet. Duke dashur të më mësojë mua ky, i ka hyrë detit këmbë. Edhe për vehte nuk është i zoti ky krimbo, mo jo. Do e mburret kot. Ky të vejë të studjojë në Bashkimin Sovjetik?! Ky të dalë profesor?! Jo mo. jo, nuk më ha buza kulaç.

Xha Brahuë shkak donte. Zinte muhabet me partizanët që të shpëtonte nga Mësuesi i Çetës Po Agimi nuk e linte.

— E fillojmë xha Braho, — i thoshte.

— Fillojmë, or krimbo, fillojmë, — i përgjigjej xha Brahuë me shaka e duke tundur kokën me atë qylafin e zi bellus me yll të kuq. Pastaj menjonte me vëzë duke qeshur:

— Hej, ç'më polli macja në kamaret mua të varfërin me këtë çun!

Nga një herë, jepte e jepte dhe i binte asaj pllakës ose defterit, ç'të kishte, me kalemt, ngrirte kokën, vështronëtë në një vend të pa përcaktuar, e thoshte:

— Jo, or jo, nuk shkruaj dot, nuk më thyhet dora. Përse nuk më thonë, xhanëm: «Shko vra Duçen», se vallahi, detin do ta çaj më këmbë dhe do të vete ta vras, ama për të shkruajtur nuk murd, jo!

Pastaj merte përsëri kalemin dhe i mëshonte me sa fuqi që kish. Edhe kur lëronte tërë ditën në arë, që në mëngjes e gjer në mbrëmje, nuk i qe lodhur dora ndonjë herë aqë shumë sa tanë duke shkruajtur.

— O burra, xha Braho, hë, ashtu, rrrotulloje pak, bëji bishtin, — i thoshte Mësuesi i Çetës dhe i rrinte përmbi kokë.

Xha Brahuë, qysh se erdhi Agimi në çetë, me ngadalë, por kishte filluar të mësonte mirë. Në të lexuar shkonte më përpara, ndërsa të shkrojturit e kishte pakëz më me

zor. Në krye të shtatë a tetë muajve ai arriji ta lexonte vëtë Komunikatën. Letrat komisarit ia shkruante vëtë: Puna e mësimit i kishte hyrë edhe atij në qejf tashti.

Në këtë kohë Mësuesi i Çetës iku në Brigadën e I sulmuese dhe kur u përcuall me Xha Brahon i tha:

— Ta dish, xha Braho, se do të ta fitoj bastin. — Pastaj ju kthyeshokëve: — «A e dëgjuat juve, shokë? do t'ja fitoj bastin xha Brahos, kini për ta parë kur të çlirohet Shqipëria. Të jini dëshmitarë».

Kishte zëmër të fortë xha Brahua. Ai ishte shumë i duruar. Shumë të vrarë e të plagosur pati ngritur me duart e tij në të kaluarën, kur pati luftuar bashkë me Çerciz Topullin, qe plagosur edhe vëtë, kur luftonte kundër ardharië grekë, i qe vrarë e plagosur edhe ndonjë partizan, tashti në këtë luftë, por qe treguar burrë e i duruar. Ai pati qëndruar i fortë, më shumë për të mos trëmbur djejmëtë, siç mendonte ai, se ishin të rrij, mirëpo atë mëngjes që përçollë Mësuesin e Çetës diç ndjeu në lugthin e zemrës dhe fërkoi sytë gjoja sikur i digjinin rga tymi i zjarrit.

— Është i vogël, — mendoi me vehte, — gjashtëmbëdhjetë vjeç djalë, me trup të pakët, — e u dhimbura për të si për djalin e tij, kur e pa për të fundit herë ashtu të thatë në fytyrë e kur ja pshtolli në dorën e tij të madhe atë dorë ashtu të hollë, që e kishte mësuar si të mbante lapsin, si të shkruante...

Gjatë një moti e gjysëm si komendant çete partizane, xha Brahua mësoi e u zhvillua aqë sa nuk ishte zhvilluar gjatë gjithë jetës së tij. «Paskam qënë në të errët», menjtonte sa herë me vehte, «dituria të bën me katër sy». Rreth zjarrit partizan ai mësoi historinë e popullit tonë, gjeografi, njohuri të ndryshme të kulturës së përgjithëshme... Më parë, kur bëheshir mbledhje të fshatarëve, të organizuara nga çeta partizane, ose metingje a qfarëdo mbledhje tjetër, ai thosh vetëm dy fjalë «shokë duhet t'u bjemë këtyre qafirëve që na kanë zaptuar vatanin...» dhe, megjithëse i lutej komisari, nuk vazhdonte më shumë, se nuk e ndjente vehten të zotir. «Tani do t'ju flasë komisari», iu thoshte xha Brahua fshatarëve pas atyre dy fjalëve të tijat, dhe pastaj fjalën e merte komisari. Mirëpo tashti, pas motmot

e gjysëm në çetë, kishte fituar besim në vehten e tij dhe i priste gjuha brisk, pse kishte mësuar dhe kishte kuptuar si duhej folur. Hallet e fshatarëve ishin po ato që kishte ai vetë si fshatar, hallet e tyre ishin ato që ai i kishte qarë me 'ta përditë kur ishte pa dalë në çetë.

Xha Brahma luftoi me armë në dorë me djem, me njëpër e me ç'kish e ç'nuk kish, gjer në çlirimir e plotë të Shqipërisë. Ai pati luftuar aty edhe gjer në tokat e Jugosllavisë, andej nga malet e Vishegradit.

Në fillim qe komandant çete, pastaj komandant batalioni, dhe mbarimi i luftës e zuri komandant brigade. Tash-ti është oficer rezervë pensionist, me gradën nënkolonel. Qëndron në shtëpi në fshat por pa punë nuk e gjen kurrë. Merret me punët e bujqësisë dhe një djalë i tij është kryetar kooperative i dekoruar. Në fshat është antar i këshillit popullor, në lokalitet gjithashtu është antar i këshillit. Edhe rë rreth edhe në qark është antar i këshillit popullor. Megjithëse plak, herë me shkop në dorë, herë kaluar, do ta gjesh sa në një fshat në tjetrin, sa në një lokalitet në tjetrin. Në një vend agjiton për realizimin e mbjelljeve të vjeshtës ose të pranverës, diku gjetkë për grumbullimet, diku për detyrimet; herë për një fushatë, herë për një tjetër, sipas kohës dhe rastit. S'di të lodhet ai njeri.

— Djem, vellezër, shokë, — u thotë fshatarëve, — ç'u tha dje në luftë, na u dhanë të gjitha: ç'ra u tha se do të bëhej si u çliruam, u bërë dhe u kaluan. Edhe ç'na thu-het tashti e ç'do të na thuhen nesër, do të bëhen ti gjitha.

Xha Brahma rallë vjen në Tiranë, po kur vjen amari një javë, dy tri, e nga njëherë edhe më shumë. Një natë e merr njeri për darkë, rënjë natë tjetri, dhe megjithatë, kur ikën, ndahet me qejfprishur me shumë shokë, se nuk mundet t'ua plotësojë dëshirën të gjithëve atyre që duan, të paktër, të fjalosen një darkë me 'të.

— Do t'ikij, — ju thotë shokëve që e ftojnë. — do t'ikij se më presin një tog punë atje në fshat, në lokalitet, në rrëth.

Aty nga viti 1954 xha Brahma kishte ardhur në Tiranë me rastin e festës së «10 korrikut». Si bëri festën, qëndroi edhe nj'a shtatë a tetë ditë dhe pastaj iku.

Një mbrëmje po shëtiste vetëm gjatë bulevardit «Stalin», po gjithënë nga krahu i majtë. I kishte rënë nj'a katër a pesë herë tutje e tëhu, që tek kafe «Çajupi» e gjel lart nga zyrat e gazetës «Zëri i Popullit». Po shkonte ora tëtë e mbrëmjes dhe kolonel Çeçua me major Sulon, me të cilët kishte lënë fjalë të takoheshin atë mbrëmje, gjatë asaj rruge dhe po n'atë orë, nuk po dukeshin të virin. U mërzit pak, por megjithatë po vazhdonte të shëtiste, duke mbajtur duart prapa dhe me trupin pak të kërrusur përpara, ashtu siç ecën zakonisht. Kush e shikon për herë të parë xha Brahon çuditet me ecjen e tij, por atyre që e njojin, u janë mësuar sytë dhe nuk iu bën përshtypje.

Duke shëtitur posht e lart, përpara kabinetit të Partisë, pa një grup të rirjsh të hynin brënda.

— Cfarë ka këtu, or djalë i babajt? — pyeti një të ri dhe i mbajti këmbët, duke hedhur vështrimin nga salla e mbledhjeve.

— Këtu është kabineti i Partisë, shoku rënkolonel, — iu përgjegj i riu, — është një mbledhje seminari me propagandistë e formave të arsimit të Partisë.

— Mirë, djali babajt, mirë mësoni, mësoni, — i tha xha Brahua, tamam ashtu siç iu thosh edhe partizanëve komunista kur i pëshpëllinin në vesh: «Ne, xha Braho, do të shkojmë, do të lëmë vetëm, se kemi mbledhjet e celulës» dhe atij i bëhej qejfi që djemtë nuk mbanin gjë të fshehur nga ai.

Bëri edhe nj'a dhjetë a pesëmbëdhjetë hapa më lart, kur poqi ballë për ballë me të dy shokët që kishte lënë takim.

— Po ku jini, or djem, ç'u bëtë? më latë vetëm si qyp nardeni!

— Ke shumë të drejtë, xha Braho, na fal. Nga provimet mbaruan shpejt, që në ora pesë, por ashtu ra doli një punë dhe të duallëm nga fjala, — u justifikuan kolonel Çeçua me major Sulon.

— Mirë, de, mirë, s'ka gjë, po si dualët?

— Që të dy muarëm pesa.

— Bravo, ju lumtë! Kështu i bëhet qejfi babajt, zjarr në luftë, zjarr të jini edhe në punë, kështu iu ka hije dje mave të Skraparit, Kurveleshit, gjithë Shqipërisë.

— E po rga do të vemi tani — pyeti xha Brahua më në fund, mbasi mbaroi biseda e provimeve.

Në pallatin «Ali Këlmendi» po hynin pak si me nxitim plot njerëz. Kolonel Çeçua ktheu kokën nga porta e hyrjes rë pallat, mbajti këmbët dhe ju drejtua xha Brahos:

— Tashti në ora tetë e gjysëm këtu në Pallatin «Ali Kelmendi» bëhet një konferencë. Tema është: «Shkenca dhe feja», do të flasë profesor Agim Kalaja. Hyrja është e lirë për të gjithë. Tema është shumë interesante. A dëshëroni të vemi të dëgjojmë?

— Po vemi, or bir, gjë ruk humbasin, veçse do të fitojmë. Sa më shumë të dijë njeriu aqë më shumë e ka të hapur synë. Unë jam plak e më zjen zëmra të di sa më shumë, jo juve që jini të rinj... — tha xha Brahua duke qeshur.

Të dy oficerët e rinj e vunë xha Brahon në mes dhe hynë brërda. Në mes të shkallëve xha Brahua qëndroi. Vuri duart në bel dhe iu tha:

— U plaka, or djem, nuk më punojnë gjunjët si më përpara.

— Jo, jo, xha Braho, ti je përtëritur tani. Djemptë si ne ti i flak atje tej me gishtin e vogël. — qeshën dy oficerët që e shoqëronir.

— Jo, or, jo, s'është ashtu, nuk jam më ai i pari, u plaka, u plaka, e shoh unë, — qeshi xha Brahua dhe e ngri- ti trupin, si për të treguar rga ana tjetër se me të vërtetë ishte përtëritur, sepse iu bë qejfi që i thanë shokët: «ti na flak me gishtin e vogël». Cili është ai që nuk do të jetë sa më i ri në këtë kohë?!

Kur hynë në sallë, ajo qe mbushur plot: burra, gra, të rinj, të reja, ushtarakë. Mezi gjetën tre vënde, dhe u ulën të tre bashkë afër tryezës ku do të fliste konferencieri.

— Mirë jemi këtu, — tha xha Brahua, — megjithëse nga veshët nuk jam keq, jam mirë, prapë se prapë, sa më afër të jesh aqë më mirë është në këto raste.

Një vajzë e re, leshverdhë, paraqiti korferencierin, iu tha edhe një herë temën mbi të cilën do të flitej, me-

gjithëse ajo ishte shkruar edhe në lajmërimin përjashtë dhe pastaj e mori fjalër profesori Agim Kalaja.

Sapo kishte filluar të fliste, se si i vanë sytë te Xha Brahu dhe tek dy oficerët që e kishin vënë në mes, dhe megjithëse ishte duke folur, i shikoi me dashamirësi, iu buzçëshë. dhe vazhdoi konferencën.

Xha Brahu po mejtohej dhe po thoshte me vehte:
— Ku e kam parë këtë djalë unë?

Flokët e profesorit, të zes sterrë, të ndarë në mest, sytë e tij të qeshur, fytyra e tij e dashur, i kujtonin një rjeri të njobur, bile shumë të njobur, po ku e kishte parë nuk i kujtohej dhe duke dëgjuar po vriste mëndjen ta sillte në hatër. Pas pak shikoi një herë djathtas, një herë majtas. Por kur pa që kolonel Çeçua me major Sulon ja kishin qepur sytë konferencierit e po dëgjonin me vëmëndje, nuk deshi t'i pyeste, se vallë e njihnin edhe ata, dhe pse t'iu largonte vëmëndjen.

Si mbaroi konferanca dhe pasi iu përgjegj profesori pyetjeve, që iu bënë nga salla, të gjithë dëgjorjësit filluan të delnir.

Profesor Agim Kalaja, pa humbur asnjë sekondë, si i paduruar, u derdh nga xha Brahu dhe e përqafoi me mallëngjim.

— Unë të putha, or bir, se e pashë që ti më njohe. Edhë urë të njoh, më dukesh si fytyrë e parë, por kam qëkur erdha që po e lodh mëndjen ta gjej se cili je e si e ke emrin dhe s'po e gjej dot. Pa më thuaj cili je ti?

— Po Agim Kalaja, është, xha Braho, nuk e rjeh ti? e ke patur në çetë, — i tha kolonel Çeçua. Në fund të 1943 ky iku nga bataljoni ynë dhe shkoi në brigadën e I-rë. A të kujtohet tani?

— Hooohoo! — bërtiti xha Brahu dhe i ra ballit me pëllëmbën e dorës. Të solla ndërmënd! Të solla ndër mënd. Ti je Mësuesi i Çetës! Ti je Mësuesi Çetës! Sa paske ndryshuar! Po hajde, ore, hajde të të puth edhe një herë babaj.

— Leri, leri këto fjalë, — i tha Agim Kalaja gjithë duke qeshur, — ti më njeh, po bën sikur s'më njeh, se do që të mos më japësh bastin, po ruk shpëton dot, se kam dorëzënës Çeçon unë.

LIBREZA USHTARAKE

Shaqo Bendua atë ditë i lëshoi qetë më vonë se çdo herë tjetër. Murrashit i ishte nxirë qimja fare nga djersa dhe jargët i kullonin nga të dy cepat e buzëve. Shaqua i shkoi dorën mbi kurriz e përgëzoi edhe nga zverku dhe foli më të sikur ai ta merrte vesh q'i thosh:

— Shko Murrash tari, shko të keqen e krahut, se i mbaruan edhe të mbjellat.

Për krye arës së Shaqos shkonte rruga. Një bashkëfshatar i tij kaloi aty me qetë përpara dhe vetë hipur në kalët.

— Gëzuar, o Shaqo, gëzuar e me bereqet. Mbarove ë?

— Të lumi të goja, gjithë tok. Mbarova, mbarova, po i vrava mjaft qetë sot.

— Të lumi të ty! Mot për mot, i pari mbaron ti nga të mbjellat. Hajde a do të vish?

— Jo, jo, se jam lodhur. Do të pi edhe një cingar, pastaj do të ngrihem.

— Natën e mirë

— Natën e mirë

— Shiko qetë ore, Sefer, se mos pinë ujë të nxeh të, e porositi edhe një herë të birin Shaqua, një djalë rja pesëmbëdhjetë vjeç. — Mbaji nj'a dy orë në Brinja të kllosin, pastaj jepu ujë e leri, se vete unë i ruaj natën.

Qetë, të lodhur, mezi çapëlehëshin.

— O Shaqo, — i thirri bashkëfshatari i tij që kishte larguar. — A shkoi këtë postjeri i Çorovodës?

— Jo. Pse pyete?

— Kishte një letër për ty.

— Nuk e pyete nga më virte?

— Jo, nuk e pyeta.

— Do të ma ketë çuar Eqremi, — (djali i madh) që

kishte ushtar), mejtoi Shaqua dhë u gëzua, se kishte një muaj që nuk kishte marrë lajm nga i biri.

Megjithëse i merrëshin këmbët nga lodhja, nuk u çlodh fare. Atë cingar që kishte ndezur e mori në gojë, ngarkoi parmëndën me gjithë veglat e tjera të punës në kalët, i hipi edhe vetë më nj'anazi dhe u nis për në shtëpi.

Era e freskët e majit, që kundërmonte nga lulet e nga gjethi i porsa çelur, i ra krahërorit të tij të hapur. Hapi gojën, mbushi gjoksin me atë ajër të pastër dhe, duke menduar se të mbjellat i mbaroi, purët e tjera të bujqësisë i kishte më vijë, letër djali do t'i kishte dërguar, ndjeu një gëzim në zemër dhe i ra kalit që të arrinte sa më parë në shtëpi.

Me të mbrrijtur pyeti të shoqen:

— Ku e ke vënë atë letrën që pruri postjeri sot?

— Në tartabenë t'oxhakut, — iu përgjegj Hatixheja.

Mori letrën, mori edhe kandilin e doli në qoshkur që ta këndonte, se ishte freskët.

— Gëzuar, or burrë, me bereqet ishalla. Të na vijë edhe djali shëndoshë! — e uroi e shoqja pasi u kthyte nga katoi ku lidhi kalin e ku vendosi parmëndën.

Shaqua ruk i foli fare.

— Kush e di ku e ka mëndjen, — mejtoi Hatixheja me vehte. Po kur e pa që ajo po fjaloste dhe i shoqi nuk po i përgjegjej, atëhere e la bisedën përgjysëm dhe e pyeti:

— Ç'ke ti?! Mos ka ndonjë haber nga djali?!

— Jo, moj, jo, — iu përgjegj Shaqua, dhe e mori përsëri letrën, e hapi, afroi përsëri kandilin dhe po e lexonte me vetulla të vrejtura.

— E po folë, ç'thotë ajo letër? Pse rri kështu?! — e pyeti Hatixheja e çqetësuar.

— Është një shkresë nga Çorovoda, i tha më rë fund Shaqua.

Shaquo Bendon e lajmëronin që të vinte në zyrën ushtarake të dorizonte librezën e ushtrisë, mbasi kishte mbushur moshën dhe do të hiqej nga eviderca ushtarake.

— E po folë, de, folë! Për këtë bëhesh merak ti?!
Pas nj'a dy orësh erdhi edhe i biri, Seferi, nga qetë.

— Pa merre atë letër e këndoje, — e urdhëroi Shaqua; këndoje të tërë. Edhe ato të shkrojturat me maqinë.

Seferi e zuri me radhë e e lexoi me kujdes që të mos i shpëtonte asnjë gërmë.

— Pa këndoje edhe një herë që këtu, i tha përsëri i jati dhe i tregoi me gisht që nga ta niste.

Hatixhëja, duke e parë se ajo shkresë e kishte mërzitur të shoqir, e pyeti:

— Po është gjë, or burrë, pse të heqin nga defteri i ushtarllékut, kur ke mbushur moshën?

Shaqua vuri buzën më gaz.

— Është gjë, si nuk është gjë?! Del nga defteri.

Seferi qeshi me zë.

— Ka gjë më të madhe, moj nënë, se sa kur të heqin nga defteri?!

Shaqua e shikoi të birin si me keqardhje.

— Aqë ta arrin ty, or bir, aqë mendon ti.

Hatixhesë, megjithëse u duk sikur u qetësua kur vuri buzën më gaz Shaqua, tanj prapë iu bë hall puna e asaj shkrese, se nuk po kuptonte përse qe mërzitur i shoqi nga shkaku i saj, e nuk e dinte përse e si hiqet njeriu nga eviderca ushtarake. Duke mos dijtur ç'të bënte, hoqi çemberin e shkundi dhe pastaj e lidhi prapë në kokë, e iu kanos të birit:

— Rri ti, nuk po të pyet njeri ty!

Dhe zuri po bluante lloj-lloj mendimesh me vehten e saj: «Po sikur të jetë për të keq kjo heqja nga defteri e ushtrisë?» Pastaj prapë e kthente: «E po pse të jetë? Ne, sa qe lufta, u dogjëm e u përvëlumë; burri bëri kaqë kohë në çetat partizane, me gjithëse ishte me një vatër fëmijë e mua më la kërcure këtu vetëm. Mjaft po ato që hoqa atë dimër që na dogjën shtëpitë e mbeç me fëmijët mes katër udhëve, gjersa më hodhi dorën këshilli e më mblodhi me vetë e me fëmijë... Pastaj, si u çliruam, tokë na dha Partia e qeveria, shtëpitë na i bënë. Para, sa kemi kërkuar hua, Qeveria na ka dhënë. Të gjitha ç'kemi e ç'nuk kemi, nga kjo qeveri i fituam. Edhe re po qeverris i kemi qëndruar gjer më një: me planin, me detyrimet. Djali ka vajtur vullnetar kaqë herë sa qe

pa shkuar ushtar. Burri anagjore. Unë, në fshat, kam punuar e punoj, me atë që di e me aqë sa di, me gjithë shpirt... Nga se na erdhi kjo!...»

Një herë deshi të mos ja thoshte këto mendime të shqit, se mos e bënte merak akoma më shumë, po pastaj nuk iu durua dhe ja çfaqi edhe atij.

— Sa budallaçkë paske qenë, moj grua, dhe nuk të paskam njohur dot gjer tari! Ç'janë këto marrëzi?! — qeshi Shaqua dhe u duk sikur i qe larguar pak mërzija.

Seferi ja krisi përsëri të qeshurit dhe po e ngacmonte tëmër. Shaqua, duke parë të birin, po qeshte edhe ai ca më shumë akoma. Në shtëpi u prish heshtja që kishte pllakosur pak përpara.

Hatixheja hëm qeshte hëm i vinte inat.

— E po thuaj të drejtën, or burrë, — iu kanos ^{të} shoqit, — të ardhka keq që u plake. Por mos të të vijë keq, se plak je, nuk bëhesh dot djalë prapë. Vec mos ki frikë, se unë ruk të lë. Kur s'të lash sa qesh e re, nuk të lë sot me rjë vatrë fëmijë.

— A na e there atë zogun ti, që na kishje thënë se do të na e therje sapo të mbaronim të mbjellat? — e pyeti Shaqua.

— Ua thera, po ti kecin kur do të na e therësh?

Atë darkë Hatixheja kishte bërë zog me thërrime.

Si u hëngër darka, Hatixheja, dy fëmijët e vegjël, që kishinngrënë bukë që n'aksham e kishir fjetur, dhe Seferi, u pshtuallën në konakun e beharit ku flinin. Shaqua mori kalin dhe shkoi nga Brinjat të kulloste qetë.

* * *

Nga fundi i majit nata zvogëlohet shumë, nuk është si në dimër, po Shaqos iu duk muaj ajo natë. Prit të gëdhijihej e s'ka. Në krahëror ndjente sikur i rëndonte dicaka. I shtritur më kurriz, mbuluar me gunët, shikonte nga qjelli dhe mejtonte: «Sikur të mos ma merrnin librezën do t'ishte mirë. Urë mbahem akoma. Do t'ishte mirë që qeveria të mos e thërriste nënë armë njerinë vetëm atëhere kur ai nuk është me të vërtet i zoti pér pushkë».

Në këto kështu «ka-k u u u», ushëtoi një pushkë përetej nga mali pér karshi.

— Ndonjë egërsire që do t'u jetë afruar kopeve do t'i kenë shtirë, — mejtoi me vehte Shaqo Bendua dhe ho-dhi sytë rga pylli që ishte përtëj Brinjave. Qetë e kalin i kishte lidhur tani se mos e zinte gjumi dhe hynin më ndonjë arë e bënин zarar.

Ai pyll i solli ndër mënd rrithimin e ca diversantëve para nj'a tre vjetësh. «Njeriu nuk duhet ta mburrij vehten, duhet ta mburrin të tjerët, tha me vehte Shaqo Bendua, por në këtë hall që ishte ai sot kishte plotësisht të drejtë të mburrej: Po të mos kishte qenë ai më një shteg andej nga pati qenë vërdi më i rrezikshëm, njeri nga diversantët, kryetari i tyre, do të kishte shpëtuar me siguri. Po Shaqua e kishte pikasur e ja kishte mbajtur — jo në kokët se vdiste, kurse ai donte t'i binte i gjallë në dorë, — po nga këmbët. Atje ku ta mban Shaqua atje ta qep plumbin si me dorë. Pa po më ta merr plumbi diversantin çapok më çapok dhe bije shakull rë vend, pa lëvizur asnjë pëllëmbë më tej. Komandanti i njisitit ndjekës e kishte puthur në buzë Shaqon, jo vetëm pse u zu kryetari i diversantëve, por edhe pse dijti ta bënte të zihej i gjallë.

Kujtoi edhe këtë Shaqo Bendua dhe, siç e kishte patikën pshtetur më r:j'anë e shtërngroni fort e tha duke qeshur:

— Mua të më nxjerrin tëkayt që tani?! jo, or jo, nuk është e drejtë aspak. Nuk do ta dorzoj unë librezën.

Pastaj e ktheu përsëri mëndjen: «Them unë që nuk është e drejtë, po pa pyet ligjir: ç'thotë? Jo, or Shaqo Bendua, jo, nuk pyetesh ti pér këtë punë, po pyetet ligji.»

Dhe gjersa e zuri gjumi Shaqua vrau mëndjen se si mund të ja gjente anën që të mos e dorëzonte librezën ushtarake e të mos quhej i dalë rga defteri i degës ushtarake.

Një ditë Shaqua po prashiste misér andej nga Prigova dhe kur qe duke pirë një duhan me Sabrinë, një bashkëfshatarin e tij me të cilin i kishin arat ngjitur e pyeti:

— Nuk më thua, o Sabri, se ti ke qënë kaqë kohë rë rrobën e ushtrisë me rrogë, dhe i di më mirë këto gjëra, a mund të mos e dorëzosh librezën ushtarake dhe a mund

të mos hiqesh nga defteri i degës ushtarake, kur nuk dësheron?

— Jo, o Shaqo, — i u përgjegj Sabriu, nuk është e mundur.

Shaqua tundi kokën si me keqardhje.

— Pse ç'ke ti Shaqo, pse më pyete?

— Të pyeta se para tri ditësh më kanë lajmëruar që brënda dhjetë ditëve...

— Po mirë atëhere, shko dorëzoje, përse nuk do ta dorëzosh? Apo të vjen keq se u plake?

— Të gjeti edhe ty si time shoqe e si disa të tjerë që ma kanë vënë: «Të vjen keq se u plake, prandaj nuk do... Jo, or Sabri, jo, ruk e kam atje hallin. — Shaqua iu ra mustaqeve me kurrizin e dorës një herë tej një herë këtej, dhe vazhdoi: « — Ti je anëtar Partie, dhe gjykon më mirë se unë, por unë them që njeriu duhet të luftojë përvatanin e tij gjersa t'i regëtijë edhe një damar i vetëm, — dhe vuri gishtin e tij të trashë e të bërë me dhe, në venën e zezë e të trashë të qafës. Kemi luftuar për këtë vënd edhe atëhere kur e trashëgonin bejlerët e pashallarët, e jo të mos luftojmë sot që po shkojmë e po rrojimë si zotërnë verdin tonë. Pse, i ri qe yt at që luftoi si partizan ka-që vjet me radhë?! Ishte gjashtëdhjetë vjeç burrë ai! Dhe nuk u përgjunj asnjë herë, por luftoi barabar me neve; më mirë shihte natën se ditën. Edhe unë këtë mendoj tari: ne luftën nuk e duam kurrë dhe mos na pafshin e mos na dëgjofshin kurrë sy e veshë luftë. Por, sikur, sikur të ngrihet njëri atje tej e të na thotë: «Po na i jepni këto ara që na i kini marrë...» e t'i vëré flakën asaj e kësaj, si thua ti, të rri duar kryq urë e shokët e mi?! Ja këto mendoj unë.

Sabriu e dëgjonte duke mos ja ndarë sytë dhe pa në ftyrën e tij me sa sinqueritet fliste Shaqua. «Babaçko është», mendoi për Shaqon e pastaj iu përgjegj:

«Ne themi të mos bëhet kurrë ashtu, o Shaqo, pa perdhi ajo ditë do të ngrihem me kuç e me maç; edhe fëmijët e djepes do të luftojnë e jo ti e unë që po se po.

— E po atëhere, përse të më fshijnë nga defteri?!

— Se gjer n'atë moshë e parashikon ligji. Ata që ka-

në bërë ligjin i kanë menduar të gjitha më mirë se ti e unë.

Shqua përsëri tundi kokën dhe mendoi me vehte:

— Mirë ligji, po ligji duhet të më pyesë mua, kësh-
tu merdoj unë me këtë budallallëkun tim. Mirë, ai që do,
le ta heqin nga defteri, po mua që s'ma do zëmra, përsë?!

Shaqt Bendua e kishte vendosur që të mendohej gjer
një ditë para se t'i mbaronte afati për t'u paraqitur, se
mos gjente ndonjë shkak pér të mos e dorëzuar librezën
ushtarake, por pas bisedimit me Sabri Kulën, e ktheu përsëri
mendjen. Meqerëse kishte pér të shpurë detyrimet e
leshit dhe kishte edhe ca punë të tjera, e mëqënëse i doli
edhe kjo çështja e fundit, Shaqua e ndau mendimin që të
nisej që të nesërmen e asaj dite pér në Çorovodë. Tashti
shpresën e kishte te kryetari i degës ushtarake, i cili, do
të dinte domosdo më shumë rga ligjet e ushtrisë, e do t'i
gjente një nen atje më ndonjë ligj që të mos fshihej Shaqt
Bendua nga defteri.

Të nesërmen, u ngrit herët, bëri gati kalin i hipit dhe
shkoi në Çorovodë.

— Shoku Shaqir, më duket sikur paske rënë pak, je
plakur ca, — i tha kryetari i degës ushtarake. — Kur ishim
partizanë ishje si dif.

Mos ia kanë futur në vesh edhe këtij që unë nuk
dua ta dorëzoj librezën, — mendoi Shaqua me vehte, — dhe
kërkor të bëjë shaka? Apo ndofta nuk ka ndonjë ligjë
që të hijen njerëzit sipas vjeçëve po sipas fuqisë, dhe kë-
tij i kanë thënë që Shaqua u plak, edhe këtij i dukem plak
tani? Pse nuk ma ka thënë këtë fjalë ky edhe herë të tje-
ra kur jemi takuar?

Pastaj, duke e vështruar me ata sytë e vegjël e të the-
llë në një mënyrë sikur të blinte ç'kishte në mërdje krye-
tari i degës, iu përgjegj:

— Kanë shkuar dy mbëdhjetë vjetë që atëhere shoku
major. — E si pér t'i marrë hakun, vazhdoi: — «Pse juve
të ri e dini vehten? Edhe juve qënkeni plakur, bile më
shumë se unë.

— Jemi plakur vërtet pak, po zëmra ruk na plaket
kurrë ne, të marrim gjak në vetull ne, — qeshi kryetari
i degës.

— Kur tē marrim gjak nē vetullt, mua pse po mē fshini nga defteri, — i tha Shaqua seriozisht.

Që këtu nisi biseda pér punën që kishte vajtur Shaqua nē degën ushtarake dhe kryetari i degës ja shpjegoi gjatë e gjërë ligjin e tē gjitha pikë pér pikë. Pastaj zurë nga bisedime tē tjera: pér jetën partizane që kishin kaluar bashkë, pér grurin, pér misrin.

Shaqua, si mori fund bisedimi e si e pa që e zgjati shumë, u ngrit, mori kutinë e duhanit, e futi nē xhep, dhe u ris tē delte duke menduar: «ishalla e harroi librezën e nuk i kujtohet tē ma kérkojë». Por kryetari i degës ushtarake nuk kishte harruar. Duke buzëqeshur, sikur t'ja kishte kuptuar hilenë Shaqos, e la gjersa vajti te dera e i tha:

— Shoku Shaqir, mē duket se harruat tē lini librezën.

— Nuk harrova, or tē shkretën, jo, po s'më vjen mtrë, — u përgjegj Shaqua dhe u kthyep prapë, u afrua afër trapezës dhe futi dorën si me përtim nē xhep. Pastaj, mbasi pati nxjerrë librezën ushtarake nga portofoli, vuri dorër e ashpër nē zemër si pér t'i kérkuar falje që po e zgjaste shumë dhe vazhdoi: Nuk e di, shoku major, a ta thashë ashstu si e kam nē zémër këtë punën time, dhe nuk e di se si e kuptuat juve. Unë dua që Partija e qeverria, tē më njohin zyrtarisht si ushtar tē tyren rë çdo kohë, gjersa tē kem shpirt. Ja këtu e kam hallin unë. Se duke më hequr nga defteri, nuk e di unë, por se si më duket, sikur nuk jam i vlefshëm pér vatanin. S'ka gjë, ju limëni rë listë, tek janë njëqind p.sh., limëni edhe mua, le tē bëhen njëqind e një. Kështu më duket sikur jam më i ngrohtë, sikur...

Kryetari i degës ushtarake **mori librezën** e futi nē sîtar dhe u mundua edhe një herë tē bindëte Shaqo Bendon.

Rrugës duke u kthyer pér nē fshat, Shaqua mendonte fjälët e kryetarit tē degës ushtarake tē Corovodës, i cili i kishte thënë. «Po ta dojë puna, shoku Shaqir, nuk do tē na r'dalojë njeri që tē mbrojmë gjakun që kemi derdhur dhe gjithë tē mirat që kemi fituar. Atëhere, siç kemi luftuar do tē luftojmë, e ligjë mbi detyrimin ushtarak dhe librezë ushtarake do tē jetë ajo që ka tē shkrojtur e tē rrënjosur çdo patriot shqiptar nē zémër.»

HISTORIA E NJË FSHATI

Kishte kohë që punohej për ngritjen e kooperativës bujqësore në katundin Shkozanj. Në fillim patër çfaqur dëshirëri shtatë familje, pastaj, dy-tre muaj më vonë, u bë-në nëndëmbëdhjetë dhe kur vajtëm ne si ekip, pas gjashtë ditësh pune, u rregjistruan edhe shtatëmbëdhjetë të tjera, kështu që, rëga dyzet shtëpi që kishte fshati tridhjetë e gjashë qenë gati të ngritën kooperativën. Prandaj të gjashëtën ditë rë një mbështetje vendosëm që të nesërmen të bëhej inaugurimi. Tërë atë pasdreke zieu kënga e vallja në shkollë ku qemë mbledhur. Rregjistrimi i çdo anëtari të ri pritej me gëzim të madh, sepse ata që u rregjistruan ditën e fundit ishin nga ata që ngulnin këmbë më shumë, e atë ditë erdhër e u rregjistruan mjaft prej tyre.

Sapo qe errur u ngritëm të shkonim nëpër bazat që na pati caktuar këshilli. Siç ishim më këmbë e tek po bë-heshim gati të ndaheshim, se kush tha njëri rëga shokët:

— Domethënë, Muço Kokojka nuk erdhi as sot të rregjistrohej.

E një tjetër shtoi:

— Ore, vërtet, si do të bëjmë, na mbetën ato katër shtëpitë e lagjes së Bregut. Nuk iu dalim edhe një herë sot nga borxhi?

Hapja e kësaj bisede, pa e kuptuar as ne vetë, na gozhdoi përsëri në vënd. Si të bëjmë tek të bëjmë, dikush thosh se po të futet Muçua, ato tri shtëpitë e tjera janë të futura me kohë, sepse nga ai varen. Dikush thosh se Muçua ka ardhur në udhë, ndonjë tjetër ngulte këmbë se atij nuk i njomet kokë me kollaj, po sidoqoftë mendimi i shumicës ishte se edhe Muço Kokojka, ato dy ditët e fundit, sikur kishte ardhur pák në brazdët, prandaj duhej bërë edhe sot një përpjekje e fundit. Për këtë menduan një herë që të vinim për darkë te Muçua, po meqenëse kishim ngrë-

në dy vahte tek ai, vendosëm të shkonim te Veseli, ku na ishte caktuar baza, dhë atje të thërrisrim edhe Muçon e të bisedonim.

Kur vajtëm te Vesel Koçani zjarri digjej bubullimë. Siç e kanë zakon në fshat, me rastin tonë Veseli kishte ftuar për darkë edhe vëllezërënë. Aty ishte edhe Muç Kokojka.

— Hë, sa mirë, — thamë me vehte që të gjithë kur e pamë.

Sapo hymë brënda, të ftuarit e Veselit na u ngritërmë këmbë, u tokëm me ta dhe pastaj u ulëm. Si u përshëndoshëm me njëri tjatrin, u hodh Veseli:

— Të gjithë këta shokët e tjerë i njeh ti shoku Musa, po këtë, dhe më tregoi me dorë një plak që rrinte në këndin e të zot të shtëpisë. — besoj që nuk e njeh, se ky nuk para del. Është Xha Hamiti, kushërirë im. — Pastaj iu kthye xha Hamitit e i tregoi kush ishja urë.

— Qofsh shëndoshë, biro, gjëzofsh të ritë, — më uroi xha Hamiti disa herë me dorën në krahëror e me gjithë zemër. Këtë nuk e kuptova në fillim, pastaj, gjatë bisedit mit, mësova se Xha Hamiti po t'i thoshje se ky është i deleguar nga Komiteti i partisë, ose, ky njeri është i Partisë, ai për ata njerëz kishte dashurinë më të madhe. Fytyra e tij qe gjithë rrudha të shrregullta si të çarat e një toke në verë nga thatësira. Goja i qe bërë fushë, bullçitë i kishin hyrë fare, mjekra i delte përpëra e gati sa nuk i piqe; me hundën. Nga që nuk kishte dhëmbë e thithë me zor çibukun dhe mezi fliste. Ndënë xha Hamitin qe ulur Hysseni, pas tij Lutua e pas Lutos, Muçua. Nga këndi tjetër qeshë unë, sekretari i organizatës bazë të Partisë, Guçia: Myftari, kryetari i Këshillit Popullor të fshatit dhe në fund, sipas zakonit, rrinte Veseli.

Për disa minuta mbetëm pa folur. Sikur të hynte njëri në derët n'atë çast do të thosh: «Ç'kanë këta që nuk flasin me njeri tjetrin, mos janë zënë?»

— Folë, o xha Hamit, — i thashë si për të thyer hesh-tjen, — se mbetëm syqyt.

— Veseli qeshi. — E di unë kush i hap fjalët, — tha, — po ja edhe një cikë sa të na bëhet mezeja.

— Sa vjeç je, o xha Hamit — e pyeta.

— Jam njëqir denjëzet vjeç, biro.

— Po a të dëgjojnë këta djem, nipër, kushërinj, a ua heq veshin ndonjë herë.

— Më dëgjojnë, më dëgjojnë, — tha me besim në vethen xha Hamiti. Pastaj vazhdoi: — Jo se më dëgjojnë për hatër të pleqërisë, po më dëgjon puna mua, se nuk i kam mësuar e nuk i mësoj currë pér keq.

Térë lagja e xha Hamitit ishin futur të parët në koooperativë, prandaj e mora me mënd se xha Hamiti nuk do të qe bërrë pengesë pér ta e nuk kishja tanë përpara një plak që do të na prishtë punë në agjizacionin që do t'i bënim Muços. E me qëllim që ta shpija bisedën atje ku doja vazhdova.

— Ky Muçua më duket sikur nuk të dëgjon, xha Hamit. Përse nuk ja ke hequr pâk veshin?

Xha Hamiti e vështroi e vështroi një copë herë Muçon që rrinte me kokë ulur pastaj m'u kthyte:

— Muçua është i ardhur këtu në fshatin tonë. Ka marrë tokë kur u bë reforma agrare. Por e kam patur dhe e kam edhe këtë si djemtë, nuk e ndaj fare, se i kemi edhe shtëpitë afër. Ky është pesëdhjetë vjeç burrë e nuk duhej që ta mësonte njeri, po ja që u dashka të lodhemi edhe me këtë. Pastaj duke vështruar përsëri nga Muçua tun-di kokën me gjithë çibuk në gojë e tha me besim: — Do t'i mbushet koka edhe këtij, biro, do t'i mbushet. Nuk ka lënë njeri pa i mbushur mëndjen kjo Parti e kjo qeverri.

Në këto kështu Veseli na shtroi rakinë e duke pirë nga një gotë iu derdhëm të gjithë Muços. Mirëpo nuk qe e lehtë të bindej Muço Kokojka!

— Paska ndryshuar prapë, — me pëshpëriti në vesh sekretari i organizatës bazë, — nuk qënka ai Muçua që qe në mëngjes kur bisedova unë me të.

— Lëkundet, — iu përgjegja me ngadalë, duke i përsëritur shakanë që bënim gjatë atyre ditëve që agjitonim.

— prandaj, o burra, ca më nj'anë ca më anën tjetër, të mos e lëmë të rrëzohet.

Xha Hamiti, kohë pas kohe, më drejtohej:

— Do t'i mbushet mëndja, biro, do t'i mbushet.

Më në fund, si e pamë që Muçua nuk po luante nga ajo e tija, deshëm që të gjithë ta këmbenim bisedën. E për këtë e mora unë fjalën i pari:

— Do të më tregosh xha Hamit, — e pyeta, se më pati bërë përshtypje me kohë, — përse i kini bërë shtëpitë këtu në majë të këtij bregu, ku ngordh dërrí për ujë, s'ke ku mbjell një pemë e s'ke ku bën një copë kopsht, dhe pse nuk i kini bërë poshtë në fushë ku kini dhe ujë?

Plaku psherëtiti dhe tundi kokën.

— Atje poshtë në fushë, i kemi patur shtëpitë një herë e një kohë, biro, po pastaj u ngritëm e hodhëm rrënëjë këtu në këtë dërr shtufi.

— Po pse?

— Është histori e gjatë, biro, po bëre mirë që më pyete, tha xha Hamiti duke i përsëritur nj'a dy herë këto fjalët e furdit.

* * *

Dhe xha Hamiti më tregoi atë natë:

„E tërë fusha më parë ka qenë jona. Na kishte zili boia. Shkonim e rronim si ne e asnjeri tjetër më mirë. Ra më gjak një bashkëfshatari i ynë dhe ja shiti pjesën e tij beut të Dushkut e vetë shkoi në Stamboll. Beu, që e kishte maras fushën tonë, aqë deshi sa futi këmbën. Me të blerë mallin, bëri shtëpitë. Më 1837 të senesë¹⁾ kam qënë njëzet vjeç, dhe e mbaj mënd m'u si sot: beu na mbledh pleqtë tanë atë vit e iu thoshte: «Unë kam shumë bagëti e nuk kam se ku t'i mërzej në verë, prandaj të më falni atë copë tokë tek burimi në fushë, që e kini musha, ç'zë hija e plepave». Pleqtë ja falën e ja dhanë me të shkruar që atë ditë. Beu ngrihet që të nesërmend, me të shkrepur dielli, dhe i vë kufit gjer atje ku zinte hija e plepave në mëngjes. Zunë pleqtë tanë, ca me të mirë e ca me të keq, por nuk dëgjonte beu. Vajti puna në qeverri, po beu nxori shkrepësën ku ishin vënë tetëdhjetë gishta e ku ishte shkrojtur ashtu siç kishte dashur beu, se shkresën e kishte bërë vetë ai; ne ishim njerëz të pa ditur, biro, asi kohe. Ishim qorra».

1) Në vitin 1837.

Xha Hamiti mori frymë thellë, mbushi çibukun me duhan e vazhdoi:

«N'atë kohë, i gjyshi i këtij Veselit që është këtu, — tregon Veselin me dorë, — ishte burrë për kokër e burrit. Ja i kishte mbushur dyzet vjeç, ja jo. Vinte i gjatë në bojët, kokën atje lart, shpatullat si div dhe në belt kaqëz, — bashkon gishtin e madh me gishtin tregonjës e bën një rrëth për të treguar belin e hollë të tij. — Sa i pashëm aqë edhe trim ishte. E thoshin Isuf Koçani. E që thua t'i or biro, na mbledh Isufi ne një takëm djemsh e na thotë: «Të vemë natën e të djegim bejnë të gjallë në shtëpi me ç'ka e ç'nuk ka. Gur mbi gur të mos i mbetet themelit të tij...». Gati qemë ne të gjithë, njëzet e ca djem. Mirëpo na marrin vesh pleqtë e nuk ra lanë. «Do ta ndjekim me qeverri, thanë ata, «se po të bëjmë ashtu, ne djegim atë, po sporua e beat, me gjithë qeverinë, që e ka me vehte, na djeg ne të tërëve». I fualën edhe Isufit. Mirëpo spiuri ja futi në vesh beat se ç'deshi të bënte i gjyshi i Veselit. Dhe beu, dhëpër, hiç nuk e bëri vehten qeder, u shti sikur nuk dinte e nuk kishte marrë vesh gjë fare. Veç qahallarët i shtoi ama, e ata lanxhot, hanin e pinin e «pam» shtinin me nishan tërë ditën e përendisë: tjetër zanat nuk dinin të bënin ata».

Xha Hamiti tregonte, kurse ne hidhnim nga një gotë e dëgjonim pa ja hequr sytë. Kur çlodhej ai, kur merrte nga një gotë apo kur thithët çibukun e mejtohej pakë, si për të sjellë rëdër mend ngjarjen, ne na dukej sikur do të ra thosh: «kaqë e nuk mbaj mënd më tutje», prandaj ishim gati t'i rrinim qiri më këmbë për çdo gjë, veç tregimin të mos na e linte për gjysëm. Në këto kështu, Veseli gre gotën e na thotë:

— Hem të dëgjojmë, hëm të pimë.

— Si duket, nuk qe vetëm dëshira t'na bënte ne të pinim, po kujtimi i rgjarjes e bëri që të hidhët me doemos një gotë n'atë ças. Muçua dëgjonte me vemendje të madhe sa edhe unë.

«Isuf Kokojka, ndjesë pastë, të na falë që po i lëndojmë plagët e eshtrat atje ku ka rënë», vazhdoi Hamiti me një dhimbje të thellë dhe sikur i shkëlqyen ata sytë,

«kishte katër fëmijë: tri çupa dhe një djalë, të jatin e këtij Veselit. Djalën e kishte më të voglin: nj'a tre vjeç e gjysëm. Çupën e madhe e kishte fejuar në Qafë, i kishte prerë edhe ditën e do ta martonte një ditë pas Bajramit të Vogël. Ditën e Arfasë kishte vajtur në pazar, kishte marrë sheqer për hallvër që bëjmë ne sipas zakonit, për të gëzuar fëmijët, u kishte blerë fëmijëve ndonjë sheqerkë e ndonjë simite, kishte marrë ç'i duheshin edhe për dasëm: ndonjë plaçkë për çupën, se të shumtat, ç'kishte për t'i dhënë pajë me vehte çupës, i pati bërë hall me kohë, dhe u nis të kthehej për rë shtëpi. Por në shtëpi nuk u kthyte atë natë. Prit e shoqja t'i vinte burri në shtëpi e s'ka. Ashtu më tre a katër të natës allaturka na lajmëron ne vëllezërinë. Duallëm të gjithë jashtë. Ku ta kërkonim? Thirrëm ço sa herë, po zë njeriu nuk përgjigjej. Pyetëm ata që kishin qenë në pazar: njëri na thosh që e pashë gjer te Guri i Çarë, tjetri na thosh se qesh bashkë me të gjer te Rrapet, tjetri thosh se ishte prapa meje dhe e pashë që hyri me gomarin përpara në kufi me fshatir tënë. Tërë atë natë i thirrëm dhe e kërkuam, po nuk e gjetëm dot. Ashtu nga mezi i natës vjen gomari ngarkuar me plaçka e pëllet në mes të oborrit. Atëhere e shoqja dhe fëmijët ngritën kujën. Mirëpo ç'të bërim e nga t'ja mbanim? U muarr vesh që diç do t'i kishte ngjarë, po kujt i shkonte mëndja se do ta kishte gjetur ajo që e pati gjetur. Tërë atë natë u gëdhimë nëpër ferra e shkarpa. Kur dha Perëndia mëngjezin u mbluadhëm, e bashkë me re vllerzëirë erdhi edhe i tërë fshati. Thanë pleqtë: «Gjersa është parë se ka hyrë në kufi të fshatit tonë, mos shkoni larg, këtu përqark ta kërkojmë. Aty afër drekës e gjetëm, po si e gjetëm? dhe ku e gjetëm?! ku nuk na e priste mendja kurrë. Atje posht, në mes të fushave, ku është ai copë pyll me lisa edhe sot, ka qerë pyll që atëhere. Atje e kishin futur dhe e kishin vrarë me thika. I kishin dhënë njëzet e shtatë plagë, e kishin bërë lakër. Një thikë ja kishin futur në zëmër, si duket me atë e kishin bërë zap. I kishte shpuar thika anën e mëngores. — Kish patur simitet e fëmijëve rë xhepin e mëngorës, — nëpër simitet e i qe futur thellë në zemër. Kushedi sa qe përpjekur i

mjeri Isuf e kushedi sa do kishin qenë ata që e kishin mposhtur, se nuk rrëzohej kollaj ai trupi i tij si lis me dega! Një copë vend, sa një lëmë, qe bërë sikur të kishin gërmuar derrat dhe gjithë gjak «Oh! Cuke, Cuke! Të paskan vrarë, o bir! Ju thafshin krahët atyre që të vranë!.. thirri një xhaxhaj yrë dhe bashkë me të i ramë të gjithë përsipër. Isufi, ndjesë pastë, qe shtritur më kurriz, kishte hapur duar e këmbë, shtrënguar grushtat, dhe ishte mbuluar i téri me gjak që te koka e gjer te këmbët.

Xha Hamitit po i dridheshin ato duart gjithë rruudha sa nuk mbante dot cibukun në dorë. Buza i dridhej nga një ngashërim i përbajtur me zor, por prap e mblodhi. Mori gotën: «pini djem», na tha ne dhe uroi: «Zoti i dhëntë ymër kësaj qeverrie e kësaj partije e të rrojnë sa baba Tomorri!»

— Po pastaj o xha Hamit q'u bë? — e pyeta.

«Pastaj, or biro, lajmëruamë në qeveri. Erdhën e panë dhe që atë ditë, sa u kthyem nga varrimi i të mjetit Isuf, na muarrën xhandarët që të gjithëve, c'ishin meshkuj në fshat që gjashtëmbëdhjetë vjeç e lart, na vurnë përpara, na shpunë në burg dhe na vunë drunë. «Tregoni» na thoshin «kush nga juve e ka vrarë Isufin». Na mbajtën në burg katër muaj. As na nxirrin në gjyq as gjë prej gjëje, veçse ra kalbën në drutë. Po vinte koha të çaheshin ugaret për misër, po në fshat s'kishte asnjë burrë. Ngrihen gratë tona dhe i bjenë beut ndër këmbë: «Aman, o bej, na shpëto burrat e djemt!». Dhe beu iu thotë grave: «Çojuni haber burrave që, kur t'i pyesin: «kush e ka vrarë Isufin?» ata të thonë: Ne nuk e dimë. Beu e di se kush e ka vrarë Isuf Koçanin, se në tokën e tij është vrarë». Na vjen neve ky haber në burg dhe ne thainë əshtu siç na çuan lajmin gratë. Atëhere rra nxuarren nii gjyq. Edhe në gjyq njëqind e ca veta sa qemë thamë: «Ne nuk e dimë kush e ka vrarë Isuf Koçanin. Beu e di, se në tokën e tij është vrarë». Pas gjyqit na mbajtën edhe nj'a tri javë në burg dhe na lëshuan. Mirëpo, kur erdhëm në fshat, beu e kishte rrethuar edhe gjysmën tjetër të fushës, e kishte bërë ugar, e kishte punuar për së dyti dhe po e mbillte. E tërë fusha me gjithë atë që n

pati marrë me gënjeshtren e hijes së plepave, tani qe bërrë e beat. «Bej, ç'është kjo që ke bërë?!» i tha fshati i gjithë. C'kam bërë?! «u përgjegj beu, «mallin tim e kam», e ç'ta zgjasim, o biro, u ngrit i tërë fshati dhe e hodhi bejnë në gjyq: «Na ka zaptuar beu mallin.». E thirrën bejnë e beu u përgjegj: «Nuk u kam zaptuar ndonjë mall unë këtyre, malli është imi. Këta e kanë thënë me gojën e tyre mu këtu përpëra gjyqit që Isuf Koçani është vrarë në tokë time. Po të mos ishte toka ime ajo, këta, si do të thoshin ashtu si kanë thënë?!». Kështu, or biro, edhe qeve-rija e nxirë e asaj kohe i dha të drejtë beat. Si e fitoi mali tonë edhe me gjyq, beu pastaj na shkuli shtëpitë ne të gjithëve dhe u shtrënguam e i ngritëm këtu në majë te këtij bregu, në këtë shtuf ku na sheh sot. Edhe pastaj ra bëri bujq të tijt. Ja kështu ka rrjedhur puna që më pyete ti or biro, pse jemi ngulur në këtë greminë.

Xha Hamiti e pati mbaruar tregimin e tij. Por mua më mbeti peng, se desha të dija si u vra Isuf Koçani, prandaj bëra si bëra dhe prura përsëri fjalën atje ku doja dhe pyeta:

— Po Isufin a u muar vesh se si e vranë, o xha Hamit?

— U muar vesh, biro. Hazis beu, kështu e quanin bejnë e fshatit tonë, kishte tridhjetë e ca qehallarë. Një nga ata qe edhe Abdyli, djalë i vetëm, djali i një plake që e pati rritur jetim shërbëtore tek beu. Ai qe xhevahir djalë. Kush'e di sa herë më pati thënë asi kohe: «Or Hamit, or vëlla, nuk rrihet tek beu, është helëm buk'e tij, po ç'të bëj?! ku të vete e të pshtes kokën?! jam pa shtëpi, pa katanzi!...» E më vinte keq për të, më këpuntej shpirti. Si u vra Isufi, Abdyli, nuk e pata parë. Paç pyetur po më patën thënë se ishte i sëmurë. Pas nja tre muajsh kur shoh një ditë që më vjen Abdyli në arë tek po lëroja. Qe bërë dyllë si limoni. U habita. Ku kishte vajtur ai shëndet?! Ku kish-te vajtur ajo bukuri. Njëzet vjeç djalë dukej si plak njëte qind vjeç.

— Lëri qetë e hajde fjalosemi, o Hamit. — më thottë. Sytë i qenë zhgabërryer e vështronë sa djathtas, majtas. Shikonte duart e bënte sikur i pastronte nga diçka. Pastaj mundohej t'i fshinte nga unë.

U ulém tē dy buzë ledhit e unë ndeza një duhar. Abdyli shikonte gjithnjë me frikë rrëth e përqark dhe tē tremboëtë me ata sy që nuk e kuptoje se kë vështronin.

— Ju nuk e dini, o Hamit, — më tha që tej tēhu. — kush e vau Isufin, po Isufin e vramë re. Dhe hëm bënte sikur pastronte duart si në fillim, hëm mundohej t'i fshihte.

Luajta nga vëndi dhe kushedi si u bëra në fytyrë.

— Aman, mos më vra! — thirri Abdyli, — se mua më ka vrarë Zoti, — dhe u mblosh sa një grusht duke m'u lutur i llahtaruar. — Mua më ka vrarë Zoti! Mua më ka vrarë Zoti!

— Si e vratë, — e pyeta, — mor t'u mbylltë dera?!

Dhe Abdyli duke u dredhur i téri si purtekë, më tregoi fije e për pe:

— Më muarrën me zor. «Po nuk erdhe do tē tē vrasim», më thanë. Qemë pesëmbëdhjetë veta. Katërmëbëdhjetë u fshehëm në pyll dhe njërin e nxuarëm në rrugë. Ai priti Isufin sa erdhi nga pazari dhe e gënjeu, i tha: «Hajde se tē kérkon beu pak atje lart». Kur erdhën gjer buzë pyllit, ku shkonte rruga për rë shtëpinë e beut, duallëm tē gjithë dhe ju hodhëm. I zumë gojën me peshqir dhe hymë thellë në pyllë. Po i griu me grushta e me shqelma. Një tē shtyme iu jepte qehallarëve, tre nga ata rrézonte përdhe. Kaqë eshtë përpjekur, or Hamit, kaqë eshtë përpjekur...

— E si m'i tregoi tē gjitha këto. — vazhdoi xha Hamiti, — Abdyli më tha: «Po unë, o Hamit kam që atë natë që nuk mbyll sy as ditë as natë. Më bëhet sikur dëgjoj rënkimet e Isufit, më del Isufi përparsa me një thikë në dorë e më rdjek, e më ndjek, e më ndjek. Më bëhet sikur më shtje në dorë e më bën trupin lakër me thikë. Atje në mes tē pyllit më bëhet i shtritur, i vrarë Isufi. Pastaj e shoh me sy hapur sikur «hop» ngrihet më këmbë e ashtu i mbuluar me gjak më lëshohet me vrap. Thérres, ulérij... Pastaj nuk e kuptoj se jam në dhomë. Dhoma më bëhet pylli e në mes tē dhomës, si në mes tē pyllit, më bëhet sikur kacafytem me Isufin. Qahallarët e beut ngriher e më zënë, më mbajnë lidhur... Aman, o Hamit.» — më tha Abdyli, më në fund, «të tregova ty, se ndofta nuk do të më çfaqet

më Isufi, po ja, ja! po vjen përsëri Isufi të më vrasë!» zuri të ulërinte Abdyli, «ja tek u ngrit nga pylli, shikoje tek mundchet të nxjerrë thikën nga zëmra pér të ma ngulur mua. Amani! Amani! Mbromë. Pastromëni duart të mos m'i shohë me gjak!»

— M'u errën sytë, — vazhdoi xha Hamiti, — po nuk desha ta vras veç e mallkova «tpy, lanet qofsh! Tpy, lanet tē qoftë shpirti!» me gjithse më vinte edhe tē pështirë edhe keq pér tē. Në këto kështu na u dhanë nj'a shtatë a te tē qehallarë tē beut dhe erdhën e rrëmbyen si tē tērbuar a e hoqën zvarrë. Si u larguanë e kuptova që po e pyesrin nëse më kishte treguar mua gjë apo jo. Por ai s'qe në vëhte, vetëm ulurinte: «Pastromëni duart!» Njëri nga qehallarët që qëndroi me mua më tha: «Èshtë çmëndur, nuk di c'thotë. Kot së koti i çfaqen hije.» Të nesërmen muarrrëm vesh se e kishin nxjerrë atje poshtë te korija e e kishin vrarë Abdyl zinë qehallarët e beut. Qante e éma e ulërinte sa i ngjethej misht téré fshatit e ruk e dégjonim dot. Vdiq edhe ajo pas një muaj kush'e di nga se. Edhe sot e kam pérpara sysħ Abdyl zinë me ata gishtérinjtë e hollë si shkarpë, llapat e veshëve tē holluara sa i dukej drita tejpertej dhe me atë qafën si gisht. Sa i llahtarshëm u bë-kësh njeriu!...

— Kështu, or biro, — vazhdoi, më së fundi xha Hamiti, — kështu u muarr vesh edhe se kush e se si u vra i mjeri Isuf. Pa po, pa mbushur motin Isufi që qe vrarë, Ymer benë, djalin e vetëm të beut, e gjetën të vrarë te stanet, dhe në krye të gjashtë muajve të tij vdiq edhe Hazis beu vetë. U duk sikur u mbyll, me nder ajo hale. Mbeti shtëpija e beut në femra. Mbeti e shoqja dhe dy të bijat. Mirëpo, pa mbushur të dyzetat Hazis beu, të dy të bijat u martuanë e i futën dhëndurrët brënda. Derrat, po siç e di, një hundë karë.

Në na pati munduar beu i parë një herë, dhëndurrët e tij na munduan dy herë. E ajo sporo na mundoit e na piu gjakur: gjer ditën që erdhi Partija, or biro. Katër djem nga fshati ynë, në një ditë i kanë pushkatuar këta bejlerët tanë mu në mes të fshatit në kohën e ballit e të gjermaneve, pale pastaj sa hakarete të tjera punuan!...

Tregimi i xha Hamitit na la mbresë të gjithëve dhe asnjeri nga ne nuk po e hapte gojën. Xha Hamiti mbushi edhe një herë tjetër çibukun me ngadalë e si i lodhur, mori mashën, i vuri një thëngjill mbi të e po vështronë lart në një vënd të pacaktuar mbi mur i menduar e sikur të shikonte atje, si rë një ekranë kinemaje, të gjitha tabllotë e asaj ngjarjeje që na tregoi. Fytyra e tij gjithë rrudha e sytë e tij të lodhur, tregonin sa shumë kishte parë e dëgjuar e sa shumë kishte vojtur ai në jetë. Muçua mejtohej me sytë përdhe duke dredhur e spërdredhur një xhufkë lesh të flokjes që qe shtruar, të tjerët heshtnin duke thithur cigaret e unë i pata ngulur sytë një rrugozë të qepur e të mbushur me misër rë fund të konakut e po mendohesha. Më në fund e theva heshtjen i pari:

— Shumë ka hequr ky popull, o shokë. — u thashë,
— nuk duhet ta harrojmë kurrë të kaluarën.

Xha Hamiti, përnjëherësh i hoqi sytë nga muri me shpejtësi, sikur diç t'i qe kujtar dhe foli me zë të kthjellët, duke vështruar nga Muçua, që nuk po i ngrinte sytë akoma e sikur fliste vetëm për të:

— Po, biro, kurrë ruk duhet harruar e kaluara. Njeriu sot duhet të shikojë nga njëherë prapa, të vështrojë mirë ç'ka rrëth e qark dhe pastaj të ecë përpëra me zemër të ngrohtë.

Sa më shumë fliste aqë më shumë gjallërohej zëri i tij e dukej sikur kanosej. Muçua vazhdonte të rrinte gjithënjë me sytë përdhe.

— Ngrije kokën, o Muço, — i thirri xha Hamiti, — ngrije kokë: shikomë mua këtu. Këtyre shokëve nuk ua ke hapur zëmërën, nuk u ke thënë se përsë nuk do që të hysh në kooperativë, edhe unë nuk e pata dijtur, por sot në mëngjes, pa dashur as ti, të shpëtoi goja e ma the.

Muçua ngriti sytë e vështroi sikur ta pyeste: «Ç'të thashë? Xha Hamiti bëri shenjë me kokë sikur donte ta siguronte se me të vërtetë ja kishte treguar ku e kishte hallir, dhe vazhdoi:

— Ti Muço kujton se po të hysh në kooperativë i bëhet mirë vetëm qeverisë, e ty nuk t'u bëka mirë. Mbushe kokën, o Muço, se Partia e qeveria duan të na shikojnë sa

më mirë e më mirë. Në ke një rrugoz me misër sot, Partija do që të kesh dy, tre, katër. Pa edhe sikur, edhe sikur t'i bëhesh mirë vetëm qeverisë e Partisë, ti, burrë plak, që ke vojtur si ne të gjithë e që ke hequr e ke parë shumë, nuk duheshe të ndaheshe nga fshati. Kush'ë di, edhe ti që kishje mbetur pa tokë deri dje, kështu si ne do t'ja ketë zaptuar tët gjyshi beu juaj.

Muçua po rrinte tani gjithënë kokëvarur e si i menjtuar. Ne të tjerët nuk po flisnim. Pas një çasti heshtje xha Hamiti e mori përsëri fjalën me shpirtin akoma më të ndezur:

— Që kurse janë hapur këto fjalët e kooperativës nuk të kam folur, o Muço, se çfarëdo që të më thoshin do ta besoja, po sikur të më thoshnin: «nuk do Muçua të hyjë në kooperativë», këtë nuk do ta besoja kurrë. Sot në mëngjes, kur e mora vesh, se unë jam plak e nuk dal, më erdhi rëndë për ty, prandaj edhe mora shkopin e të erdha në shtëpi. Mirë që na u dha rasti e u mblohdhëm edhe tani bashkë, se e zbraza barkur, tani nuk më mbetet merak. Mos të të vijë rëndë pse të flas. Në të ardhët e tharët sot, do të vijë e ëmbël nesër.

E duke e tundur çibukun në drejtim të Muços, iu kanos si për të fundit herë:

— Muço, Muço! vëri gishtin kokës e mendohu mirë. Ti kujton se duke kullotur vetëm, do të hash më mirë; po mba jji mënd rga unë plaku këto fjalë: «një dele që ndahet nga shoqet, atë e zë ferra, e ha ujku». Delja kullot më mirë kur ka çobanin përpëra, çobani e di ku e çon e ku janë çahiret më të mirë.

Pasi patëm ngrënë darkën, ramë të flinim, se qemë të lodhur dhe të resërmen do të ngriheshim herët e do të kishim punë gjithë ditën.

Në mëngjes, pa u mbledhur akoma i gjithë fshati, shoh Muço Kokojkën të rruar, të ndëruar, e të qeshur, që hyri në shkollë me gunën krahëve. Pa u ulur fare më hoqi më nj'anë e më pyeti:

— A e ke me vehte atë listën e shokëve që kanë hyrë në kooperativë?

— Këtu e kam. — iu përgjigja.

— Nxirre dhe rregjistromë edhe mua, — më tha.

K U Q A L I

Myftar Dushku, kryetar i kooperativës «Partizani» dhe Nevruz Ostrovica, nëpunës i ministrisë së bujqësisë, mbasi kishin mbaruar punë brënda, dualën përpëra zyrate të administratës e po bisedonin. Myftar Dushku po i tregonte Nevruzit depot e reja, që kishte rgritur kooperativa, stallat, ndarjen e parcelave. E ndërsa po ja caktonte me dorë se që nga fillonte parcela e pambukut e deri ku mbaronte, të dyve përnjëherësh iu vanë sytë te Tahir Salillari, që po i vështronte nga larg duke e mbajtur dorë: si strehë mbi ballë, me mustaqet bigë e me kokën atje lart. Myftari e la fjalën përgjysmë dhe i thirri:

— Ti, Tahir, je?

— Unë.

— Mbaruat andej më ato të prashiturat?

— Mbaruam.

— E po hajde lart bisedojmë, ç'rri aty. Hajde, se na ka ardhur Nevruzi nga Tirana.

— Ai Tahiri i Kuqalit është ky, ë? — i tha Nevruzi Myftarit. Bëre mirë që e thirre, se më ka marrë malli për të.

— Ai i téri. E mbajtke mënd Kuqalin e Tahirit?

— Si të mos e mbaj mërd? Harrove ti ç'kemi hequr me 'të atëhere kur ngritëm kooperativën? Harrohet kollaj Kuqali i Tahir Salillarit?

Të dy qeshën pa të keq.

— A beson se, që atëhere, ja harruan llagapin fare kooperativistët Tahirit dhe tanë ca i thërresir Tahiri i Kuqalit e ca të tjerë Tahir Kuqali? — i tha Myftari Nevruzit.

— Vërtet thua? — pyeti me buzë në gaz Nevruzi.

— Nuk të gënjej, vällahi.

* * *

Përse nuk e kishte harruar Kuqalin e Tahirit Nevruz: Ostrovica dhe përse i mbeti Tahirit të Salillarëve Tahir-Kuqali, kjo është një histori e tèrë.

Si bujk Tahir Salillari nuk e kishte shokun në fshatin e tij. E kishte zënë pendër: që 15 vjeç dhe, si merakli i madh që ishte, po të vinte ai n'arë, mos ja kishje gajlenë-fare, se atje ku vinte dorë Tahiri, sikur thërrime bereqeti të mos pëlciste gjetkë e gjetkë, atje do të bëhej si vdekja. Mirëpo, sado që punonte e robëtonte, dorën mbi vesh nuk e pati hedhur kurër rdonjë herë. Djersën e tij e pati derdhur yzmeqar nëpër botë. Kush ishte pa bukë në fshat? Tahiri. Fëmijët e kujt ishin copë e trokë? Po të Tahirit.

Pas çlirimt, sapo u bë reforma agrare, Tahir Salillari mori tokë i pari në fshat. Kur shiu monë e parë grurët dhe e kish hedhur togun në lémë, gati për në hambaret, ndezi një cigar të çlodhej dhe i vuri shpatullat murit duke vështuar grurin si flori me zemrën plot. N'atë kohë Nafija, çupa e tij tetë vjeçë, i vajti prarë dhe i tha:

— Baba, pse s'ka ardhur Qemal beu për të marrë grurin?

— Tashti e kemi tonin grurët. Nuk vjen më beu të na e marri, — i u përgjegj ai dhe i përgëzoi flokët.

— Të gjithë tonin e kemi?

— Të gjithë. Asnjë thërrime nuk do t'i japim beut. Kemi edhe tjetër pa shirë akoma.

Sytë e fëmijës ndriçuan nga gjëzimi, por shihej rdërtta edhe një si frikë se mos i jati e gënjenjtë. Po kur Tahiri i bremttoi se nga ai grurë do t'i blinte një fustan të bukur. Nafija e vogël iu hodh në qafë, e puthi dhe pastaj zuari po kërcente rëpër lémë me një këmbë rrëth e përqark toqut me grurë duke kënduar:

— Hej, shyqyr moj Perëndi! Hej, shyqyr, moj Perëndi!

— Tahiri u mallëngjye, iu mbushën sytë me lot dhe tha me vehte:

— Po, moj bijë, paska patur Perëndi edhe për neve. Të rrojë Partia, që na shpëtoi!

Dhe nuk pati lënë njeri pa ja treguar këtë rëgjtarje. Sa

herë e tregonte, i përtëritez mallëngjimi i atij çasti dhe gjithënje e mbyllte tregimin me këto fjalë:

— Kush ja ka me të padrejtë kësaj partie, atij, m'e parë e punës, mallkimi i fëmijëve do t'i bjerë si thikë në zemër e do ta mbërthente top në vënd.

Nga gruri që i tepëroi atë mot, Tahiri bleu rjë lopë barse. E kështu, mot për mot, zuri të vinte nga një çikë gjë të gjallë: jo dy dhën, jo një copëz gomar... Lopa që bleu i bëri një viç mashkull këtu e atje tej sa një vishkull. Që sapo lindi viçi, e shoqja mori nj'a tri a katër të verdha veje, ja hodhi në gojë, se kishte dëgjuar që të verdhat e vezës e ndihmonir: viçin të rritej me trup të lidhur.

— Ky viç do të bëhet një goxha ka, — i tha Tahiri së shoqes, — dhe do të na shpëtojë. Veç kij kujdes mos i mer shumë qumësht lopës, që të ketë të pijë mirë, se që tani, sa është i vogël i forcohet kocka.

Në fillim viçi e kishte qimen të verdhë, po pastaj, duke u rritur, iu ndrrua, iu bë e kuqe. Që atëhere fëmijët e Tahirit ja vunë emrin Kuqal. Kur delte nga katoj në mëngjez, Kuqali lozte rjë copë herë në oborr: ngrinte bishtin përpjetë, fuste kokën midis dy këmbëve të para, hidhte shqelma dhe kërcente.

— Ho, ho, Kuqali! ha, ho, Kuqali! — gjëzonin fëmijët e Tahirit e hidheshin edhe ata mbas tij. Ai vinte u lëpinte duart e pëlliste: «meee».

— Të keqen e zërit ore, — e përgëzonte Gjylua, e shoqja e Tahirit, që brënda.

Tahiri, duke e vështruar tek lozta, èndëronte ditërkur do ta zinte nd'arë të lëronte me 'të dhe mejtonte: «Do të bëhet bojë e parë, se duket, shiko sa i ka të gjetë kërcinjtë! Do t'i ngjajë s'ëmës».

Kuqali, në tërë ato shërbime, u rrit si ndonjë bir i vetëm e u bë me të vërtetë goxha ka. Në vjeshtë mbushi tre vjeç dhe Tahiri e mësoi në mbjelljen e të lashtave. Nj'a një javë harbonte, luante sa posht lart; nuk ishte e mundur të qëndronte në brazdët, po pastaj u shtrua. Tahiri e rojti si të dy sytë mos i jepte ndonjë huq dhe mbas një Jave Kuqali u shtrua në parmerdët sikur të paske lindur i mësuar.

— Shpëtove me këtë dem, o Tahir, — i thoshin fshatarët tek e shihnin që lëronte. Pa shiko, mashallah, çfar çapi që ka!

— Shpëtova, me të vërtetë shpëtova, — u përgjegj Tahiri, — por do të shpëtoj fare kur të më bëjë edhe një tjetër lopa e t'i bëj pendë. Atëhere lopën do ta kem vetëm pér qumësht, nuk do ta zë më ndarë. Dhe i gjëzohej Kuqalit tek e vështronë, që hiqte parëmëndën pa u shtrënguar e ja bënte «fu-fu» me hundë s'ëmës si i zemëruar me të, që nuk ishte në gjëndje ta ndiqte e të shkonin njësh.

Kurrë ruk e pati shpuar Kuqalin Tahiri me bodec se ai nuk qaste bodec. Kur zëmërohej Kuqali me t'ëmën dhe e merte zvarë. Tahiri i thëriste:

— Oha, Kuqal! oha, Kuqal! Na, ore, budalla! Na, të keqen e krahat, na! q'bën kështu?!

Një ditë e shoqja ja shpuri vetë bukën Tahirit n'arë dhe kur e pa si lëronte Kuqali, ja bëri tri herë, «marshallah! marshallah! marshallah!» fërkoi hundën me dorë dhe pështyjti tri herë «tpu, tpu, tpu». Pastaj i tha të shoqit:

— Pse s'më thua, or burrë, t'i bëj gjësendi këtij kau, se mos ra e marin më sysh? Apo nuk i kemi edhe arat buzë rrugës dhe e shikojnë të gjithë.

Q'atë ditë, me të vajtur në shtëpi. Gjylua mori dy dhëmbë qeni, i qepi në një copë rrip e ja vuri Kuqalit në ballë. Pastaj, në një copë reckë hodhi ca thërime krype, një anë mustaqe të maçokut, një çikë të pëgërrë, dhe si i pështolli tok, ja lidhi edhe ato kaut në ballë me një copë gjalmë.

— Tani, i plaçin sytë atij që do t'i venë më Kuqalin tonë! — tha, duke e hequr merakun se mos ja mernin më sysh kaun. Tahiri u gjëzua aqë sa u gjëzua edhe e shoqja dhe iu kthye:

— Mirë bëre, o grua. Rrofsh që të vajti mëndja! Si nuk qemë kujtuar më përpara?

I gjithë fshati e kishir zili Kuqalin e Tahir Salillarit, jo pér gjë tjetër, se qe të mirë kishte plot në fshat, por se pse ishte shumë i bukur dhe ngadalë-ndagalë, duke u rritur, u bë bojë e parë. Kur e gjente ndonjeri duke kullo tur në pyll i vinte pëllëmbën e matëte, rjë herë pér lar tur

tësi, pastaj për gjatësi, dhe si bënte edhe nj'a dy hapa prapa e e vështronte një copëz herë, thoshte me vehte: «marshallah! me të vërtet ka për sevda është. Mirë e ka Tahiri që thotë: «Kuqali im e s'ka tjetër».

Sa herë që ja kërkonin pëndën Tahirit për ndihmë, edhe sikur të kishte rjeri për të lëruar nevojtari që ja kërkonte, Tahiri kurrë nuk e pati dhënë pëndën vetëm, por bashkë me pëndën shkonte dhe vetë ndihmonte, sepse kishte frikë ta linte Kuqalin rë dorë të botës; se sa për Muriçen (kështu ja kishte vënë emrin lopës që i zoti nga i cili e bleu) nuk e kishte edhe aq hall. «Më mirë më vrissni», thoshte, «se sa të jap Kuqalin për të lëruar pa qënë vetë». E kur s'kishte kohë të vinte edhe vetë, nuk e jepte përdënë sikur tërë ditën e tërë natën t'i luteshe.

Pas dy mëshquerreve lopa i bëri prapë një viç mashkull, se pillte për mot. Atëhere Tahir Salillari u çmënd nga gjëzimi. Edhe tre katër vjet Murica ishte e zonja të lëronte dhe kur të plakej ajo, atij i bëhej kau tjetër. Prandaj edhe vendosi të mos kërkorte para hua nga krediti agrar për të blerë ka, por për të bërë shtëpi. Kjo ishte lalmija më e madhe e tij. «Tokë kanë djemtë» thoshte me vehte, «se shqyr na dha shteti sa deshëm. Pak bagëti për dhallë i kemi, pëndën e qeve po e rregullojmë, tani vetëm t'i bëj djemtë edhe me shtëpi, se na piu e keqja në këto kasolle, e pastaj jam i lumtur. Ju kam dalë djemve nga borxhi, ata pastaj, po të jenë të zotët, do të rriten dhe le të shtojnë sa të duan, po të bëhen të hajrit, për vehte dhe për mua».

Kjo dëshira për të bërë shtëpi të reja Tahir Salillarit nuk i kishte lindur kët. Ai, mot për mot, nga ato që i tepronin e që i shiste, diçka kishte hequr më nj'anë ca para. Pak ishin, po bereqaves. Shteti i jepte kredi dhe kjo ishte kryesorja. Pastaj, nuk ishte vetëm puna se i jepte shteti kredi, por ajo më e rendësishmjë që se Tahiri e shihte veshen në gjendje tani që ta përballonë shlyrjen e borxhit, që do t'i merte qeverisë pa bërë ndonjë cen në shtëpi. Një darkë e bisedoi këtë punë edhe me të shoqen. Ajo u gjëzua, por edhe nuk ndejeti pa i thënë: «Veç shiko, or burrë, se mos kredhemi në borxhe». «Jo, jo» iu përgjegj Tahiri, «i kam bërë hesap të gjitha unë». Të tre djemt. m'i madhi

dhjetë vjeç, dhe të dy çupat dëgjorin këto bisedime, iu shëndrisnin sytë në flakën e zjarrit nga gjëzimi, dhe kur ranë të flinin, ndejtën rjë copë herë të madhe ndënë jorganet duke u fjalosur «çy-çy-çy», me njëri tjetrin e duke pushtuar shoqi-shoqin sikur të kishin hyrë që atë darkë në shtëpirë e re.

Kolektiva bujqësore kishte motmot e ca që ishte ngritur në fshatin e Tahirit, po ai nuk pati hyrë, sepse kishte merakun e Kuqalit.

N'ato ditë që Tahiri po mendonte se si, qysh e tek do t'i ngrinte shtëpitë e reja, erdhi në fshatin e tij një ekip për të ngritur kooperativën. Kryetari i ekipit ishte Nevruz Ostrovica, shok që pati punuar në ato anë katër vjet, sa që lufta, dhe e njihnin edhe kalamajt e djeçes. N'ato arë Nevruzi pati punuar edhe dy tre vjet të tjerë pas çlirimt. Ai Nevruz kishte qenë edhe kur u ndanë tokat. E kur nj'a dy a tre vetë atje në fshat nuk kishin dashur që Tahir Salillarit t'i jepeshir ato toka që iu dhanë, Nevruzi kishte thënë: «Në këto arat e Qemal Beut i kanë rënë brinjët një jetë njeriu këtij Tahirit. Tashti këtij i takojnë, se ka hequr kafshitën e gojës ky dhe e ka ndarë me ne partizanët. Ja, mua që më shihri këtu, ju e dini fare mirë që akoma bukën e këtij kam në gojë. Ku i patëm thënë Tahirit e s'pati ardhur me ne të luftonte? Ama pse s'u hodh partizan përgjithënjë? e po të gjithë...» këtu Nevruzi e kishte ulur zërin dhe pastaj kishte vazhduar: «kishte pesë fëmijë i shkreti...». Tahiri pati qërë aty pranë më këmbë e i kishte dëgjuar vetë me veshë këto fjalë.

Me të marë vesh Tahir Salillari se kryetari i ekipit ishte Nevruzi, nuk i erdhi mirë, se me të tjerët. kishte bërrë si kishte bërë, por Nevruz Ostrovicës nuk i thoshte dot «jo». Malli e kishte marrë për të, por të mos kish vajtur për kooperativër ama. Të gjitha ç'ishin thënë në fshat për kooperativën nga shokët e partisë, nga agjigatorët, i dinte, por s'i qe mbushur kurrë mëndja të jepte fjalën të hynët. siç e patën dhënë mjaft shokë të tjerë.

— Grua, si do të bëjmë? — i tha së shoqes i tronditur atë. darkë, që pati ardhur ekipi.

— Si gjithë bota, or burrë; nes'do të ndahemi nga shokët. Po hynë të gjithë edhe ne do të hyjmë. Shikojmë një herë si do bëjnë të tjerët.

Tahiri u mejtua tërë atë natë. Rrotullohej në dyshek sa më një krahë në tjetrit dhe nuk verdoste dot as në një anë. Edhe besonte se do t'ishte në kooperativë ashtu siç i thoshin, por edhe nuk besonte. Ai nuk kishte besim tek ndorjë dembel, se kujtonte që të atillët do të hanin mbi krahët e tij. Pastaj: «njëloj si e tija do t'i dhimbsej malli e gjëja e kooperativës Hysniut? Pse di dhëmbsuri kau Hysniu i Bazes? Ai është xhahil. Ka prishur tre qe gjer tanë. Po t'i bjerë Kuqali në dorë atij, ai e pëlcet në mes të arës. Prandaj s'ka bërë prokopi kurrë». Mejtonë këto e pastaj sillte ndër mënd planet që kishte për të ardhmer: shtëpitë e reja, këtë, atë... Vallë do t'i bënte të gjitha, po të hynte në kooperativë? Dëshira e tij ishte t'i thoshte sikter fukarallekut. Dëshira e tij ishte të rronte sa më mirë e më mirë, sa t'ishte vetë gjallë, dhe fëmijët t'i linte pas të lumtur. Po a do ta arrinte këtë duke qërë në kooperativë? Një mëndje i thoshte: «po», një mëndje tjetër i thoshte: «jo». Nganjëherë i dukej sikur, po të qëndronte ashtu si ish, të gjitha do t'i arrinte. Pastaj e kthente prapë: «U robëtova e u copëtova njëzet e pesë vjet me radhë dhe nuk u bëra dot me një copëz arë, gjersa më rë fund erdhi partia e na shpëtoi. Edhe tani, do mundohem kështu vetëm dhe nuk do t'i plotësoj dot të gjitha dëshirat e mijë». Po kur mejtonë si e kishte kthyer dynjallëkun aqë shpejt ato tre-katër vjet pas çlirimt, prapë i lindëte besimi se më mirë do të qe për 'të të mbetej ashtu si ish, bujk më vehte. Fjalët e shokëve të partisë, që i kishin thënë se në kooperativë bujku shpëton një herë e përgjithmonë, se ato që arrin të bëjë bujku duke qënë në kooperativë nuk është kurrë në gjëndje t'i bëjë duke qënë fill i vetëm, se në kooperativë bujku arrin lumturinë më shpejt..., të gjitha këto ja kthenin përsëri mërdjen. E më në fund, pasi e kishte kthyer mbarë e prapë çdo gjë, thoshte me vehte: «Po Kuqalir? si ta dorëzoj unë i ziu Kuqalin në kooperativë!»

Të nesërmen në mëngjëz i vajti Nevruzi në shtëpi. U puth e u përqafua me të, pastaj, si i nxori një gotë qumësht,

nisën nga bisedimi i ngritjes së kooperativës. Nevruzit ja kishin futur në vesh shokët që më përpara se Tahiri nuk donte të hynte në kooperativë. E dinte edhe se çfar arsyesh virte përpara, por me gjithatë u shtrua këmbë kryq me Tahirin dne i dëgjoi të gjitha edhe një herë nga goja e tij. Ishin shkaqe të zakonëshme, që i kishte dëgjuar kushedi sa herë edhe nga shumë fshatarë të tjerë. «S'kam krahë pune», i tha Tahiri «e që të hysh në kooperativë duhet të kesh krahë pune; vetëm ata që kanë krahë pune fitojnë rë kooperativë. Fëmijët i kam akoma të vegjël...» Pastaj i tha se në fshatin e tij nuk prodhonte toka. I nxori hallin e shtë-pive të reja që do të bënte, por këtu nuk i tregoi drejt, i tha se i kishte pajtuar, kishte dhërë edhe kaparin, dhe për të përballuar shpenzimet gjoja sikur kishte bërë llogari të shiste Kuqalin. I çfaqi më rë fund edhe dyshimet që kishte se mos në kooperativë s'do kishte rregull, disiplinë, drejtësi... Mirëpo asnje prej pengesave që nxori, nuk piu ujë përpara sqarimeve të Nevruzit. Dhe kur e pyeste Nevruzi herë pas here:

— Hë, o Tahir, ç'thua tani, nepra fjälën?

Ai përgjigjej:

— E po, ja, or vëlla, nuk më është mbushur mëndja akoma, si të të them unë i varféri?!

Sa shuanë një cigare, ndizte tjetrën. Fëmijët e ruanin në syt q'do të thoshte. Jashtë ata merrnin vesh se edhe filani u rregjistra, edhe filanit iu mbush mëndja. Te she-shi i shkollës zjente kënga e vallja. Ata nuk donin të mbeshteshin të veçuar nga fëmijët e fshatarëve të tjerë. Në vështrimet e tyre dukej sikur i luteshin të jatit:

— Hë, baba, jepe fjalér, rregjistroju.

Dhe Tahiri, tek u hidhte sytë, dukej sikur iu përgjegjej:

— Për juve mejtoj, or bir; për juve e kam hallin; nuk di si është më mirë. Kuqalin s'do ta kemi më tonin, do ta ketë kooperativa.

Po ti kolopuç, si thua? — e pyeti Nevruzi djalir e madh të Tahirit duke i fërkuar kokën, — të futet babaj në kooperativë apo jo?

Ai, sic kishte ndenjur më gjunjë pas tij, nga kërdi ku rrinte Nevruzi, e sic që pshtetur mbi të dy duart përpara,

vuri kokën pas gjoksit të Nevrüzit, duke vështruar tane me ca sy të dhimshëm e lutës, iu përgjegj:

— Si të thotë babaj, unë nuk e di. Për vehte, unë dua që të hyjmë në kooperativë.

Në t'ikur e sipër, pas katër orësh bisedim, Nevrizi i tha Tahirit:

— Kjo tregon se ti, Tahir vëllaj, ruk ke besim te koooperativa. Unë nuk e kam harruar atë historin e Nafijes tën-de që më ke treguar kur shive grurin. Edhe ti mos e harro. Si më ke thënë?! «Kush ja ka me të pa drejtë kësaj partije, do ta zërë haku i kalamajve». Shiko si po të ruajnë fëmijët në gojë. Ata presin që t'i thuash «po». Mos harro se ti e ke në dorë tani t'ardhmer e tyre.

— Më godite rëndë, o shoku Nevruz! — thirri Tahiri.

— Unë nuk ja paskam me të drejtë kësaj Partije?! Le të më thotë Partia: «shko vritu» të vete që tani ta jap jetën.

— Nuk të them se ja ke me të padrejtë, por nuk ke besim te rruga që të mëson. Partia nuk po të thotë: «shko vritu», por po të thotë: «hajde të shpëtosh, me vete e më fëmijë». Po të thotë: «hajde bëhu i lumtur....» Këto po të thotë partia. Por ti, u pa puna, nuk qerke ashtu si të pata kujtuar unë. Sidoqoftë mejtohu, mejtohu. Ne këtu jemi. Unë do të vij prapë nga ti, dhe darkën këtej nga ti do ta kem sot.

Nevrizi shkoi. Tahiri ndehti edhe një copë herë, u menjtua vetëm përpara derës së shtëpisë, pastaj u nis nga shkolla të shihte sa fshatarë ishin rregjistruar. Fjalët e Nevrüzit nuk i hiqeshin nga mëndja. Dhe shtonte me vehte: «Ç'farë ka thënë partia gjer sot edhe nuk e ka bërë?!

Mbas pesë ditësh, kur e pa se shumica e fshatarëve ishin rregjistruar në kooperativë, e si luftoi pa fryt që të mos e dorëzonte Kuqalin në kooperativë, Tahir Salillari vajti rë shkollë të rregjistrohej edhe ai. Duke vënë gishtin në fletën e rregjistrimit, po i dridheshin duart dhe psherëtiu me vehte:

— Ah, Kuqali, Kuqali, unë i varfëri!

Djemuria e fshatit iu hodhëri në qafë e pushtuan, ai vuri buzën në gaz dhe ndjeu, për të parën herë pas pesë ditësh një lehtësi në shpirt; se gjer ahore i dukej sikur

thoshin tē gjithë: «ja ky éshtë më i ligu i fshatit! Ja ky do që tē rrojë veç shokëve!» Por kur dëgjoi një gojë që tha: «Ama hyri edhe Tahiri i Salillarëve, kaqë desha unë. Me Kuqalin e tij tri ditë tē lëruar bëj rë ditët unë», dhe po fërkonte duart. Atëhere Tahiri u vrejt prapë e iu duk sikur te Kuqali i tij i kishin sytë tē gjithë. Atë shokun që tha kështu nuk e dorte, e kishte zët, se bujk i mirë nuk ishte. e bujk i mirë hiqej. I hipën xhindet në kokë dhe u mat një herë sa tē thoshte:

— U bëra pishman, nuk dua tē hyj në kooperativë, po hiqmëni nga lista.

Mirëpo, kur pa fëmijët që e kishin rrëthuar e po i përgjorin duart e trasha tërë qime e tē çara thela-thela si zhapë lisi, gjithë tē gëzuar sikur t'i thoshin: «Rrofsh o baba, na shpëtovë!», atëhere as ai vetë nuk e di se ç'e ndaloi dhe nuk e hapi gojën. Thënë për tē mos u turpruar e për tē mos u bërë gazi i botës, se ç'ishte për tē bërë qe bërë, fjalë qe dhënë.

Nj'a katër a pesë shokë e rrëmbyen n'atë çast nga dora dhe e futën në valle tek po kërcenin disa tē tjerë.

Menjëherë pas mbarimit të regjistrimit, u bë inaugurimi i kooperativës dhe komisioni i vlerësimit filloj nga mbledhja e pendëve. Tahiri ruk donte tē vinte vetë ta merrte Kuqalin në katua. Në fund vajtën dy shokë, dhe e prunë te sheshi i shkollës. Me tē parë Kuqalin, Tahirit iu mbushën sytë me lotë dhe sikur iu çkëput një pjesë e mëlcisë.

— Si thua, o Tahir, — e pyesni: shokët e komisionit, — a je i kënaqur për kaqë mijë lekë?

— Për mua tërë fshatin tē më falnit nuk e jepja Kuqalin. Ju sa tē doni çmojeni, — dhe dridhej i tërë ky Tahir sikur ta kishin zënë shtatë palë ethe.

Atë darkë Tahiri ruk vajti në shtëpi tē flinte, por shkoi e fjeti në arë, gjoja për tē ruajtur grurin nga kaprodhet. Por në tē vërtetë nuk vajti sepse i dukej shtëpia akull pë Kuqalin në katua.

Vazhdoi kaqë kohë që, sa herë e shihte Kuqalin, vinte i shkontë dorën mbi kurriz, e puthte dhe nuk i mbante dot lotët. Nuk kishte nafë tē mos shkontë në shtallën e qe-

ve që të shihte a kishte Kuqali bar në grazhd për të ngrënë. Kur vinte rga puna, mblidhët nga një krahë bar të njomë e ja hidhte, veç atij që i kishte hedhur kujdestari i qeve të kooperativës. Çdo mëngjëz ngrihej herët dhe vinte shikonte Kuqalin mos i qe rgyjethur qimja. E kur qëllonte ndonjë mëngjes që Kuqali nuk kishte bërë bark, grrindej me shtalljerin.

Kjo është tërë historia se përse Tahir Salillarit ja vu-në llagapin kooperativistët e kooperativës «Partizani» Tahir Kuqali e përse nuk e kishte harruar Nevruz Ostrovica Kuqalin e Tahirit.

Kur vajti Tahiri të takohej me Nevruz Ostrovicën atë mbrëmje që i thiri Myftar Dushku, Nevruzi e priti me kra-hë hapur dhe, që pa u afruar, i tha:

— Po hajde, ore Tahiri i Kuqalit, se na ka marrë mlli, kemi katër-pesë vjet pa u takuar.

E si u puthën buzë për buzë, Nevruzi e pyeti Tahirin pa u ulur akoma mirë:

— E, o Tahir, a të vjen më keq për Kuqalin, a qan më për të?

Tahiri qeshi me gjithë shpirt e iu përgjegj:

— Tashti, o shoku Nevruz, më vjers keq për tetëdhjet e ca kuqalët që kam në shtallë. Për ata do të qanja tan, po të m'i gjente gjësendi. Pa sa për Kuqalin tim, atë ja ku e kam. — Dhe ja bëri me dorë duke i treguar një palë shtëpi të reja me perikota flakë të kuqe, me dy kate.

— Ka bërë shtëpi të reja sivjet brigadieri ynë i pëndëve, shoku Nevruz, — i tha kryetari i kooperativës Nevruzit, kur pa se nuk po e kuptonte ç'donte t'i thoshte Tahiri me ato fjalë, — prardaj uroje Tahirin.

— Aha, qënka me të vërtetë për të uruar, — tha Nevruzi dhe i hodhi Tahirit dorën në qafë duke vështruar rga shtëpitë e tij të reja.

— Atje në shtëpi urohet më mirë, se pa e lagur nuk zë urimi, — iu përgjegj Tahir Salillari i gëzuar.

Si këmbyen nga një cigar, filluan të bisedonin e të kujtorin ato ditë, kur u ngrit kooperativa «Partizani» para pesë vjetësh. Kujtuan se si kundërshtonte njeri, e pengesat që nxirte tjetri, ...pastaj Myftari e Tahiri i treguan Nevruzit se si kishte shkuar përpala kooperativa gjatë atyre pesë vjetëve, se si shumë familje kishin bërë shtëpi të reja, si jetonin tani fshatarët shumë më mirë se më parë...

— Vetëm një gjë ruk kuptoj unë, — iu tha Nevruzi.

— Kam marë pjesë në ngritjen e mjaft kooperativave, si këtu tek ju edhe gjetkë. Kudo, mjaft fshatarë, kanë nxjerrë pengesa e nuk kanë dashur në fillim që të futeshin në kooperativë. Megjithatë, e vërtetë është kjo se kudo, pas katër pesë ditësh purë — veç punës që ka qënë bërë më përpala — është ngritur kooperativa me nëntëdhjetë e pësë përqind të fshatarëve e nga një herë kanë hyrë edhe i gjithë fshati. Këtë nuk e kuptoj dot unë.

Tahiri shikoi Myftarin në syfë si për t'i marë lejë që po i delte përpala dhe tha:

— Ti, i ditur je, o shoku Nevruz, se të bëri partia të tillë, por ja ku të them unë: Ne fshatarët kemi një dëshirë. Dëshira jonë është: të flakim fukarallëkun. Edhe partia këtë kërkon për neve. Dhe ne e kuptojmë këtë dëshirë të partisë. Mirëpo, në fillim, ne prapulizemi në mes të lidhjes që kemi me mallin e me gjënë torë e të frikës që kemi se ço valla shkojmë dot mirë, po të hyjmë në kooperativë, dhe në mes të besimit që kemi te rruga që na mëson partia. Më në fund, është e vërtetë ajo që thua edhe t'i se të gjithë hyjmë në kooperativë, megjithëse bëjmë nazë. Ja, kështu jemi ne fshatarët. Këto do të ra gjesh në zemër, po të na hapësh zemrën e të na e shikosh. Pse futemi? do të thuash ti. Futemi sepse besimi ynë te partia është më i madh se sa lidhja që kemi me mallin e gjënë tonë e më i madh se dyshimet tona. Pastaj, duhet të dish edhe një gjë t'i shoku Nevruz: Ne fshatarëve na është mbushur mëndja top. se çfar ka thërë pa tia gjer sot e nuk e ka bërë?»

«*VEIËM, MOS QOFTË AS GJARPËRI NDËN GURT*»

Kishte edhe dy hostene diell pa të ngrysej. Në perëndim kuqte orizonti sikur të qe ndezur flakë. Tërë malin Tomorrit, gjysëm i veshur me pyll e gjysëm gur e shkëmb, me fshatrat rrëzë tij, kishte marrë një rgjyrë të kuqe të lehtë si e kuqja e ylberit e dukej sikur nuk qe parë kurrë ndonjë herë aqë i madh e aqë i bukur. Era e jeshilit të majit, e luleve, freskija e mbrëmjes në këta çaste, të ngjallte shpirtin, të bënte të harroje çdo gjë e t'ia thosje këngës.

Në këtë kohë një skuadër e pëndarëve të kooperativës «23 shtatori» të rrethit Beratit, një rga kooperativat n'ato fshatrat në këmbët e Tomorit, kishte lënë punën dhe po ngjitej për në fshat. Qetë i patën vënë përpëra dhe vetë vinnin pas duke kënduar. Qamili ia thoshte, Sala ja mbarante, dhe të tjerët, kush dëgjonte, kush mundohej të bënte iso.

— Merja asaj, o Qamil, i tha Sala kur pati mbaruar këngën e parë.

— Cilës asaj?

— E po ti e di cila më pëlqen mua.

— Ehë, m'u kujtua; po dale ore të shkretën se na lodhi kjo e përpjeta, na u zu fryma.

— Hë, hë, merrja o xhart.

Dhe Qamili, ja hodhi ashtu tel më tel:

*Posi gojë e dallëndyshes,
Kur këndon, të luftonte gjuha;
Nga të bëri nënia fare,
Të bëri texheli për mua.*

— Kësaj t'ja marrim mëdysh, — tha Qamili kur pati

kënduar strofën e parë. — T'ja thotë Bektashi, se ja merr mirë edhe ai, e t'ja mbajë Mersini.

Bektashi nuk deshi.

— Jo, jo. pér perëndi s'ja marr dot, më është ngjirur zëri.

— E po ti ç'ke që rri kështu sikur të ka rrgrënë gomari bukën, — i tha Estrefi dhe i hodhi dorën në qafë. — Kishje hallin e misrit, ja edhe misrin e mbolle, ç'ke tanë?

— Mejtohet se i hëngrem bukën shumë sot, edhe keci i iku, edhe byreku... prandaj rri ashtu, — bëri shaka një tjetër aty përpara tyre.

Dhe kënga gjëmoi përsëri. Bektashi ra prapë në mejtime duke iu rgjitur asaj të përpjete, pa u vënë re shumë nga shokët.

Me të arritur në fshat, shtallieri i kooperativës dolli mori qetë. Bektash Kula u përshëndosh me të dhjetë shokët e skuadrës duke i falënderuar:

— Ua paça hua! U lumçin krahët!

Pastaj i ra gomarit, ku pati ngarkuar parmëndat, u foli qeve dhe u nis pér në shtëpi.

Dita ngadalë-ngadalë po errej.

* * *

Me të aritur në shtëpi, si mbylli qetë e gomarir, Bektash Kula vajti vuri shpatullat murit në konakun ku gatuani.

— Erdhe, t'u bëftë nëna? — e pyeti Xhiko Salushja. e ëma.

— Erdha.

— U lodhe u këpüte, ta marrtë nëna.

Bektashi nuk iu përgjegj, po iu drejtua së shoqes, Nadires.

— Bjemë një ujë të ftohtë, se plasa.

— Dale, bir, se je i nxehëtë, e të prish. — foli e ëma me një zë plot dhëmshuri e duke mos ja hequr sytë. Pastaj tha me vehte: — E mjera unë, sa më është hequr djali, i ra mishtë, një krah i vetëm!

Si piu ujë atëhere vuri rë Bektashi që e shioqja dhe e

ëma nuk e kishin qeverisur shtëpinë akoma: Saçi nuk qe shpurë në vend, poncat ishin akoma në mes të vatrës: Nadirja po vazhdorte të lante enët në fund të shtëpisë dhe Xhiko Salushja po tundëte djalin, që sapo e kishin lidhur në djepe.

Ndezi një cigare, i nguli sytë në vatër e po mendohej i futur në të thella. Nga që qe bërë për të rrojtur e ca nga që e kishte nxirë dielli, i dukej Xhiko Salushes më i dobët se sa qe, e mendoi: «E, or bir, e! Të këputi pun'e shkretë! I vetmi s'ka nge të pijë ujë e jo të çlodhet!» Edhe po vriste mëndjen përsë rrinte aqë i menduar i biri: «Ta ketë nga lodhja?» pyeste me vehte, pastaj përgjigjet po vetë: «Jo» «E po atëherë ç'më ka djali?» Nëna, edhe kur fle evlati, bëhet merak dhe vete e përgjon a merr frymë, e jo pastaj po ta shohë të mërzitur. Ta pyeste? druanse se mos e mërziste më shumë. Deshi t'i hapte ndonjë fjalë që t'ja hiqte mërzirë. prandaj si duke folur me vehte, tha:

— I shpëtuam edhe këto të mbjellat...

Bektashi ngriti sytë e vështroi e për një çast i qeshi fytyra.

— I shpëtuam edhe i shpëtuam mirë. Me këtë vlag mbin misri dhe bëhet për shatë.

— Gjer atëhere, do zoti bije edhe ndonjë shi, ju heq edhe një shatë. — shtoi e ëma. — dhe pastaj e ke bereqetin në hambart.

— Ashtu është. Po ta zerë një shi rë shatët...

Bektashi nuk e mbaroi fjalën, po lëvizja që bëri me dorë donte të thoshte se do t'ishte shumë mirë. Pastaj ra prap në mejtime dhe e ëma duke tundur djalin nuk po ja ndante sytë. Kishte afro dy vjet që e shikonte djalin dërdur kështu me një mërzi të tillë dhe e mori me mend se përsë rrinte ashtu edhe sot. Psherëtiti thellë dhe tha me vehte:

— Eh, or bir, e!

Balbardha kishte afro dy vjet që qe bërë kooperativë. E shumta e fshatit, pas shumë pune, u futën që ato ditë që u ngrit. Seç mbeten atëhere rj'a dhjetë shtëpi jash-

të, edhe rga ato, nj'a katër a pesë u futën më vonë. Kishin mbetur tani jashtë vetëm Bektash Kula, dy të kushérinjtë dhe një tjetër. Pa u ngritur kooperativa, edhe ca kohë pasi u ngrit, në Balbardhë fllisnin bota plot fjalë: «Në kooperativë vdes për bukë». «Kush ka krahë pune rron në kooperativë, po kush s'ka vdes». «Do hanë njerëzia bukë me gavetë. Ja, si ushtarë». «Nuk e ke vehten në dorë. Nuk sheh as mik, as shok, as pazar me sy». «Fshati në kooperativë është si ajo shtëpia me dy mbëdhjetë pleq e trembëdhjetë çibukë, seicili puron pas kokës së tij». «Çdo gjë është e togut, po gjenë e togut s'e hanë as qentë». «Do hanë dembelët në krahët e atyre që punojnë...». Dhe ato ditë që kishin vajtur ekipi për ngritjen e kooperativës në Balbardhë, Qerimi, xhaxhaj i Bektashit, kishte vajtur tek i nipi e i kishte thënë, siç e ka ai duke hapur gojën sa një kamare e tërë jargë e shkumbë: «Gjer këtë radhë e patëm! U prishëm, u prishëm me bina».

— Si të bëjmë, moj rënë? — E kishte pyetur Bektashi Xhiko Salushen atëhere gjithë i mërzitur nga që s'dinte nga t'ja mbante.

Dhe Xhiko Salushja i qe përgjegjur:

— Si të them, or bir?! bëj si të bëjnë shokët, shko me të shumtit. Ku të venë ata, edhe ti. Në lumët, në lumët. Me gjithë dyrjanë, se vetëm nuk rrohet, pa vllerëzi, pa shokë, pa miq. Vetëm, as gjarpëri ndër gurt mos qoftë.

Po që t'i thoshte copë «hyrë» ose «mos hyrë», këtë nuk ia tha se i qe bërë mëndja dhallë edhe asaj të shkrete. Dëgjonte shokët e partisë, ata që kishin ardhur nga rrëthi e nga Tirana për ngritjen e kooperativës e gjithë të tjerët në fshat, që e donir kooperativën, e ata thoshin se kooperativa ishte rruga e shpëtimit. Dëgjonte të tjerët, ata ja çthurnin mendjen, ja bënин çorape.

Xhiko Salushja vetëm hallin e Bektashit kishte, pa ajo për vehten e saj sot për nesër qe, sa kish rrojtur vjetë ruk do rronte ditë. Edhe një merak tjetër i kishte ajo Bektashit: Ai kishte një zakon shumë të lik. Kur kërkonte në fshat i vinte mirë, por kur i thoshin atij: «Na jep një ditë qetë për të lëruar», ose «pelën për të mbajtur pak plehë», nuk i jepte. Këtë tabjat Xhiko Salushja nuk ja

pëlqente hiç. Ajo i pati rritur jetim atë djalë e tri çupat. Në saje t'atij fshati i rriti ata fëmijë e qëndroi me rder në derë të burrit. Pa i vëllai i burrit e të kushërinjtë e burrit nuk e ndihmonin sikur kaqëz. Ata kishin hall si e si t'i hanin mallin. Prandaj i pati folur gjithnjë të birt. Por ai, më një e më dy, e i përgjegjej:

— Mezi i kam vërë, moj néné. Tek ata qe e tek ajo pelë i kemi sytë.

— Po pse, atyre që u kërkon ti, nuk u dhëmset malli a? në rrugë e kanë gjetur ata? Malli është i dhëmshur njëlloj me shpirtin, or bir, për të gjithë; po njeriu t'i verë një çikëz gjishtin kokës, se me atë fshat rron. Vetëm të ha ujku, or biiir!

Kështu e këshillonte ajo Bektashin gjithmorë. E kushedi sa herë, pa pyetur të birin fare, qe ngritur, pat hapur derën e katojt e i pat dhënë atij fshatarit qetë apo pelën që kërkonte.

Tani që do të bëhej kooperativë Xhiko Salushja ja kishte frikën akoma më shumë të birt, sepse ca e kishte huq ai vetë, ca fshati, duke u bërë kooperativë, do të shikonin hallir e tyre, e Bektashi do të mbetej vetëm si dhija në mes të dhënve.

— «Mos hyrë» s'i thashë atëhere, — mejtoi me vehtë Xhiko Salushja, kur ishte duke tundur djalin, po prapë edhe atë akshëm po e brente marazi: — Përse nuk iu vura unë pikërëna djalit që atëherë që të hyrte me shokët edhe ai në kooperativë?!

Bektashi, sa shuante një cigare ndizte tjetrëri. Edhe ai po këto gjëra mendonte: Kur u ngrit kooperativa në Balbardhë, ai kujtonte se rë kooperativë nuk do të kishte rregull. Nga do ja mbante njëri nuk do t'ja mbante tjetri. Janë dy vëllezër të një barku në një shtëpi e nuk iu puq taçelja e jo t'i puqj taçelja një fshati të tërë. Malli do t'i shkonte jakëm për dhjamë qerri.

E me të vërtetë, ata muajt e parë, në kooperativë pati ca gjëra që s'i pëlqenin: Që të nesërmen që u inauguruat kooperativa, disa vajtën në ara e prenë lisat, gjoja se u duheshin për zjarr, se qe dimër. Bektashi pati thënë atë-

here me vehte: «Ja si bëhet tari! E kujt i dhëmb malli!» Dhe kur pa Tajarin e Canellarëve tek i kishte vënë sopatën një lisi të madh, i kishte thënë: «Mos e pre, mos, se gjynah. Të thyhet një tra nesër pasnesër, ku do ta gjesh? Pa vdes një njeri, se të gjallë jemi, e s'do gjërdet një lis t'i bëjme straricat!», Po Tajari, buzëvarur, as që i qe përgjigjur. Me atë heshtje kishte dashur t'i thosh: «Ikë mos më çaj kokën edhe ti aty!». Prandaj Bektashi pat mbajtur rrugën dhe e pati këthyer kokën katër a pesë herë duke e parë me dhëmbje atë lis të madh që po shkonte dëm.

Mirpo pastaj shpejt e shpejt kooperativa vuri rregull. Në punë po delnin të gjithë. Ndonjë tek tuk, ndofta nuk shkonte akoma më krahë të ngrohtë, nuk i kishte dalë akoma frika, po sidoqoftë puna po bëhësh. Që atë dimër, me gjithëse kooperativa u ngrit nga mezi i janarit, ata hapën airo dyzet dyrymë tokë të re. Kurrë s'mbahej mënd ndonjë mot të qenë hapur në Balbardhë më shumë se shtatëtetë dynymë. Mbuallën pemë e pjergulla sa të duash. E, si të thuash, rga të gjitha ato që u folën asnë nuk dolli. Kur u ndanë prodhimet në vjeshtë, motir e parë, të gjithë muarën bereqet, para. Kështu që, siç llogariste Bektashi, më përpara në Balbardhë, afro njëzet shtëpi nuk e bënin bukën e motit, kurse atë vit, ja ishin pesë a gjashtë shtëpi që ruk u delte buka, ja nuk ishin.

Duke mejtuar të gjitha këto, Bektash Kula, atje mes shpatullat pas murit në konakun ku gatuanin, tha me vehte: «Kujtonja atëhere se ata të kooperativës do të vdisnin e unë do të rronja, po s'qënka kështu» dhe psherëtiti, sepse iu kujtua pela që pati shitur para tre katër muajsh, menjëse misrit të tij i pati hyrë krimbi rë kërcell, dhe, le që nuk u rrit kashta, por edhe mori erë e nuk e kllisnin qetë fare zahirën në gojë. Nga kjo nuk i ushqeu edhe qetë mirë e nuk do të kishte arritur ta mblidhëtë misrin sivjet me kohë, po të mos e kishte ndihur kooperativa atë ditë me dhjetë pëndë.

Nebiu, kryetari i kooperativës, një ditë më parë e kishte thirrur në kryesi. Kur e lajmëruan, Bektashi kishët kujtar se mos e thërriste për t'i marë arat, sepse çokush i kishte thënë që kooperativa do t'i fuste në bllokun e saj

nj'a dy nga arat e tij dhe do t'i jepte ca copërrina andej nga Qeshtet, kurkurina, që as okërin ruk e bëjnë.

Me të hyrë në kryesi, — dy vjet të tëra, kjo ishte e treta herë që hyrte n'atë dhomë, — Nebiu e priti si gjithmonë buzëgas dhe bëri shaka me të, siç bënte sa herë që e takonte në rrugë apo kudo: «E Bektash; ja ti, ja unë këtu në fshat, se dy atllarë rë një grazhd nuk rrinë», mbasi, për shaka, ja kishte vënë emrin Bektashit «Kryetar i individëve». Si i dha edhe një cingar, pastaj e lajmëroi që kryesia kishte marrë vendim ta ndihmonte në mbjelljen e misrit, mbasi të sajat kooperativa i kishte mbaruar, koha po shkonte, për dy-tri ditë ishte frikë se mos i delte vlagatokës, dhe para se t'i rgjisnin qetë në malt, ata i kishin dhënë vendim t'i mbillnin edhe atij misrin. Bektashi u gëzua aq sa dhe u çudit, po deshi të mos e bëjë vehten, me gjithatë, gëzimi që ndjeu i dukej qartë në fytyrë.

Që andej vajti në shtëpi, u tha s'ëmës e së shoqes përkëtë, i porositi të përgatisnin bukë për pesëmbëdhjetë, gjashtëmbëdhjetë veta, shkoi mori edhe rjë kec që më darë; dhe atë natë, megjithëse qe i lodhur si çdo ditë, e zuri gjumi vonë.

C'mendoi atë natë, ato e munduan gjatë ditës duke lëruar e po ato mendime po i zienin në kokë edhe tanë. E ëma kishte pasur të drejtë kur e pati këshilluar: «Bir, vetëm mos qoftë as gjarpëri rdën gurt!» Sa e madhe ishte kjo fjalë, ai këtë e kishte kuptuar që atë ditë që ishin bërrë zgjedhjet për kryesinë e kooperativës. At ditë, në çastin që do të fillonin votimet, ata të presidiumit kishin thënë: «Ju lutemi atyre që s'janë rregjistruar, të rrinë pak më nj'anë, po më mirë t'i paske rënë pika atë minutë, n'atë vend ku ishte, se sa të largohej ashtu. I kishte rënë koka përdhe dhe, pse kënduan më vonë, pse kërcyen, pse pirë... ai as pa as dëgjoi; tym iu bë përpara syve dhe nxinte e sterronte. Më vonë, kur merte qetë e shkonte ndarë, apo shkonte fill i vetëm me shatën rë krahë, ose me draprin në dorë, i dukej sikur ja bën «aha»! të gjithë; edhe gure e drurë i bëhej sikur e qeshnin. E pati thënë që atëhere:

«Shtarë le të bëhet edhe ajo bukë, në dreq të venë edhe ata qe, pela, ato pesë dhënë!» Mirépo prap s'kërkoi të futej në kooperativë. Këtu ja bërte gjyqin vehtes: Në fillim pati menduar: «Nuk vete të falem unë, se do thonë: «E sheh, më në fund, po me ne erdhi, po me ne». Dhe pati Gashur që të vinte, si të thuash, nga ata të kooperativës futja e tij në kooperativë. Mirpo pastaj fajin e kishir pasur ata të kooperativës. Jo të gjithë, po si të thuash ndonjë nga ata që s'e kishte pasur me gjithë zemër edhe vetë të hynte rë kooperativë, po kishte hyrë se ja kishte mbledhur djali, apo çupa: «O të hyjmë në kooperativë o unë ikinj nga shtepija». E këta tipa kushedi, shpresonin mos e mos prishej kooperativa, prandaj u fusnin edhe spica njerëzve. Një nga këta që e kishte zemëruar keqas Bektashin kishte qenë Raufi. Ai pati parë një ditë lopën e Bektashit, që pat hyrë në një zarar e duke e pritur, lopa s'dorte të delte nga grurët, e ai kish thënë për Bektashin: «Tëmën e s'ëmës! Le vetë që është i lig, po edhe lopën e ka të ligë!» Nj'a gjashtë qind metro kopsht, që i pati hapur atë dimër që u bë kooperativa, ja kishin marrë, duke vënë si shkak se përzjehëshin me arat e kooperativës e pse nuk i kishte rregjistruar në kadastër. Edhe kjo e kishte zemëruar mjaft Bektash Kulën. Pastaj, kur kishin vajtur për ta uruar për djalin e tretë që i pati lindur, disa kishin thënë: «Pse vini te Bektashi. Me atë as mos hyni, as mos delni. Po të donte të rronte me fshat, ai hynte në kooperativë». Këto gjëra qerë bërë shkak që e kishin ftohur Bektashin me një pjesë shokësh, e tani luftonte me vetvehten. Inati që kish marrë më ta nuk e linte, po edhe përzëmërsija që tregon: shumica e anëtarëve e bënte që të mejtonte e t'i thoshte vehtes: «Bektash, mos bëj budallallëk! Flaki ato llafet si të grave të këqija, shkele të ligën me këmbë dhe përzihu me shokët». Pastaj, ai nuk pat besuar kurrë që t'i vinte t'i ndihte edhe Xhezua, që pat thënë: «Edhe sikur të më zjesh në një kazan me Bektashir, mua nuk më përzjehet uji me 'të e jo gjaku!» sepse ashtu i kish shkarë goja Bektashit dhe e kish sharë kur ishte çështja e atyre gjashtëqind metrove katrore kopsht. Mirpo, ja që në skuadrën që e ndihmoi për të mbjet

llë misrin ishte edhe Xhezua. Ai i pati vënë veshin pér hilese si punoi Xhezua atë ditë në arën e tij dhe pa se si i mshonte parmendës që të hyrte thellë. Pa kur delte ndonjë gur apo ndonjë rrënë, Xhezua nuk e linte, po ulei, e merte dhe e hidhte në fund të arës. Kur mbetej ndonjë plis, e thyente me këmbë. Vetëm në arën e tij punon njëriu kështu.

Aqë sa u gëzua Bektashi që i mbylli të mbjellat me kohë, «se s'i thonë shaka ore», mejtonte ai, «po i thonë bukë kësaj, bukë e çiliminje», po aqë të madhe e ndjente edhe një tengë në lugthit të zemrës tërë atë ditë e atë darkë në shtëpi. Këtë radhë, veçanërisht, shokët e kooperativës e kishin vrarë, si të thuash, me pambuk. «Vetëm ore», mejtonte, «vetëm qënke si balash», e kujtonte fjalëri e s'ëmës: «Biiir, as gjarpëri...» Pastaj edhe ç'kishin thënë pér kooperativën ata që s'donin e ç'kishite mejuar ai vetë, të gjitha ato nuk kishin dalë asnjëra, po kishin dalë ç'ishte thënë e mirë pér kooperativën. Dy vjet të tëra, kur vinte në mbledhjet e fshatit e ndjente vehten si kollovar në fshat. E jo vetëm në mbledhje, por edhe kur piqesh me pesë-gjashtë shokë, ata bisedonin jo kështu skuadra jonë, po kështu brigada, kurse ai ç'të thoshte e ç'të bisedonte! Edhe kur vinte pér ndonjë urim e pér ndonjë ditë të kremte ndër shokët, Bektashi e ndjente vehten si të huaj, se të tjera bisedonir njerëzit e shtëpisë, e ky nga ato qe larg. Prandaj rrinte një çikëz e ngrivej ikte si i lënduar. I shkoi të gjitha këto nëpër mënt e s'dinte nga t'ja mbante edhe këtë mbrëmje. Nuk verdoste dot, të bënte apo të mos bënte lutje pér t'u futur në kooperativë.

— Hajde hamë pak bukë shpejt e shpejt, — i tha më në fund s'ëmës dhe së shoqes, — se do shkoj të kullos që të jashtë që të çlodhen mirë këtë natë, e nesër t'i ngjis në malt, se janë bërë sa tunder udhëve.

— Po hidhu gjësendi sot, — iu lut eëma si me gjysëm zëmre, se hëm i vinte keq pér të birin, hem mendonte përgatë, — leri nesër të kullosin nga Shëmitrat, iu mbledh edhe nusja rjë dorë bar, djalin e gënjej unë një copë he-

rë, dhe pasnesër ngjiti në malt. Çlodhu edhe vetë një ditë.

— Ah, moj nënë, — psherëtiti Bektashi e ja bëri me dorë, — ç'më thuaj çlodhu! I vetmi s'ka nge të vdesë, e jo të çlodhet! Ajo copë që kemi mbjellë atje nga Xhyvellet u bë pér shatë.

— Po ti mos u mërzit, — iu lut Xhiko Salushja. Dhe këtë ja tha si me qëllim, që ta kuptonte më mirë: nga purët që e kishin marrë nëpër këmbë e nga lodhja rrinte ash-tu, apo nga ç'mendonte ajo. E u sigurua se i biri qe mërzitur nga që e vriste ndërgjegja pse qe ndarë nga shokët, kur Bektashi gjithë duke psherëtitur iu përgjegj:

— Ah, moj nënë, ta dish ti ku e kam hallin unë! Më pate thërë sa herë, po kjo kokë s'të ka dëgjuar!

Xhiko Salushja i kuptoi tani të gjitha.

— Po shko, o bir, dhe thuaji Nebiut.... — iu lut ajo pa e mbaruar fjalën.

* * *

Xhiko Salushja priti të nesërmen se mos i thosh Bektashi: «bisedova me kryetarin dhe...» Priti edhe të pasne-sërmen, por ai rrinte gjithnjë i mejtar dhe psherëtinte. Të tretën e ditës mori shkopirë e vajti vetë te Nebiu, në kryesi të kooperativës, që në mëngjes.

— Nebi, or bir, i paç thënë atij kokë derrit tim: «Biiiir, vetëm mos qoftë as gjarpëri ndën gurt!» po s'më dëgjoi. Tani iu mbush koka edhe atij, po...

Kryetari i kooperativës u ngrit e pushtoi:

— Ashtu, de, ashtu! Shumë e zgjatët!

Në mbrëmje duke ndenjur në qoshkur përpara shtë-pisë, Xhiko Salushja, nusja, Bektashi, dy djemt e mëdhenj të Bektashit, — njeri tetë vjeç dhe tjetri shtatë, — du-keshin sikur u qeshnin edhe rrobat që kishin veshur.

Xhiko Salushja, duke vështruar Bektashin, që dukej si i mejtar, po që shquarte që atje tej sikur qe lehtësuar nga një të rëndë që i pati ndenjur si plumb në barkut e i

përgëzonte fëmijët siç s'é kishte parë për afro dy vjet më radhë, tha me vehte:

— Tani edhe të vdes, shkonj e tëra. Nuk bëra keq që vajta vetë te Nebiu.

Dhe pastaj urdhëroi të renë:

— Nuse, ngreu ra zërë një zok, there shpejt e shpejt, ripe e bënaj me thërim, se shpejt është, bëhet ai sa të vi-jë koha e darkës.

Të dyja, re e vjerrë, u ngritën hynë brënda.

Në perëndim kuqte përséri qielli si katër pesë ditë më parë, sikur të qe ndezur flakë. Fytyra ngjyrë bakëri e Bektashit shkëlqente në drithë e kuqërrreme t'asaj mbrëmjeje pranverore. Siç rrinte këmbë kryq, e hodhi këmba mbi këmbë, e duke u fërkuar kokat të dy djemve, që i qenë ulur pranë, ja tha këngës me zë të ulët:

*Porsi gojë e dallëndyshes,
Kur këndon, të luftonte gjuha.*

Djemtë të dy, duke qeshur sikur të dirin që s'ishin të zotët për atë punë, por për t'i bërë qejfin të jatit, po mbabin iso: eeeeeeee.....

KOHËT NDRYSHUAN

Këtu e tridhjetë e ca vjet më parë në Hajdaraj ka ndodhur një ngjarje që edhe sot e tregojnë. Çuni i Demirit, Shefiti, pati hedhur dashuri në çupër e Rizajt, Shegën, dhe duheshin si ata të dy e jo kush tjeter. Që të dy i kishin dhënë besën shoshoqit se as vdekja nuk do t'i ndante e kurrë nuk do ta tradhëtonin rjeri tjetrin. Mirëpo as Rizaj donte t'ja jepte çupën Shefitit, as Demiri nuk donte që i biri ta merrete për nuse «atë që bënte dashuri». Panë ç'panë, më në fund Shefiti e bëri me fjalë me Shegën që ta rrëmbente e të hapnin krahët e të iknin më ndonjë anë, të punronin të dy e të rronin. Rizajti ra era që e bija donte të rrëmbehej, prandaj e mylli brënda e nuk e linte të kapërcente as pragun e derës. Nga ana tjeter e fejoi shpejt e shpejt dhe e martoi me fshehuri: natën erdhën kruhqët e muarrën dhe natëri ikën, sepse kishte frikë Rizaj mos delte Shefiti përpara e i bëhej ndonjë rrëng. Ç'ta zgjasim, jetë të zezë kaloi Shega atje ku vajti, jetë të zezë kaloi edhe Shefiti me atë që i dha i jati. N'atë kohë fshati u ngriti këngë hëm Shegës, hëm Shefitit:

*Ti, o babaj im,
Qofsh o i mallkuar
Që s'më dhe një burrë
Për t'u trashëguar.*

dhe

*Ti, o babaj im,
Qofsh o i mallkuar
Që s'më dhe një grua
Për t'u trashëguar.*

Dhe Destan Xhufka, kur ishin hapur këto fjalë né fshat, kishte thënë mu né mes të fshatit pér çupëri e Rizajt: «Po ta kishja unë çupë Shegën, nuk do ta lija të gjallë, po do t'ja prisja kokën me sopatë mu né prag të deres.»

— Mos, or Destan, or bir, — i qe përgjegjur një plak nga Hajdaraji, kur e kishte dëgjuar, — mos thuaj ashtu, se evlati éشتë i dhëmbsur njëlloj me shpirtin. Nuk ka faj Rizaj i shkretë, po a e di ç'thuaj? mos të mbiftë rë derët, mos të pjelltë me evlat të lik, se po të polli, të turpëron e nuk ke se ç'i bën.

— Po, po, — ja pati këthyer Destani, duke tundur kokën, — unë nuk kam çupa, po sikur të pjell e kur të rriten, le të bëjnë dashuriçka, le të bëjnë, po kjo babaxhane i pret! — dhe kishte rgritur sopatën lart.

— Do të shohim, do të shohim, kishte thënë plaku e pati qeshur nënë buzë.

Ca nga fshatarët e Hajdarajit që patën qëlluar atje n'atë mbledhje, kishin mbajtur anën e plakut, e ca të tjerë anën e Destan Xhufkës.

* * *

Karë kaluar triçnjetë e kusur vjetë që atëhere, d¹e aty njëditzaj marr vesh që çupa e Destanit, ajo e mesmja, Manushaqja, ishte martuar me dashuri me Meçan Çermën, të birin e Ramazanit. Se si e kishin filluar dashurinë e si qenë martuar, më fjalosën vetë Meçani me Marushaqen, që i pata né shtëpi pér darkë.

Meçani me Manushaqen na qenkeshin dashur që né vegjeli. Si Shefiti me Shegën ashtu e paskëshirënisur edhe ata të dy. Në fillim, kur ishin të vegjël e kur losnin bukagjella, Meçani bëhej dhëndërri e Manushaqia gjithnjë bëhej nusja. Kur losnin symbyllurazi, fshihëshin të dy ardej nga vreshtat. Hë, hë, ata rritu dhe dashurija rritu, erdhë një ditë e një kohë që të dashurohëshin me gjithë mënd. Manushaqes tanë sikur i vinte turp, por edhe pér të rdejtur nuk i rrihej pa e parë Meçanin makari një herë né di-

tët. Po edhe Meçani në mos ishte bërë veri nga koka përkëtë Manushaqer! Një e dy e shkonte te kooperativa e shitblerjes. Atje përkarshi kooperativës e kishte shtëpinë edhe Destani. Gjithë ditën me Manushaqen ishte, në një skuadër; po ja që edhe në darkë nuk i rrihej, pa mbinte e shkrinente te kooperativa. Mirëpo, rjë herë, dy herë, më në fund hapet fjala, se ti më thua mua, unë i them Qemalit, Qemali Nuriut dhe kështu na e merr vesh fshati dhe zënë e pëshpërisin: «Meçani me Manushaqen duhen me njeri tjetrin». Gojë pas goje, na i kish vajtur në vesh kjo fjalë edhe Destarit. Kur e kish dëgjuar ditën e parë, Destani nuk e kish bërë qejfin qeder fare. «Mirë», qënke përgjigjur, «çupa do martohet me Meçanin, nuk do të martohem unë. Ajo të hapi sytë mirë, ta zgjedhi burrin, se nesër pasnesër, i del keq, s'shkon me 'të, i nxihetjeta, pa i duhet që të ndahet; e rë i daltë kështu, nuk i ka faj njeri, pastaj. Prandaj ajo t'i hapi sytë katër. Po qe se i pëlqen, po qe se e sheh se do të shkojë jetë të lumtur me të, unë i them: «Mu trashëgofsh, moj bijë, paç uratën, me këmbë të mbarë».

T'ju them të drejtë, kur mora vesh që Destani qe përgjegjur në këtë mënyrë, u hodha drejt përpjetë. Po gjene nuk është përtu çuditur. Destani, pak i kaluar nga mosha vërtet, po është burrë i zgjuar, ka pasë bërë kaqë kohë në çetë partizare në këtë luftë, ka qënë kryetar fronti në fillim. Tashti është anëtar i kryesisë së Kooperativës, në këshillin popullor të lokalitetit...

Fshati zjente nga fjalët e Meçanit e të Manushaqes, po këta të dy shikonin punën e as kishin pyetur përgojët e këqija rë fshat, që delnin te çezma, si Fajreja e Xhungallarëve, dhe cirrnin faqet. «Upupu c'po bëhet moj të zezanni, upupu c'po bëhet! Manushaqe-zeza i nxiu faqen shtëpisë, turpëroi kooperativën, moj, që u nxiftë me bojë, u nxiftë!» Dhe as që ua kishte zgjatur njeri këtyre gojë çorapeve.

Gojët e këqia flisnin, ruk iu thosh njeri as «hesht» as «mos», se gojën e tyre e kishin. Dhe Meçani me Manushaqen bënин planet se si do të martohësin e kur do martohësin. Ata prisin që të ndaheshin edhe prodhimet, pastaj ta shpallnin fejesën, e pas një kohe të bënин dasmën. Mi-

rëpo planet e tyre ua paskëshin prishur Destani me Ramazanir.

Para një muaji kooperativa e Hajdarajit kishte festuar pesëvjetorin e krijimit të saj. Qenë mbledhur burra e gra e të rinj bashkë në klubin e kooperativës e më t'ja kishin shtruar me të ngrëna, me të pira, me këngë e valle sa qe tundur qeri i kallajxhiut.

Nga mezi i natës, në zjarr të muhabetit, ishte ngritur Ramazani me shishen e rakisë në dorë dhe i kishte thënë Destanit:

— T'u tura, o Destan.

— Mirse të më vish, — i ishte përgjegjur ai.

— Unë po vij, por kam edhe një fjalë.

— Të re apo të vjetër?

— Të vjetër, po sot po ta them sefte. Do të ma dëgjosh? Destani qe kujtar ku i rrihte çekani Ramazanit.

— Po qe për të dëgjuar, do të ta dëgjoj, --- i ishte përgjegjur.

— Po edhe në mos e dëgjofshim ti e unë, or Destan, atë ka kush e dëgjon.

Të gjithëve sa ishin në gosti u pati vajtur mëndja ku ishte fjala dhe po mbanin vesh. Meçani me Manushaquer, nga turpja, ishin fshehur e mbledhur njëri në një qoshe, njëri në çoshen tjetër.

— Kur qérka kështu, për hair qoftë e me bukë të ëmbël, or krushku Ramazar, — ja kishte pritur Destani, pa pritur ta mbaronte fjalën Ramazani, e ishte ngritur e qenë puthur buzë për buzë me Ramazanin.

Të gjithë kooperativistët kishin rrahur pëllëmbët e duarve atëhere të gëzuar e i kishin uruar gjithë me gotat ndër duar:

— Me bukë të ëmbël, o Destar!

— Me bukë të ëmbël, o Ramazan!

— Hajde me trashgime dhe në kokën time, — kishin thirrur një takëm të rinj.

Havushja, eëma e Meçanit, po puthej me Zelikon, të jemën e Manushaqes. Xhevrija ja kishte kërcitur deficit me sa mundëte e Qerimi e qante me qemaret pas. Shebipi

kishte këthyer gënetën lart nga tavani e ja kishte marrë një kabaje myzeqarçe.

Meçani me Manushaqen kishin humbur torruan fare. Duke përfituar rga rrumuja, i qenë afruar shoqishoqit, kishin zënë duart e po rrinin si të shastisur nga gëzimi. Pogjene nuk kishin ndejtur shumë ashtu të harruar, se ishte ngritur Destani, me ato mustaqet e mëdha e të pilluara gjer te veshi e me ato vetullat e trasha rënë mbi sy, i kish zërë të dy dorë për dore, i kish puthur në ballë, e sado burrë, nuk i kishte mbajtur dot lotët nga gëzimi. Atëherë kishin thirrur të gjithë duke përplasur duart:

— Nusja në valle! Manushaqja në valle!

Riza Gurrës na i paske mbetur peronë në zëmër ajo fjalë që kishte thënë Destan Xhufka për të bijën, Shegën, sot e tridhjetë e kusur vjetë. Prandaj, me që sot i kishte ardhur në shtekt, do ta çfrente dufin. Kishte bërë si kishte bërë, ja kishte gjetur rastin kur qe shtruar pak gëzimi ! dyfisht e duke pirë një shëndet për çiftin i ishte drejtuar Destanit:

— A e mbar: mënd, o Destan Xhufka, ç'ke thënë një herë e një kohë për çupën t'ime? Pastaj, më duket, se ti ishje betuar që, po ta bënин edhe çupat e tua si Shega e ime...

— E mbaj mënd dhe fare mirë bile, o Riza Gurra, — i ishte përgjegjur Destani, — po kohët ndryshuan dhe kemi ndryshuar edhe neve që atëhere. Vdiq ajo kohë kur i fejonim djemt e çupat që rë barkun e nënës në raki e sipër, kur i rrëhni, kur i mbyllni, kur në katojt e kuajve, kur i vrisni. Sot kanë ardhur kohë të reja, o Riza Gurra!

Si m'a mbaruan së treguari këtë histori, i thashë Meçanit e Manushaqes:

— Miku, kur të vjen në shtëpi, ruk pyetet përse ka ardhur, po unë do të bëhem **budalla e do t'u pyes**.

— Po ja, — më tha Meçani, — kemi ardhur të marrim

një krevat të gjérë, dyshekë, jorganë, se siç të thamë, u martuam shpejt e shpejt, na u prish ay plani ynë që patëm bërë. U nxituan pleqtë.

— Mirë, — i pyeta, — po a kiri para, — se një krevat dyshe nga ata të Misto Mames bën..., një jorgan i madh bën... — E siç ua bëra llogari unë, u duheshin mjaft para.

— Kemi ore, si s'kemi!

Shpejt e shpejt Meçani më tregoi një dëng me mijshe. Nuk e kishte të trëmbur syrin hiç i biri e botës. Pastaj më bëri llogari:

— Sivjet urë futa në kooperativë 320 ditë punë. Manushaqja 290 ditë. Na ra dita e punës, njëditzaj para dy javësh kur ndamë prodhimet, nga katër kg. grurë, 2 kg. misër, nga 100 lekë para, veç të tjerave e të tjerave, si thekër, urov, sheqer... Ditët e punës që kishte bërë Manushaqia Destani ja la për plaçkë për vehte.

Vështrova një herë Meçarin të veshur e të mbathur, pastaj Manushaqen me atë sy gjarpër, e zgjuar, ta merrte fjalën nga goja, se kishte mësuar shkrim e këndim në kurs e tani bënte klasën e pestë në shkollë e natës pranë shtatëvjeçares që kanë në fshat, dhe thashë me vehte. duke krahasuar jetën e të rijve tani me të kaluarën: «Lum këta të rij sot! Me të vërtet kohët ndryshuan, mirë i ka thërë Destan Xhufka Riza Gurrës.»

PËR NJË ÇIKË DJALË...

Kur i lindi çupa e parë u dëshpërua e s'u dëshpërua Tafil Kazani, sa edhe të shtëpisë, edhe vëllazërija, edhe miq e shokë që vajtën e uruan, që të gjithë, i thanë:

— Mos u dëshpëro, o Tafil, se çupa sjell djemt pas, mos ki merak, po a e di ç'thuaj? Shyqyr që të shpëtoi grua-ja, se grua-ja me barrë është si ai njeriu me rjë këmbë në varr. Të rij jiri juve, ehu! sa do bëni e do pillni! Pastaj, më mirë që të lindi çupë fëmija e parë, se ajo do të rrisij djemt më vonë.

Por kur i lindi çupa e dytë i ra koka përdhe dhe nxinte e sterronte ky Tafil si ai oxhaku. Nuk priti as urime, nuk bëri as gosti kur i vuri emrin... Tani nuk kishin gojë si ta rgushëllonin edhe të tjerët.

— Ç'të lindi o Tafil? — e pyesnin fshatarët ato ditë kur e takonin në rrugë. Ai përgjigjej gjithë hundë e buzë, sikur t'ja kishin ata fajin:

— Çupë, or vëlla, çupë!

Dhe e këthente kokën më rj'anë, vështronte larg di-ku me një vend të pacaktuar.

Së shoqes zuri t'i rrinte lëshuar e t'i mbante mëri, si-kur e kishte ajo në dorë ta bënte ç'të donte.

— Ç'ke me mua të zezën, mor burrë?! — i ankohej Hys-rija, — këto janë punët e Zotit. Ai që na dha çupat do të na japij edhe djem, po mos fsho e mos hyrë në gjynah.

Ato ditët e para, kaqë shumë ishte dëshpëruar Tafili, sa po ta ziqej në majë të hundës i dilte shpirti. Por pastaj, du-ke kaluar ditët, dhe sidomos kur erdhi më të parë një hallo e tij e iu vuri veshin flokëve prapa kokës të çupës së dy-të! e i tha se shenjat e flokëve tregonin që pas asaj çupe do t'i lindëte medoemos djalë, atëhere sikur i kaloi pak

ai dëshpërimi i madh. Që rga ajo ditë zuri e po përpinqej kohë e pa kohë të bënte edhe një fëmijë të tretë, duke shpresuar se do të delte e vërtetë ajo që i kishte thënë hallua e do të thyhej këmba e shejtanit.

Qameti fare u bë në shtëpinë e Tafil Kazanit kur i lindi çupa e tretë. Gjashtë muaj i mbajti mëri së shoqes. «Kur lind çupa qajnë edhe qeprat e shtëpisë», thoshte me vehte. «Mirë se e para më lindi çupë, ja edhe të dytë e pranova, po kjo e treta q'qe?!

Kur vinte në shtëpi i cirrej së shoqes për çupat:

— Hiqi këto mace, largoji, të mos i shoh me sy!

Hysni ja e shkretë vinte rrëth t'i hiqte më nj'anë, po ku t'i conte? hiq piq një konak kishir. T'i nxirrte jashtë, mbërdhinin. Jepte e jepte, në fund zemërohej me 'të dhe ja kthente fjalën:

— Mos i pillje, nuk janë të mijat vetëm, por edhe të tuat. Bashkë i kemi bërë, ruk t'i prura me vehte. S'ke as gjunah, i thua edhe vehtes baba dhe nuk i përgëzon një herë këto çupa!

Duke dëgjuar magjitet e grave, çupës së dytë Tafil Kazani ja vuri emrin Sose, me qëllim që të soseshin çupat, së tretës ja vuri Mbaresë dhe sulmoi për të katërën.

Magjitet nuk pinë ujë fare. Edhe fëmija e katërt çupë i lindi Tafilit.

— Të murd gruaja ty, Tafil, — i thoshin një takëm që donin të talleshin, — pa shiko mos ja gjesh marifetin ta mundësh ti atë.

E ndonjë tjetër shkonte akoma më tej:

— Tafil vëllaj, — i thoshte, — shiko se ti e di si i zgjedhim re cjejet për të na bërë dhitë kecat femra. Mos edhe ti do t'i ngjash ndonjë cjadi t'atillë?

Gjersa Tafili s'qe i zoti të bënte një djalë, s'do mënt se kjo do ta gjente: prit e dëgjo llafet e botës, si i tirrte njeri nuk e endëte tjetri.

Pas çupës së katërt, si pati bërë dhe kushedi sa magji e sa duva ndër magjistarë e hoxhallarë, Tafil Kazanit i hipit në kokë ta ndante gruan dhe të merrte një tjetër, sep-

se tani e preu çdo shpresë pér djalé e nuk mund tē duronte dot më. «Çupat janë der'e botës», thoshte ai me vehte, «në sér ato rriten, martohen e hapin derën e tjetrit. Kurse mua tē ziut do tē më mbetet shtëpia mbyllur; mallir e gjenë time do tē m'i harë boja. Pleqërija do hysmet, unë s'kam një djalé ta martoja që tē kem nusen në shtëpi. Pa kushedi sa rroj, se yméri është gjer në ditët, e do tē mbetem udhëve sa te njera çupë te tjetra. Pa pastaj, mirë se do duan çupat tē më mbajnë, po valla do duan dhënduarrët?»

Zjeu sa zjeu kështu përbrënda me vehte, më në fund ja plasi këto mendime Hysnijes, duke u munduar që t'i mbushte mëndjen edhe asaj, se duhej tē sigurorin pleqërinë, tē mos u mbetej dera mbyllur...

Ajo u hodh këtu e atje tej kur i dëgjoi e iu kthye:

— C'thuu kështu, or burrë, ku tē vete unë, kam katër fëmijë?! I ke mëntë ti apo jo?! Ta merr mëndja ty tē ikij unë e tē lë çupat jetime?! Jo, or jo, sikur ta shoh litarin varur këtu në trat, nuk luaj unë nga shtëpija! Ti, ç'të duash bëj! Ç'mall e gjë kemi ne që do tē na e hanë boja, o i zi?! Jo tē mbledhësh tërë fshatin, por gjysmën, as pér një dre-kë nuk iu del.

Dhe ja krisi tē qarit kjo Hysnija sa ruk e përbaje dot. Çupat e vështronin tē mallëngjyera, e vunë në mes e po qanin edhe ato bashkë me t'ëmër.

Tafili nuk e trubullonte gjakur fare e as i pushonte as gjë prej gjëje, veç rrinte në këndit si qyp nardeni, i mërzitur, qylafin ngjeshur gjer ndër veshë, vetulla e mustaqe lëshuar, më i zi se gllaniku dhe «fap fup» pirte duhan: një cigar e shuanë, tjetrin e ndiste. Rrallë e tek xheku i vinte keq nga një herë tek vështronë që nën vetulla tē shoqer duke pushuar çupat e duke u dredhur sikur po ja shkëpusnin atë qast fëmijët nga gjiri, por pastaj prap e vendoste me vehte: «Jo xhanëm, po nuk e lë unë mallin tē ma hanë boja!...».

Hysnija, sikur t'ja merrte nga barku c'mejtorte Tafili n'ato çaste, duke e vështruar me bishtin e syrit, thoshte me vehte: «I ziu ti sa zemër katrani që je!».

Si Hysnija vetë ashtu dhe gjithë dashamirët e tij iu lutën Tafilit që të merrte një djalin e të vëllajt e ta bënte bir për shpirt, se i vëllaj kishte katër djem. Por Tafili nuk afrorët fare. Ai tërë marazin tek i vëllaj e kishte, se kur mejtonte që do t'ja hanin mallin bota, botë pér 'të djemt e të vllajt ishin.

Kjo grindë zgjati vjete me radhë në shtëpinë e Tafil Kazanit, gjersa më në fund se kush e pati mësuar t'i mbush-te mërdjen Hysnijes që ajo të pranonte çkurorëzimin në qeveri me këto kondita: Tafili të martohej me një tjetër, Hysnija të mos ikte nga shtëpija, ajo t'ish gjithnjë si gruaja e tij, të rriste çupat, t'i martonte. Çelësat e shtëpisë dhe zonjëllékun ta kishte ajo. Kurse gruaja e dytë e Tafilit të mos kishte asgjë në dorë veçse të pillte djem dhe të punorte ç'ta urdhëronte Hysnija; t'ishte, si të thuash, shërbëtorja e Hysnijes.

Ai që e këshilloi kështu ja kishte gjetur edhe nusen e dytë Tafil Kazanit e ja kishte gati me të mbaruar çkurorëzimin.

Deshi s'deshi, Hysnija e shkretë, ra në këtë ujdi me të shoqin, megjithse ajo e kishte frikën, se të gjitha këto që i thoshte Tafili, me të prurë atë thellërxën në shtëpi, do t'i harronte e nuk do t'ja mbante fjalën. Pale pastaj kur të lindëte ndonjë djalë me gruan e dytë, atëherë tërë dashurinë dhe tërë kujdesin Tafili do ta hidhët tek e dyta dhe Hysnjen me gjithë çupat nuk do t'i quanin veçse si shërbëtre të shtëpisë. Kush i duronte atëherë dënglat e shëmrës! Po ç'të bënte? edhe kërcënimet e të shoqit, se do t'i vinte drunë e do ta përzinte nga shtëpija, nuk duroheshin.

Me të marrë fjalën nga Hysrija, Tafil Kazani u dha kaparin pér nusen e dytë hëm lajmësit hëm vjerrit të dytë, se kishte frikë mos ja rrëmbente tjetri. Pastaj, veç kaparit, tre mijë lekë lajmësit e dhjetë mijë lekë të tjera vjerrit, do t'ua jepte ato ditë që do të merrte nusen.

Vajti në qytet te avokati, bëri lutjen pér çkurorëzim në emër të së shoqes, vuri në 'të gishtin e tij fallco dhe ja

dha gjyqit. Atë javë u qeth e u rrua te berberi, bleu edhe një palë rroba të reja nga stofa e kombinatit e i veshi që në pazar, se helbete dhëndërr. Kishte marrë vesh që atë të enjte kishte dalë në pazar dhe i vjerri, i dyti, e do të pi-qej me 'të, prardaj duhej që t'ja mbushte një çikë synë, jo vetëm me paret që i dha, po edhe me sullupin.

Kur e pa Hysrija në darkë ashtu të rruar e të pilluar, i shkoi menjëherë mëndja për ato ndryshime.

U hëngër dhe darka, u fjalosën dhe për ç'kishte nga pazari asaj jave e për ç'kishte nga fshati, po për lutjen nuk i zuri ngojesh gjë Tafili Hysnijes. Vetëm kur ranë të fllrin i hodhi dorën dhe i tha si nën buzë:

— E bëra atë lutjen unë.

— Shyqyr që erdhi sahati të bëhej ajo lutje që të gëzoja edhe unë në jatak një herë një çikë burrë për të qënë, se kemi njëzet e pesë vjet që jemi martuar dhe kurri nuk mbaj mënd të më kesh ardhur rjë herë nga pazari i qethur e i rruar te berberi. Kurse sot më qënke bërë, siç thoshin në një kohë plakat, «si dhëndërr kauri»!

Ditën që do të bëhej gjyqi për çkurorëzim vajtën Tafili. Hysnija dhe tre dëshmitarë nga fshati.

Siç e pati mësuar avokati Tafilir ashtu do të thoshte Hysnija në gjyq.

Gjykatësi, duke patur lutjen përpara me arsyen se nuk u puthnin karakteret dhe duke parë moshën si të Tafillit si të Hysnijes, dyshoi, për ndonjë djallëzi.

— Sa vjet ke që je martuar, shoqja Hysnije Kazani? — e pyeti.

— Poooo, kemi posa, kemi njëzet e pesë vjet e më shumë.

— Sa fëmijë ke bërë?

— Kemi katër t'Allahut. Katër çupa.

— Djalë s'ke?

— Të kishnja djalë, or shoku gjykatës, nuk kishja ardhur gjer këtu unë, — iu përgjegj Hysnija duke tundur kokën e pshtjellë me një çember të ri, si e pikëlluar. — Për një çikë djalë u ngrit gjithë kjo tantara e po mundo-

hemi posht e lart! Po le ne, se e kemi taksirat, po zotrija juaj ç'taksirat paskeni të lodheni me ne! Ç't'i bësh, kësh-tu qënka thënë e shkruar.

Hysnija hodhi një vështrim rrëth e qark sallës si për të larguar dëshpërimin, po kur pa gjithë ata r:jerëz, e më të tjerë që po hynin, iu err dynjaja; i erdhi turp qysh i sho-qi për një copë djalë e ngriti nga an'e anës dhe e pruri këtu, ta marrë vesh tërë bota... Ju duk sikur i ra tavani e e zuri. Po pyetja e gjykatësit e pruri përsëri në vehte.

— Shoqja Hysnije, na thoni: a jeni zënë ndonjë herë me burrin?

— Po pse të ziheshim, shoku gjykatës?! Ky në arë, urë në arë; ditën, ditën; natën, natën. Me barkun te goja kam vajtur e kam prashitur bashkë me të. Me një dorë kam mbajtut fëmijën rë krah me tjetrën kam mbledhur fasule që në mëngjes e gjer në darkë. Tërë natën i kam mbajtut fenerin e kemi vaditur, në mëngjes më ka lindur çupa. E me gjithë këto, pa bukë e pa gjellë kurrë nuk e kam lëre ndonjë herë, o shoku gjykatës. Pyete, ja tek është, — dhe i tregoi me dorë Tafilin që kish pranë, — a ka parë kurrë ndonjë herë të keqe nga unë?!

Tafili sa vinte po mblidhej si ndonjë këpushë e ata sytë si të bufit i ndririn përmes vetullave.

— Kurrë nuk jini zënë ndonjëherë?! — tingölloj zëri i gjykatësit.

— Bah, kurrë nuk jemi zënë, shoku gjykatës! — dhe Hysnija luajti pak nga vendi. Turp! qysh të ziheshim?! Po të qahem më vret Perëndija. Ama helbete, janë zorrët në bark dhe nakatosen. Xheku, rdonjë herë, edhe jemi grindur, po jo sa të bëhej e madhe, se ja tek është, le të thotë: ja kam kthyer ndonjë herë fjalën apo jo? Po ky i uruar ka patur vetëm një maras: donte një çikë djalë, që s'na e dha Zoti e s'na e dha, dhe për atë xheku më ka mbajtut mëri.

— Po mirëëëë, atëhere përsë kërkon të ndahesh ti me këtë Tafil Kazanir?

— E kam thënë aty në lutje unë, shoku gjykatës.

— Po ja, ti thuaj: «s'kemi armoni».

— Posi, ashtu është, ja ashtu siç e ka shkruar ai që e bëri atë lutjen.

— Kush e bëri lutjen?

— Ku e di urë e zeza, mor shoku gjykatës, si iu thoni juve atyre që shkruajnë lutjet.

— Shoqe, të thuash drejt, se këtu je para gjyqit, përse po ndahesh ti nga burri?

— Po ja për atë, siç e kanë shkruar aty në lutjet e siç e the zotrote vetë tanë.

Këtu Hysnijes nuk po i kujtohej dot ajo fjala që e kishte mësuar Tafili të thoshte në gjyq. Pasi tha kushedi sa herë: «ja për atë... ja për atë» më në fund iu kujtua:

— Ja për atë, shoku gjykatës, që s'ra puqin karikatorët....

— Po ti thuaj që s'ke patur grindë. Si është kjo që grindë s'ke patur dhe?.....

— Folë, or burrë, si i thonë asaj që të mësoi ai burri që të shkroi lutjen, se nuk e mbaj mënd unë e zeza. Ç'i thonë karikatorë a, ç'farë?! Se turp, po i lodhim edhe kë-ta zotërinjt.

Tafili kafshonte buzët sa i bëri copë. Mirëpo Hysnija e shkretë nuk e thoshte dot: «s'ra puqen karakteret», se e kishte harruar.

— Shoqja Hysnije, vazhdoi gjykatësi, — Tafili do të flasë kur t'i vijë radha dhe do të na thotë të drejtën siç na e ka thënë. Po ti thuana të tuat, se vetëm e drejta fiton.

Hysnijes i erdhi qamet. «Po mundohen goxha njerëz me kokër tonë», mejtoi me vehte, «turp! Paç faqen e ze-zë, or burrë!» Dhe duke vështruar plot sytë trupin gjykues: gjykatësin, një shoqe antare të gjyqit, që ishte në krahun e djathtë të gjykatësit, dhe atë burrin në të majtë të tij, tha me zë të kthjelltë:

— Do drejt ti shoku gjykatës?

— Doemos, të drejtën duam ne të na thuash.

— Atëhere, me Allah dhe me Perendi, ja cila është e drejta. Urdhëro e më dëgjo...

Dhe Hysrija zuri e ja numëroi drejt, fill e për pe, gjyqit tërë historinë, siç ishte e vërteta. Më në fund e mbylli fjalën:

— Tani e keni në dorë vetë ju, shoku gjykatës, për atë një cikë djalë ju lodhëm edhe zotrinë tuaj. Vendosni si të jetë e drejta.

Tafil Kazanit i kishte rënë koka përdhe, qe bërë njësh me dyshemenë e kur u përgjegjej pyetjeve të gjykatës të zëri i tij dukej sikur delte nga fundi i botës.

Në mbarim të seancës, trupi gjykues u hoq më nj'anë dhe pas pak komunikoi vendimin se gjyqi nuk e pranon të rrëndarjen e shoqes Hysnije me shokun Tafil Kazani.

Si mbaroi komunikimi i vendimit, Hysnija. siç ishte më këmbë karshi trupit gjykues, vuri dorën në zemër dhe i uroi:

— Paçi faqen e bardhë, zotérini!

Ktheu kokën prapa, hodhi një sy rrëth e përqark dhe iu duk sikur të gjithë njerëzit që ish'n mbledhur atje qenë të gëzuar për atë verdim të drejtë që mori gjyqi përfatim e saj. Prandaj i përshëndeti të gjithë me buzë në gaz duke pandyer se edhe ata kishin qënë me një mëndje me të dhe e kishin përkrahur që t'a fitonte ajo gjyqir. Atë qast i ranë në sy edhe muret e sallës që sapo ishin lyer me ate bojë aqë të bukur ngjyrë qelli.

Pastaj iu kthyte të shoqt, që kishte mbetur përmbyt:

— E, or burrë, nuk të pata thënë unë, nuk është razzi Perëndia të më ndash, se ruk të kam ndonjë faj unë e zeza! Ti s'doje. Mirëpo e drejta është e drejtë. Ja se edhe qeverija është me mua, ajo është për një të drejtë.

— I vuri dorën e majtë Tafilit në sup, si për ta bërë që të ngrinte kokën të shikonte e të bindej për të shkuar, me dorën e djathtë bëri një hark duke u kthyer nga salla dhe vazhdoi: — Pa shiko, or burrë, ja edhe të gjithë këta shokë e shoqe që janë mbledhur sot këtu po qeshin me ty, po për mua u ka ardhur mirë të gjithëve, se as zoti as robi nuk janë razi të ndahemi ne pas njëzet e pesë vjetësh e ca martesë. Ngrihu tashti të ikim, se bezdisëm miletin

dhe shko mërru kaparin atyre që ua ke dhënë për nusen e re, se ra duhen paratë, jeimi xhveshur e zbathur, kemi fëmijët lakuriq.

Kur e pa se Tafili s'po tundej nga vëndi u përkul e i pëshpëriti në vesh: —

— Jam me barrë prapë, se e ndjeva gjallë këtu. Isha-llash na lind djalë ky i pesti dhe po na lindi djalë do të bë-het i mirë dhe i mençëm si gjykatësi, se tek ai i kishja sytë n'atë çast që më lëvizi. Kështu thonë: «fëmija i ngjan atij që e ke në sy n'atë çast që e ndjen gjallë».

Tafil Kazani qe mbledhur nënë gunën si ndonjë iriq dhe me ata sy si të bufit që i ndrinin përmes vetullave vësh-trorte rrëth e qark sallës si i hutuar. Nuk i bënин gjunjët të ngrihej. Ku të vinte? Ç't'ju thoshte krushqeve që po e pris-nin përjashta e që do të nisëshin për të marrë nusen e re sa po të merte vendim gjyqi për ta çkurorëzuar.

Vendimi i gjyqit qe më për hair për Tafil Kazanin, sepse, pa shkuar as gjashtë muaj nga dita e gjyqit, Hys-nija lindi djalë pës katër çupash. Djali e bëri Tafil Kazarin të harrojë humbjen e gjyqit dhe të nuses së re. Kurse Hysnija, veç gëzimit të madh që pati se i lindi djalë, ajo gëzoi edhe se djali do t'i ngjajë gjykatësit...

AVAZI I KIÇOS

Kiço Dervishi sa herë që pinte, jo vetëm që bëhej thumb, por edhe zihej me shokët, thyente gotat, rrihej nga një herë, e si të thuash, ishte njeriu më i mërzitshëm.

— Pse pi, mo Kiço, mo derëzi e punëzi? — i thoshin ata që e donin. — Hiq mo dorë rga rakija, se shkatërrove shtëpinë, shëndetin. A e di që kur pi e humbet mëndjen dhe bëhesh loço?

Dhe Kiçua iu përgjegj duke zgjatur përpëra atë hundën e tij të madhe e të kuqe nga rakija si mëlçi e prishur:

— Po unë i ziu prandaj pi, që ta humbas pak mëndjen, se u lodha së menduari me mënd në kokë.

E megjithatë Kiço Dervishi, edhe kur ishte esëll nuk kishte më shumë mënd se sa kur dehej.

Herën e fundit që qe dehur, i kishte rënë në qafë kot së koti rjë bashkëfshatarit të tij, e kishte sharë, e në fund pati vajtur sehiri një grosh në fshat. Si i dolli rakija në mëngjes, e shoqja, Marika, e bëri rezil.

— Turp, turp të kesh nga hija jote! — i tha duke çejrrë faqet. — Ti le që pi sa çmëndesh, le që po na prish shtëpinë me atë të shkretë raki, por sa herë dehesh, do të nxjerrësh nga rjë avaz. Pse, ore burrë, bëhesh gazi i botës! Pa véri një çikë gishtin kokës; me ato para që pive, blije një palë opinga për djalin që e ke zbathur, i sillje shtëpisë një jorgan të pshtillëshin fëmijët për të fjetur... A i bën këto hesape apo ruk i bën?!

Kiçua, si fajtor që ishte, as fliste as kuvëndonte. I mbufatur nga rakija, vështronte me sy të skur-qur duart që i qenë çjerrë ferrave dhe mejtonte me vehte: «Si jam bërë unë, o grua, folë ti të dëgjoj unë tanë». Dhe në fund i thirri: «Bjemë atë kryq, bjemë edhe atë ungjill këtu». E si shkeli kryq e ungjill, u betua që nuk do ta vinte kurrë rakinë në gojë.

— E po shyqyr që i erdhën mëntë, — tha Marika e shkretë atë ditë dhe u gëzua sikur t'i kishin falur dy-njarië.

Kur muarrën vesh bashkëfshatarët e Kiços, thanë: «Të kthejmë një gjë së mbari» dhe e uronin: «Shyqyr që shpëtove, o Kiço!». E Kiçua u pëgjegjej: «Shyqyr që shpëtuat edhe juve, se edhe juve ju kishte ndezur groshi me mua».

Mirëpo një takëm pleq nuk e linir rehat Kiçon e zi. «Shtjeri një gotë Kiços nga unë», i thoshin kafexhiut duke u shtirë gjoja sikur nuk e dinin se ai ishte betuar.

— Jo, jo, nuk dua, e kam bërë be.

— Hë, mo, hë pije. Je betuar për të mos pirë raki kumbulle, kurse kjo është safi rushi, digjet rë gishtit. Je betuar për të butën, jo pér të fortën.

«Kërrtiq» ja bënte gurmazi i Kiços dhe shikonte rrëth e qark. Ndonjeri merrte gotën e tij, ja afronte te hunda dhe i lutej: «E po mirë, o Kiço, ti je betuar të mos e pish, po jo të mos marrësh erë».

«Kërrtiq», «kërrtiq» «kërrtiq» ja bënte gurmazi i Kiços tri herë me radhë. Po sidoqoftë, megjithë këto «provokime», siç i quante Kiço Dervishi, ai pati qëndruar burrë.

Kishir kaluar afro tri javë nga dita që pati lënë rakinë Kiçua. Edhe për shtatë ditë binte nata e Shën Vasilit. Taqua, i vëllaj i Kiços, kishte fejuar djalin, Vasilin, dhe me rastin e ditës së emrit ai do të bënte edhe gostin e fejesës së djalit atë natë.

Kiçua e mori vesh që Taqua i kishte nxjerrë nga rrusht e tij rj'a njëzet qillo raki ballë kazani, edhe verën ja dinte që e kishte lloj-lloj të kuqe, të bardhë, tre vjeçë verë. Tërë ato ditë mejtonte: «Ah, unë i varfëri, që nuk do të burbuletem dot një çikë!» dhe kur kujtonte gostinë «kërrtiq» ja bënte gurrmazi.

Nata e vitit të ri erdhi dhe Taqua kishte bërë darkë për kokën e darkës. U shtrua rakija, mezetë lloj-lloj: mish, gjel deti. Filluan gotat: «çak-çuk» «çak-çuk». Kiçua shikonte si i mjerë. Nuk kishte frikë ai as nga kryqi as nga urgjilli që pati shkelur se as e shihnin ata, as e dëgjonin e as i flisnin, po kishte frikë nga e shoqja. E shikonte Marikën në syt sikur t'i lutej: «Amar, a të pi edhe unë sot, vetëm

sot, se këtë gjëzim ka burazeri, e ka djalë të vetëm Vasilin?» Por ajo e shikonte me inat sikur ta shtinte në dhjet të gjallë. Rrotullohu andej, Kiçua i zi, irotullohu këtej, goja i lëshonte lëng. Ndonjeri nuk e linte rehat: «E di si qërke kjo raki, o Kiço, — i thoshte, — si ajo që nxori aty parë-vjet Aliu. Vetë shkuaka, vetë, nuk dashka të shtyjtur hiç fare». Sepse u ngrit Marika e vajti m'at' anë nga e kunata, atëhere Kiço Dervishi u bë trim e iu thirri shokëve: «Më mirë tri ditë e kaposh, se sa motmot e pulë, o shokëni», dhe «fap» e rrëmbeu gotër e e ktheu. Aqë qe puna sa u thye betimi, e Kiço Dervishi e zuri radhë: një për atin, një për birin, një për shpirtin e shejtë.

— Do të na e prishi gjëzimin ky, — menduan të gjithë, rjëzet e ca të ftuar sa qenë atë natë te Taqua.

Pas tri të parave, Kiçua filloj si zakorisht: merrte gotën dhe duke e kthyer me fund, sipas mënyrës së tij, thërriste: «Hopa! E priti gropal!» dhe herë pas here ja thoshte këngës së tij që ja kish ngritur fshati:

*Raki rushi, meze mish,
Qejf, o qejf, Kiço Dervishi.*

Të tjerët e zunë shtruar në fillim, por pastaj, disa prej tyre, si iu pati hyrë mirë në tru ajo e shkretë raki, e ua bëri shesh me lule, filluan edhe ata si Kiçua. «Hopa! E priti gropal!».

— Ngadalë, o shokëni, se do të bëhem Kiço të gjithë, si e kini zënë juve, — tha Muke Gjyryku. Po ata që i kishte bërë për vehte rakija ishir të mençëm vetë tanë. Një nga ata qe edhe plaka Stefani Kënuta, tezja e Kiços, së cilës ja pati lënë trashëgim në kamaret punën e të pirit që e gjyshja dhe që bërë qejfleshë edhe ajo.

Në kulmin e qejfit e të muhabetit, Kiçua ngriti gotën: «Me zëmër të mirë e me bukë të ëmbël, o burazer!» — e uroi Taqon, — Të të trashëgohet Va...va...va....» E nuk po mundët dot ta imbaronte urimin. Buza e poshtme po i dridhej e po qante.

— Ç'ke o Kiço?

— Edhe më pyesni ç'kam unë?! — thirri Kiçua. — Po unë i ziu do t'a kishja djalin sa të Taqos sot, do ta kishja

fejuar edhe unë si Taqua. Tani kam mbetur me çupat e me atë djalir dhjetë vjeç. Valla do t'ja arrij unë që ta fejoj?!

Kiços i kishte vdekur fëmija i parë këtu e njëzet e pësë vjet të kaluara pa bërë as tri javë. Kujtohet tre javëshi pas çerek shekulli! mirëpo ç'të bënte edhe ai i shkreti?! ashtu e mësonte rakija.

Lotët e Kiços shkonin si breshërimë e i përpinqeshin në majë të mjekrës.

Nga shkaku i Kiços, ja krisi të qarit edhe Taqua. Push-to Kiçon e qaj lebetit:

— Po ç'ke ti, or burazer, Vasili im është yti!

Ndërsa po mundoheshin të pushonir Kiçon e Taqon, që qenë bërë të dy kokë për kokë duke puthur e pushtuar njeri tjetrit, hop ja krisi Hasani

O burra, u derdhë njerëzit, të pushojnë Hasanin. Mirëpo kë të pushonir më përpara tani, se gratë vërtet nuk kishin pirë, po gratë si gratë, ato një çikëz shkak duan dhe lotët i kanë gati. Ato ja krisën me shami ndër duar e qaj e Lebetit, puth shoqja shoqen e mundohu të mbajnë me gjajret njera tjetrën.

— Po ti mos qaj, moj Fotiri, ti të thuash: shyqyr e lum që ja arrijte ditës të fejosh Vasilë. Pa mejtomë mua korbën që kam shpurë në Shëndëlli katër me radhë njerin pas tjetrit; njerin sa po lindi, tjetrit dy javësh, tjetrit gjash-të muajsh... Tani kam shyqyr pesë perifanë, po ata që me karë vdekur nuk i kam harruar. Thuaj për mua, unë kam të drejtë të qaj për Thomanë, për Nikon, për Rikun...

Këta ishin emërat e fëmijëve të vdekur të Stefanisë që mundohej të mbante me gjajret Fotininë, të shoqen e Taqos. Mirëpo u bë një ngatërrresë, sepse këta emra Stefania ua kish vënë fëmijëve që kishte gjallë, e kur dëgjuan të dehurit se Stefanisë i kishte vdekur Thomai, Nikua, Riku... kujtuan se i kishin vdekur ata që kishte gjallë, mbasi nuk i dinin emrat e fëmijëve të vdekur të Stefanisë këtu e dyzet vjet më parë, prandaj u derdhën duke qarë nga Stefanija:

— Qysh, moj e zezë! Qysh moj korbë! të paska vdekur Thomai, moj?!

— Po, or bir, për kokë time më ka vdekur Thomaj

Dhe Thomai ishte më i madhi. Kur thoshte Stefanija: «Thomaj i parë» sarahoshi t kujtonin Thomanë si barku i parë.

— Edhe Nikua të paska vdekur?! — e pyeti tjetri.

— Edhe Nikua, or shpirt, edhe Nikua!

— Po Riku ç'pati, moj kallogre?!

— Ja, për njëzet e katër orë, iku. Siç e mbanja përparrë duarve, mbylli sytë e sikur s'e pata të gjallë, — tregon-te e qante Stefanija.

Gostija e Taqos u kthye në vaj e në kuje tanë. Kiçua qaj më rj'anë, Hasani lebetit andej, gratë me shami në dorë kullonin lotë e qyре. Stefaninë nuk kish zot që ta pushonte.

— Daleni, bre burra, — thërrisin ata që ishin në gjendje, — daleri bre, se kemi gosti. Nuk jemi mbledhur këtu të kujtojmë ata që vdiqën gjysëm shekulli më parë.

— Pa ta marrim shtruar, pa ta marrim shtruar, — thiri Muke Gjyryku. Pushoni ju gratë një herë, pa pusnoni juve. Le këta që janë të dehur, po juve ç'kim, me erët u dehët juve?!

Gratë u qetësuan.

— Pse qan ti Stefan? Cili Niko të ka vdekur?

— Ai që kam në Shëndëlli, Nikoja i parë.

— Po Nikon tjetër ku e ke?

— Puron në fabrikë, t'u bëftë nëna.

— Thomanë e ke në shtëpi. Edhe Rikun shëndoshë...

Si u muar vesh puna e Stefanisë, të tjerët hoqën dorë nga lotët dhe muhabeti ra shesh përsëri. Vetëm Kiçua nuk pushonte.

— Pusho, o Kiço, se nuk ka vdekur njeri, po ty të ka vdekur mërdja, — i tha Myke Gjyryku. E mori Kiçon krahë e kofshë, e coi në një qoshe, i hodhi një rrobë, e pastaj ju drejtua gjithë të tjerëve: — Ua thashë që në krye, bre shokë, mos pini se do bëhemë Kiço të gjithë. Ja ku na coi avazi i Kiços. Ky është avaz i rakisë. Na fal o i zoti i shtëpisë...

Kiçua, që tanë i qe trashur gjuha nga rakija e që i dëgjonte këto bisedime, thërriste që nënë rrobën rga qosha ja ku e kishin vënë të flinte: «Hopa! E plitti gllopaaa!».